

IN•PE•RA•TO•RE•BT: Zbulimi i zanafillës dhe enigmat e mbishkrimit në përkrenaren e Skënderbeut.

Nga Ylli Sula



BOTIM JUBILAR I VEPRËS SË CAMAJT

Numri i ardhshëm do t'i kushtohet
kësaj ngjarjeje të rëndësishme

Për një lexim më të thelluar dhe
për një interpretim më të mirëfilltë
të veprës letrare të Martin Camajt

Anton Nikë Berisha (fq. 12)

SHËNIME MBI LIBRAT

"Ikona e plagosur"

Një tjetër roman historik i
Mira Meksit

Nga Eshref Ymeri (fq. 13)

Shënime për romanin "Bija e Minotaurit"

Moderniteti arkaik i Agron Tufës

Nga Balil Gjini (fq. 21)

Një monografi studimore e Behar Gjokës, "Toena"

Petro Marko - shkrimtar i lirisë

Prof. dr. Bardhosh Gaçe (fq. 6)

Sherif Bundo, Dollia shqiptare, institucion
shpirtëror i mikpritjes. "Mediaprint"

Një monument i gjallë
etnokulturor

Nga Agim Vinca (fq. 8)

"Dëshmitari i remë" i autorit Bujar Skëndo

Një roman për artistin
Sherif Merdani

Nga Izet Duraku (fq. 11)

"Grila e bardhë" e Raimonda Belli Gjençajt, "Dituria"

Një bardhësi e ndritur simbolike

Nga Prof. dr. Klara Kodra (fq. 16)

Nga Bechtein
te Bechtein

Nga Ina Kosturi (fq. 17)



Foto nga Fadil Berisha

Ermonela Jahos, në operën koncertale 'La rondine' të Puccini-t

Nga Eno Koço

Ishte po ky zë i Ermonelës që penetroi më së bukur mbi këtë orkestër kaq të rafinuar e të përsosur siç është Orkestra Simfonike e BBC-së së Londrës edhe pse në momente të caktuara dirigjenti Rizzi mund ta kishte kontrolluar orkestrën duke e mbajtur atë më qetë, veçanërisht në momentet e ndjera të regjistrat të mesëm të zërit të Ermonelës.

Ç'privilegj të ndiqje këtë operë koncertale. Edhe në ardhje për në Barbican ashtu si dhe në dalje nga salla pas përfundimit, në bashkëbisedimet e shkurtra me londinezët ndiheshim krenarë të prezantoheshim se jemi bashkatdhetarë të saj. (fq. 9)

MISTERET E

BILL CLINTON-IT

Nga Gabriel García Márquez (fq. 22)

Vëllezërit Grimm ishin të zymtë për një arsye

Nga Jennifer Wilson

The New Yorker (fq. 18)



BIBLIOTEKË

Shefkije Islamaj

(fq. 14)

Unë jam vjeshtë

Dashamir Malo

(fq. 15)

Rikthim

Arben Meksi

(fq. 23)

Karikatura e së shtunës

Malsorja që jetoi 106 vjet

DADA MEREME!

Nga Zylfi Tola (fq. 7)

SI T'I BËSH TË BUKURA FLATRAT E TRAGJIKES?

Triptik me tre zogj në tri
romane...

Nga Visar Zhiti (fq. 20)

Fatmir Musaj dhe Taip Sulko
bisedojnë për romanin "I arratisuri"

TË RRËFESH PËR VETEN
TËNDE ËSHTË NJË
FUSHË LETRARE
E MINUAR (fq. 10)

IN • PE • RA • TO • RE • BT: Zbulimi i zanafillës dhe enigmat e mbishkrimit në përkrenaren e Skënderbeut.

Nga Ylli Sula

Që prej shfaqjes së saj për publikun në fund të shekullit XIX, në Muzeun e Vjenës, përkrenarja e Skënderbeut, si asnjë element apo artefakt tjetër i mbijetuar nga ai, është shndërruar në objektin dhe simbolin më të fuqishëm personifikues të heroit mbarëkombëtar shqiptar, duke patur një ndikim shenjues në formësimin e gjithë ikonografisë së ndërtuar për figurën e tij.

Përkrenarja u bë shenja parësore dalluese, simboli heraldik qendror përmes të cilit Shekulli i Rilindjes, arbëreshët dhe më pas Shqipëria moderne, kanë përfytyruar e ndërtuar portretin e Skënderbeut.

Me formën dhe punimin e saj të veçantë, të kurorëzuar nga koka e dhisë mitike, e qarkuar nga rrethi metalik me rozetat e praruar dhe mbishkrimin mes tyre, ajo do shndërrohet në një emblemë ku ngërthehet e përqendrohet e gjithë mitologjia kombëtare, historike, politike, kulturore dhe fetare, madje edhe cilësitë e jashtëzakonshme vetjake që lidhen me Gjergjin e Madh, që nga përfshirja në narrativën e identitetit kombëtar shqiptar, ndërlidhja me traditën e heronjve antikë, me panteonin e strategëve ushtarakë, me ritualet europiane të armëve, me vlerat e kalorësisë e fisnikërisë e deri tek ndërhyrja e hyjnore në fatin e heroit. Vendosi zyrtare e përkrenares në emblemën e shtetit shqiptar më 1925 është tregues i qartë i peshës së madhe simbolike që ajo mori në më pak se 30 vite nga shfaqja e saj, për t'u fronëzuar më 1928 si kurorë e mbretërisë shqiptare të mbretit Zog I. Ajo është kështu e njëkohësisht artefakt material, relike heraldike, mit identitar, legjendë popullore, simbol shtetëror dhe metaforë politike.

Por një dimension shtesë e ngriti këtë objekt në pedestalin e simbolikës së një heroit mbarëevropian: mbishkrimi enigmatik i gdhendur në brezin e bronzit të përkrenares, formulimi akrostik "IN • PE • RA • TO • RE • BT", i cili ka intriguar shumë studiues shqiptarë e të huaj.

Këtu nis edhe rrëfimi ynë: le të ripërshkojmë rrugëtimin e deritanishëm të përkrenares dhe mbishkrimit të saj plot mistere dhe enigma, për t'ju sjellë më tej zbulimet e fundit të kërkimeve dhe hulumtimeve tona për simbolin më identitar të heroit tonë kombëtar.

**Faik Konica, "Albania" dhe
mëmëdhëtar i anonim**

Lajmi i bujshëm i shfaqjes për herë të parë në formë të prekshme i armëve të Skënderbeut, pikërisht në Muzeun e Vjenës, siç dihet gjerësisht, iu përcoll mbarë botës shqiptare nga Faik Konica. Në numrin 8 të revistës "Albania" (30 dhjetor 1897), Konica botoi shkrimin me gjetjen aq ngazëllimshjellëse për shqiptarinë e kohës: "Armët e Skënderbeut në Muzeun Perandorak të Vjenës". Konica në këtë rast ishte vetëm përcjellësi i lajmit, pasi gjetja i takon një "mëmëdhëtar"-i, letrën e të cilit,



Përkrenarja e Skënderbeut

dërguar Konicës, ky i fundit e boton në numrin e sipërpërmendur të "Albania"-s, duke cilësuar vetëm vendin dhe datën e shkrimit të letrës, "Viëne, n'15 t'Britmit II 1897", por jo emrin e autorit, i cili na përcillet i shenjuar me "X ***".

Nga kjo letër kemi të trashëguara deri sot përshkrimin e përkrenares, zbulimin dhe zbërthimin në latinisht të germave të mbishkruara rreth brezit të bronzit të përqark saj:

"Ksula asht é rhumulh, por syfri ksules ghinét ñi kryé dhié, éné kjo é shkrumum mé ar. Okolhas balhit asht ñi cop hékur dy ghishtesh i ghan, n' t' cilin jan t' shkrumuna kto létra:

IN • PE • RA • TO • RE • BT •

do mé than n' ghuu lhtinisht:

"*Ihesus Nazarenus • Principi Emathiae • Regi Albaniae • Terrori Osmanorum • Regi Epiri • Benedicat T.*"^[1] (foto 1,2,3)

Të parët që i bënë jehonë këtij lajmi, natyrshëm, ishin arbëreshët e Italisë. Një muaj e gjysëm më vonë, më 15 shkurt 1898, mbishkrimi dhe dekodimi i tij në latinisht, siç e kishte përcjellë Konica, botohet në gazetën *La Nazione Albanese*, e themeluar në

Kalabri nga Anselmo Lorekjo. Shumë shpejt pas botësimit ndër shqiptari, përkrenarja dhe mbishkrimi i saj u shndërruan në një element të mirëfilltë ikonografik e heraldik që dukej sikur kishte shoqëruar figurën e Skënderbeut që në të gjallë të tij, pavarësisht se ky integrim po ndodhte thajse 450 vite pas vdekjes së heroit.

Ky rikonfigurim i ikonografisë dhe heraldikës skënderbejane, nuk do të zhvillohet si një proces, por do të përftohet si një fakt i mirëqenë nëpërmjet dy akteve të vetme: njeri lajmëruar, nga Konica, drejtuar fillimisht botës shqiptare, dhe tjetri "kanonizues", drejtuar kryesisht botës italo-arbëreshe dhe europiane, siç do e shohim më poshtë. Përndezja patriotike, identitare e idhullizuese, që rrethonte figurën e Skënderbeut gjatë viteve të Rilindjes dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të fundshekullit të XIX dhe fillimshkullit të XX, pa dyshim kishte pjesën e saj në përpjirjen plot etje të këtyre akteve shpalosjeje e ripropozimi të ikonografisë dhe heraldikës së Skënderbeut, por një element tjetër peshonte po aq në gjithëpranimin entuziast të të dy akteve në fjalë: profili tepër i lartë dhe autoriteti i padiskutueshëm i autorëve të tyre, Faik Konica dhe... Zef Skiroi.



**Zef Skiroi - "kanonizuesi" akademik
i mbishkrimit: nga lajmi i Konicës
në ikonografinë italo-arbëreshe dhe
europiane për Skënderbeun**

Më 1904, Zef Skiroi botoi në Napoli veprën e tij të rëndësishme *Gli Albanesi e la Questione Balkanica* - një traktat patriotik identitar, politik, historik dhe kulturor, i shkruar për audiencën italiane dhe europiane, me qëllim tërheqjen e vëmendjes dhe mbështetjes së saj në favor të çështjes kombëtare shqiptare. Në faqen hyrëse, pas faqes së titullit, Skiroi vendos portretin e Skënderbeut, të shoqëruar me mbishkrimin e plotë latin të përkrenares, sipas interpretimit të sjellë nga Konica shtatë vite më parë.^[2] (foto 4)

Kjo faqe është konceptuar si një pllakë memoriali që sjell bashkë, sipas përzgjedhjes qartësisht simbolike e kumtsjellëse të Skiroit, të gjitha elementët më përfaqësues të ikonografisë dhe heraldikës skënderbejane, mes të cilave Skiroi jo vetëm ka përfshirë edhe mbishkrimin e përkrenares, por i ka dhënë atij një peshë kumtuese thelbësore (foto 5).

Si poet, profesor universitar dhe drejtues i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Institutin Oriental në Napolin e shquar akademik të kohës, por edhe si folklorist e publicist i angazhuar, Skiroi nuk ishte vetëm një studiues, por edhe një prodhues i identitetit kulturor arbëresho - shqiptar, një intelektual që ndjeu qartë nevojën, ndaj u përpoq aq fort, për të formësuar mënyrën se si Evropa i shihte Shqipërinë dhe shqiptarët. Në këtë përpjekje duket qartë që për Skiroin figura e Skënderbeut përbën pikën madhore të referimit dhe boshtin qendror të projektit rilindas të afirmimit identitar.

Nga ky këndvështrim, faqja - memoriali dedikuar Skënderbeut në hyrje të librit shërben si ikonë programatike në çdo element të saj ikonografik e heraldik:

-Portreti i Skënderbeut: i paraqitur në formë medaljoni, vjen me referenca të qarta në modelet e neo-humanizmit europian dhe kornizës ikonografike të shekujve XVI-XVIII, në vazhden e përfytyrimit të heroit sipas portretizimit të famshëm që gjendet në *Galleria degli Uffizi* në FIRENCE (mesi i shek.XVI), thajse identik me portretin e Skënderbeut në librin *Ritratti ed Elogii di Capitani Illustri* (1635) apo me një tjetër portret - medaljon të botuar në librin *La Spada d'Orione* (1680), të dy botime që e trajtojnë figurën e Skënderbeut mes mbretërve, fisnikëve e udhëheqësve ushtarakë më të shquar në rang evropian (foto 6, 7, 8). Në të gjitha këto portretizime Skënderbeu shfaqet jo si një luftëtar, por si një princ neo-humanist, i qytetëruar në qendrim dhe veshje, pjesë e natyrshme e botës politike europiane. Kjo i shërbente tezës së Skiroit se "çështja shqiptare është çështje e Evropës".

-Shqiponja dykrerëshe: e vendosur menjëherë poshtë portretit, simboli heraldik madhor i Skënderbeut, i shndërruar tashmë

në simbol kombëtar, duket të jetë marrë po nga *Ritratti di Capitani Illustri* (foto 7) ose nga familjet napoletane (aty ku Skiroi jetonte e punonte) pretenduese si pasardhëse të Skënderbeut, të cilat, sipas studiuesit Jaho Brahaj [3], kanë përdorur pikërisht këtë model stilizimi të shqiponjës.

-**Akrostiku i përkrenares** me tekstin e plotë të dekriptuar: të qendërzuara dhe shtrira sa gjithë gjerësia e faqes - memorial, gerrat e akrostikut janë vënë ndjeshëm në pah nga madhësia mbi dyfish me tekstin latin të dekriptuar, duke bërë që ato të lexohen edhe më vete edhe si pjesë e tekstit të plotë.

-**Emri i plotë i heroit** - Giorgio Kastrioti Skanderbeg, shoqëruar me vendin dhe ditën e lindjes dhe të vdekjes, ku bie në sy se, pavarësisht traditës së konsoliduar deri atëherë në gjuhën italiane të të shkruarit të emrit të heroit dhe kryeqendrës së tij me C (Castrioti - Scanderbeg - Croia), Skiroi ka zgjedhur në të treja rastet të përdorë K-në e shqipes.

-**Epigrami katërvargsh**: Poemthi-epitaf në latinisht, i ndarë në dy kolona nga dy vargje, është edhe elementi përmbyllës i “kanoneve” ikonografiko-heraldike të kompozuara e propozuara nga Skiroi për figurën e Skënderbeut. Në shqip përkthimi do ishte ky:

Përse më tej të krenohesh me Pirron e të lëvdosh Akilin?

Ky burrë më i madh se djali i Peleut dhe vetë Pirro qe.

Me fuqinë e tij farsalike fort i trazoi kohortat gete.

Përpara vazhdo! Veç me dorën tënde atdheun e çlirove.

Edhe në këtë element të fundit Skiroi nuk shpik apo krijon asgjë të re, por vetëm mëton të “kanonizojë” një tentativë të mëparshme të integritimit të këtij epigrami-epitaf katërvargsh në ikonografinë skënderbejane, të marrë nga vetë autori i epigramit, poeti neolatin francez, njëkohësisht portretist dhe botues, Jean Jacques Boissard, i cili në dy botime të tij *Icones diversorum hominum fama et rebus gestis illustrium* (1591) dhe *Vitae et Icones Sultanorum Turcicorum, etc.* (1597) boton portretin e Skënderbeut të shoqëruar nga katërvargshi latin i krijuar prej tij, që Skiroi e risjell tregind e ca vite më pas identik, si tekst dhe në ndarjen e tij në dy blloqe nga dy vargje (foto 9).

Për t’u rikthyer më ngushtësisht tek tema e shkrimit tonë, siç vërehet qartë, mbishkrimi i përkrenares mbart një peshë thelbësore në kompozimin e këtij propozimi të ri ikonografiko-heraldik të figurës së Skënderbeut nga Skiroi. Shkëputja që Skiroi i bën mbishkrimit nga konteksti i përkrenares e zgjeron rrokjen semantike të tekstit, duke e zhvendosur “bekimin e Jezuit të Nazaresë” drejtpërdrejt mbi vetë Skënderbeun e jo më nëpërmjet përkrenares apo armëve të tij. Po kështu, duke e vendosur akrostikun me tekstin e plotë mes portretit, shqiponjës dykrerëshe dhe emrit të plotë të heroit, mbishkrimi merr vlerën dhe peshën



Foto 4




Foto 1

e një liste titujsh mbretërorë e kalorsiakë të bekuar nga një vullnet hyjnor.

Botimi dhe marrja e mirëqenë e mbishkrimit akrostik nga ana e dy figurave intelektuale me autoritet tepër të lartë si Konica dhe Skiroi bëri në vijim e deri sot që askush të mos përpiquej të hulumtonte apo të mos arrinte të shkonte përtej tyre, në zanafillën e identifikimit dhe interpretimit të akrostikut, pa menduar se kështu, në fakt, gjithçka po i besohej jo Konicës e Skiroit, por thjesht letrës së mëmëdhedashësit kureshtar të vitit 1897, të cilit nuk i dihet as emri...

Edhe një studiues i thellë i historisë së Skënderbeut dhe njohës i mirë i latinishtes si Patër Marin Sirdani në studimin e tij *Skanderbegu mbas gojëdhanash* (1926) bën të njejtën gjë kur përshkruan “përkrenaren e Skanderbegut”, riprodhon tekstualisht mbishkrimin sipas botimit të Konicës.

Vetëm në vitin 1932, në vigjilje të 20 vjetorit të pavarësisë, gazeta “Besa” në Tiranë, teksa jep një informacion të detajuar të vendit, mënyrës dhe rrugëve sesi janë gjendur në Vjenë, armët e heroit tonë kombëtar, shprehet për herë të parë jo fort e sigurt për deshifrimin e akrostikut. Nga shkrimi tek “Besa” (3 Mars 1932), mësojmë se:

“... Në sallën XXV Nr. 71 (127), të Muzeut të Arteve të Vjenës, ndodhet përkrenarja “George Skanderbeg”. Ajo është ngjyrë e bardhë, me rrafshe të arta dhe ka sipër saj një kokë dhie të artë me dy brirë. Kjo përbëhet prej dy pjesëve: një pjesë bakri dhe pjesa tjetër sipër, është me një copë metal, buzët e së cilës janë të zbukuruara në ar. Në mesin e përkrenares është vendosur një rreth prej bakri me një gjatësi prej 65 cm dhe në këtë rreth janë shkruar këto shkronja: IN. PE. RA. TO. BE. BT. Ky shkrim, që është shumë i vështirë për ta kuptuar se çfarë thotë, deri tani e kanë deshifruar kështu: “Jesus Nazarenus. Principi Emathiae. Regi Albaniae. Terrori Osmanorum. Regi Epiri. Benedicat”. Poshtë buzës së përkrenares janë vënë 9 copa të mëdha dhe këto janë të lidhura me një rrip lëkure me bojë hiri. Pesha




Foto 2

e të gjithë përkrenares është 3000 gr. Sado që kjo përkrenare ka elemente orientale, mendohet se është punuar prej një artisti venecian.”

Sipas studiuesve Fotaq Andrea dhe Dritan Muka, “këto të dhëna të gazetës “Besa” përbëjnë në thelb po ato që na ka përcjellë në vitet 1930 ish konsulli austriak për Shqipërinë Leo Alexander Freundlich, i cili u mbështet për historikun e tij kryesisht në studimin e Dr. August J. Gross, në atë kohë konservatori i Muzeut të Vjenës. Ky dokument - shkruajnë dy studiuesit në triptikun e tyre të botuar tek “Zemra Shqiptare” - i vetmi që jep një historik të përmbledhur të Armëve të Skënderbeut në Vjenë do të shndërrohej gradualisht ndër vite si akti themeltar ku do të mbështeteshin tërë studjuesit tanë, të cilët nuk arritën një herë të dalin jashtë kornizave të tij.” Me vlerë për shkrimin tonë është edhe fakti se në triptikun e tyre dy studiuesit, teksa kumtojnë se dy shpatat e Skënderbeut që ndodhen në Muzeun e Vjenës nuk i përkasin atij, rikonfirmojnë pa asnjë mëdyshje autenticitetin e përkrenares dhe përkatësinë e saj kastriotase.[4]

Më tej, gjatë viteve të komunizmit, mbishkrimi i përkrenares si pjesë qendrore e ikonografisë dhe heraldikës skënderbejane, siç e propozoi Skiroi, u shmang apo u fshi thuajse fare nga historiografia zyrtare, së cilës nuk i shkonin për shtat lidhjet e heroit me Kishën dhe Papatin e Romës dhe identifikimi i tij si Kampion i Krishtit. Tepër të rrallë qenë ata, si Kristo Frashëri, që përmendën në studimet e atyre viteve për Skënderbeun mbishkrimin e përkrenares. Ky nënvlerësim apo kjo mosnjohje e këtij dimension i të figurës së Skënderbeut - siç shkruan Aurel Plasari - “do t’i nxirrte Gjergj Kastriotin dhe bashkëluftëtarët e tij jashtë “ujrave të vet”, jashtë atij areali që quhej *Europë*...”, e po kështu do t’i hiqte përplasjes së Skënderbeut me Osmanët “sfondin qytetërimor”, të cilit i mvishet pashmangësisht “edhe petku fetar”.[5]




Foto 3

Por le t’i rikthehemi historisë së mbishkrimit dhe pyetjes së mbetur varur prej plot 128 vjetësh: Kush dhe kur e transkriptoi për herë të parë mbishkrimin e përkrenares dhe zbërtheu përmbajtjen e akrostikut në latinisht?

Nga përballja e dëshmive të mësipërme, duket se shkruesi, i lënë anonim, i letrës së botuar tek “Albania” nga Konica, me siguri e ka marrë përmbajtjen e mbishkrimit dhe dekriptimin e tij nga ndonjë përshkrim a diçiturë e vendosur pranë përkrenares, kur ai vizitoi muzeun e Vienës në vitin 1897 ose nga ndonjë dokument shoqërues apo spiegues në dosjen e saj në muze apo edhe nga ndonjë shoqërues a ciceron i pasionuar i muzeut.

Hulumtimet dhe zbulimi nga ana jonë i disa botimeve të panjohura deri sot na çuan 19 vite para Konicës, në zanafillën e shfaqjes dhe burimin e interpretimit të mbishkrimit të famshëm, po në Vienë.

Vjenë, 1878, Ekspozita “Adler”: aty ku lindi dekriptimi dhe interpretimi i mbishkrimit

Zbulimi na u shfaq papritur, por në një formë aq bindëse, aq të dokumentuar e të pacënueshme në vërtetësinë e tij, sa na e bën mjaft të lehtë përcjelljen e tij tek çdo bashkatdhetar që na lexon. Para pak muajsh, në mesin e kërkimeve tona për pasurimin dhe plotësimin e koleksionit të botimeve me interes albanologjik dhe në veçanti të atyre që lidhen me figurën e Skënderbeut, ramë në gjurmët e një botimi përmbledhës, dokumentues dhe përshkrues, i cili në kohët e sotme do të thirrej katalog, rreth një ekspozite heraldike të hapur në Vienë, në prill të vitit 1878. Katalogu me titull “Bericht über die heraldische Ausstellung des Vereines “Adler” (Raport përmbledhës për Ekspozitën heraldike të Shoqatës “Adler”) ka 218 faqe tekst, 39 faqe hyrje dhe 69 faqe të plota me ilustrime, në formatin 32.5 cm x 24.5 cm. (Foto 10,11).

Ekspozita në fjalë u frymëzua nga nisma e Carl Krahl, piktor heraldik i oborrit austro-hungarez, i cili në fund të vitit 1877 ekspozoi përkohësisht disa dorëshkrime heraldike të shek. XVI–XVII në Muzeun e Arteve dhe Industrisë.

Pas suksesit të jashtëzakonshëm të kësaj ekspozite të vogël, muzeu, nën drejtimin e Dr. Jakob von Falke, i besoi shoqatës “Adler” organizimin e një ekspozite të madhe ndërkombëtare mbi heraldikën, gjenealogjinë dhe sfragjistikën. Shoqata “Adler” (Shqiponja), e themeluar më 1870, kishte si synim rigjallërimin e shkencave ndihmëse të historisë dhe të artit kalorsiak. Për organizimin e ekspozitës u ngrit një komitet *ad hoc* i përbërë nga historianë, heraldistë dhe aristokratë të lartë, si:

-Konti Hugo von Abensperg und Traun, kryetar i komitetit dhe president i shoqatës “Adler”;

-Dr. Ernst von Hartmann-Franzenshuld, kujdestar i koleksioneve të Oborrit;

-Dr. Eduard Gaston von Pöttich von Pettenegg, gjenealog i Urdhrit Teutonik;

-Oskar von Sommaruga, jurist dhe thesarmbajtës i ekspozitës;

-Moritz Maria von Weittenhiller, sekretar i përgjithshëm i shoqatës

-Carl Krahl, heraldist dhe ilustrator;

-dhe Wendelin Boeheim, kujdestar perandorak e mbretëror për koleksionin e armëve.

Ekspozita, e inaguruar solemnisht në prill 1878, nën patronazhin e Arqidukës Ludwig Viktor, qendroi hapur për tre muaj. Në sallat monumentale të Muzeut të Arteve dhe Industrisë në zonën e bulevardit Stubenring u ekspozuan mbi 1500 objekte nga koleksione perandorake, urdhra kalorsiake, koleksione private dhe muze evropianë. Ajo u vizitua nga Perandori Franc Jozef, Princi i Kurorës, Rudolfi, Arqiduka Albrecht, Arqidukës Gisele dhe u përshkrua nga shtypi i kohës si “triumf i artit heraldik dhe shkencës historike” (*Die Presse*, 18 prill 1878). Për artin muzeal, ekspozita “Adler” u cilësua si ngjarja më e madhe e këtij lloji në Evropë.

Në katalogun zyrtar të sipërpërmendur përcillet qartë koncepti estetik i saj: ekspozita nuk duhet të dukej si bibliotekë apo arkiv, por si galeri arti, ku estetika e formës të zbulonte historinë e simboleve. Sipas raportit të komitetit, “ditën e çeljes, midis orës 9 të mëngjesit dhe 1 pasdite, numri i vizitorëve arriti 3 541, duke vijuar më tej me një mesatare ditore prej 500, ndërsa të dielave prej 2 000 vizitorësh.” Seksioni i armaturave dhe përkrenareve rezultoi më i vizituar dhe më i vlerësuar.

Pa dyshim që koleksionet e Ambrasit, si ndër më të pasurit e më me vlerë të kohës, do zinin një vend qendror. Mes objekteve të përzgjedhura për ekspozim, siç përshkruhet në katalogun tonë, kuratori dhe kujdestari i koleksionit të armëve të Oborrit Perandorak përfshiu edhe përkrenaren e Skënderbeut, e regjistruar në inventarin zyrtar me numrin 243a.

Kujtojmë se krijuesi i këtyre koleksioneve, Arqiduka Ferdinandi II i Austrisë, është zotëruesi i parë i zyrtarizuar i përkrenares së Skënderbeut, sipas inventarit të koleksionit të tij, që prej vitit 1596, por ai është edhe ideatori dhe porositësi i botimit *Augustissimorum Imperatorum, Serenissimorum Regum...* (1601), më prestigjiozi i të gjitha kohërave, me 125 portrete të perandorëve, mbretërve dhe fisnikëve më të shquar të deriathershëm me veshje luftarake dhe armët e tyre, mes të cilëve, i gjashtëmbëdhjeti, gjendet edhe portretizimi i parë i plotë dhe më i famshmi i Skënderbeut, me shpatë në dorë dhe përkrenaren pranë këmbëve (Foto 12).

Vlera e veçantë e pranisë së përkrenares së Skënderbeut në ekspozitë vihet në dukje edhe nga burime të tjera të kohës me autoritet të lartë në fushën



Foto 6

e heraldikës si Giovanni Batista dhe Goffredo di Crollanza, president dhe sekretar i Akademisë Heraldike Italiane në Piza, që botuan, po në vitin 1878, edhe një reportazh për ekspozitën në revistën e tyre, *Giornale araldico-genealogico-diplomatico*, vëllimi VI (1878–1879), i cili gjithashtu e konsideron përkrenaren e Skënderbeut si një prej objekteve më të çmuara të ekspozitës, teksa shkruan: “Preziosi inoltre sono... l’elmo di Scanderberg col cimiero a testa di becco...” (Të çmuara janë po ashtu...përkrenarja e Skënderbeut me një kokë cjapi në majë...). [6]

Wendelin Boeheim: kuratori që deshifroi mbishkrimin

Wendelin Boeheim (1848–1900), ishte historian dhe kurator i koleksioneve



Foto 7

të armëve të Oborrit Perandorak dhe Mbretëror austriak dhe një ndër themeluesit e hopologjisë moderne. Në Vjenë ai konsiderohej si autoritet absolut për armët kalorsiake të Mesjetës dhe Rilindjes. Në këtë rol ai studioi dhe përshkroi mbi 6.000 objekte dhe armë të këtyre dy periudhave. Në vitin 1890 botoi veprën e tij themelore *Handbuch der Waffenkunde* (Leipzig), që mbetet ende sot një manual referencë për studimet hopologjike në Evropë.

Si kuratori kryesor dhe anëtar i Komitetit *ad hoc* të Ekspozitës, Boeheim analizoi e më pas formuloi interpretimin e parë shkencor të mbishkrimit të përkrenares së Skënderbeut. Në raportin e tij ai e cilëson atë qartësisht si akrostik dhe jo si akronim, duke e përshkruar mbishkrimin jo si titull apo seri titujsh, por si një: “... Art Waffensegen, dessen Gebrauch... ziemlich



Foto 8

allgemein war.”- shkruan ai - “një lloj bekimi mbi armë, përdorimi i të cilit ishte shumë i përhapur për kohën”, për ta tërhequr këtë bekim dhe mbrojtjen hyjnore mbi mbajtësin e armës, për më tepër që titulli “Athleta Christi”, i dhënë Skënderbeut nga Papa i Romës, e mvishte atë natyrshëm me bekimin dhe mbrojtjen e vetë Jezuit.

Kjo praktikë dokumentohet gjerësisht në Evropën e shekujve XIV-XV, sidomos midis princërve, prijësve ushtarakë e kalorësve të krishterë, të cilët vendosnin në armët, shqytet, emblemat e veshjet e tyre e tyre formula si: “*I.N.R.I.*” (Iesus Nazarenus Rex Iudaeorum), “*I.N.D.N.*” (In Nomine Domini Nostri), “*Christus Vincit*”, apo si në rastin e Urdhrit Kalorsiak Kostandinian të Shën Gjergjit të (ri)themeluar nga vetë nipërit e Pal Engjëllit, peshkopit të Durrësit e Drishtit dhe këshilltar e kryediplomat i Skënderbeut, të cilët adoptuan nga heraldika legjendare e Kostandinit të Madh formulën “*I.H.S.V.*” (In Hoc Segno Vincas) (Nën këtë shenjë do të triumfosh).

Kjo traditë ikonografike dhe devocionale e kohës del të jetë adoptuar e përvetësuar edhe nga vetë Skënderbeu, nëpërmjet përkushtimit dhe vetëshpalljes së tij si “Miles Christi” - *ushtar apo luftëtar i Krishtit* - titull cilësues që ai e përdor në letrat e njohura që ka shkruar. Kështu, teksa i drejtohet Papës Kalisti III, Skënderbeu vetëenëshkruhet me formulën:

Ego Georgius Castriotus, Epirotarum Princeps ac miles Iesu Christi, fidem et obsequium Sanctae Romanae Ecclesiae profiteor...

“Unë, Gjergj Kastrioti, Princ i Epirotëve dhe ushtar i Jezu Krishtit, shpall besnikërinë time ndaj Kishës së Shenjtë Romake...” [7]

Në një letër tjetër të mëvonshme, drejtuar këtë herë Papës Piu II, ku Skënderbeu, si një mbret tashmë, kalon nga “Unë” në “Ne” në cilësimin e vetvetes, sërish formula është thuarje e njejtë:

Nos Georgius Castriotus, vulgo dictus Scanderbeg, Christi miles, pollicemur nos ad tuendam Christianam rempublicam promptos semper fore.

“Ne, Gjergj Kastrioti, i quajtur zakonisht Skënderbeg, ushtar i Krishtit, premtojmë se do të jemi gjithmonë gati për të mbrojtur shtetin e krishterë.” [8]

Ja dhe më në fund përshkrimi i parë burimor i dokumentuar i përkrenares së Skënderbeut, së bashku me dekriptimin e mbishkrimit, siç e shkroi Boeheim në raportin e tij (foto 13,14):

“Përkrenare e Gjergj Kastriotit, i njohur edhe si Skënderbeu, Princ i Shqipërisë (1403-1466).

Kjo përkrenare prej hekuri të lëmuar, ka thuarje formën e një djepi, përveç pjesës së sipërme e cila është më e rrumbullakosur. Një rreth i trashë me thumba të mëdhenj është i kapur qark buzës së poshtme, por kjo



Foto 9

duket të jetë një shtesë e mëvonshme. Rreth gjysmës së lartësisë së përkrenares, ka një brez prej flete bakri, zbukuruar me rozeta të praruar, në hapësirat midis të cilave janë gdhendur shkronjat “in.pe.ra.to.re.bt” me shkrim të vogël gotik të vonë.

Në majën e përkrenares gjendet pjesa e sipërme e kokës së një dhie, në bakër të rrahur dhe e praruar, punimi i së cilës flet për një dorë tepër të aftë. Përgjithësisht është sugjeruar që fjala “Imperator” nuk duhet të merret parasysh kur lexohet mbishkrimi, por kjo enigmë nuk është zgjidhur ende. Është tunduese të besosh se kemi të bëjmë me një akrostik, por deshifrimi i tij është i vështirë edhe në këtë rast, sepse mund të hamendësohet se bëhet fjalë për të njëjtin tekst të sjellë në katër gjuhë, dhe ne na mungojnë shumë detaje nga historia e heroit që do mund të jepnin të dhëna për zbërthimin e këtij teksti. Shkrimi, si edhe tingulli i shkronjave, sugjeron një tekst latin, një lloj bekimi armësh, përdorimi i të cilit dihet se ishte mjaft i zakonshëm në kohën e Skënderbeut. Çiftëzimi dhe renditja e çiftshkronjave ngrenë pikëçuditëse, megjithatë, pas një shqyrtimi më nga afër, arrijmë në rezultate të pranueshme. Çdo çift shkronjash tregon thujse drejtpërdrejt titujt e këtij princi, dhe kështu do të lexonim: “Ihesus Nazarenus ¹⁾ Principi Emathiae, Regi Albaniae, Terrori Osmanorum, Regi Epiri BenedicaT”.

(Jezuji i Nazaresë të bekon ty, Princ i Emathisë, Mbret i Arbërisë, Tmerri i Osmanllinjve, Mbret i Epirit.) (varianti ynë)
(Koleksioni Perandorak dhe Mbretëror i Ambrasit, Inv. Nr. 243a.)

Përgatitur nga Wendelin Boeheim,
Kujdestari Perandorak dhe Mbretëror i Grupit të Dytë të Koleksioneve Historike të Artit të Shtëpisë Perandorake.”



Foto 10

¹⁾Në letrat e pakta të njohura prej tij, Skënderbeu përdorte vazhdimisht titullin: Luftëtar i Jezu Krishtit. (Barleti, C. Paganel, Historia e Skënderbeut.) [9]

A i përmbyll ky zbulim i burimit dhe emri autoritar i Boeheim edhe diskutimet mbi saktësinë e interpretimit të propozuar nga ai? Me shumë gjasë, jo! Në historiografinë tonë kanë qarkulluar disa teza që e mbajnë hapur këtë debat, që nga mospasja, “me letra”, nga Skënderbeu i gjithë titujve që i mvishen në interpretimin e Boeheim, deri tek teza, si ajo e Skënder Anamalit, që mbishkrimi është shtuar më vonë nga pasardhësit e Skënderbeut apo edhe vetë hapësira e gjerë interpretative që shpaloset kur gjendemi përballë një akronimi pa dëshmi të porositësit apo gdhendësit të




Foto 11

tij. Edhe vetë Boeheim duket të ketë qenë i vetëdijshëm për pikëpyetjet që do pasonin interpretimin e tij. Në raportin përshkrues, krahas përfundimeve të arritura, ai bën edhe vetëvlerësimin e rezultateve të punës së tij. *Annehmbaren* – i cilëson ai këto rezultate, të pranueshme.

Edhe sot, përkrenarja e Skënderbeut vijon të ruhet në Kunsthistorisches Museum të Vienës, në sallën Hofjagd- und Rüstkammer, e shoqëruar me përshkrimin teknik të marrë nga raporti i Boeheim: “*Helmet with copper gilt band inscribed IN*PE*RA*TO*RE*BT, decorated with rosettes; Ambras Collection, Inv.-Nr. 243a.*”.

Edhe numri i inventarit ka mbetur po ai, që nga koha kur e studioi dhe përshkroi Boeheim, në vitin 1878.

- Referenca bibliografike
- 1 Faik Konica, “Armët e Skënderbeut në Muzeun e Vjenës”, *Albania*, nr. 8, 30 dhjetor 1897, f.122-3
 - 2 Giuseppe Schirò, *Gli Albanesi e la questione Balkanica*, Napoli, 1904.
 - 3 Jaho Brahaj, *Emblema Shqiptare*, Lezhë, 1997, f.73.
 - 4 Fotaq Andrea, Dritan Muka, “Triptik”, www.zemrashqiptare.net, qershor-gusht 2025.
 - 5 Aurel Plasari, *Skënderbeu, Një Histori Politike*, Tiranë, 2010, f. 13-14, 20.
 - 6 Goffredo di Crollanza, “L’Esposizione Araldico-Genealogico-Sfragistica di Vienna”, *Giornale araldico-genealogico-diplomatico*, Pisa, 1879, f. 10-18.
 - 7 Thalloczy & Jireček, *Illyrisch-albanische Forschungen*, II, Wien, 1908, f. 233.
 - 8 Giovanni Domenico Mansi, *Sacrorum Conciliorum nova et amplissima collectio*, t. XXXI, Firenze, 1759, col. 1041-1044.
 - 9 Wendelin Boeheim, “Helm des Georg Castrioti genannt Scanderbeg, Fürsten von Albanien (1403-1466)”, në *Übersicht der heraldisch-genealogisch-sphragistischen Ausstellung des Vereines “Adler” in Wien*, Wien, 1878, f.4.



Foto 12





Foto 13 dhe 14

Shkrimtari i shquar i letërsisë bashkëkohore shqipe Petro Marko dhe vepra e tij letrare në dekadat e fundit, është kundruar nga mjaft studiues, si: Ali Aliu, Rexhep Qose, Fatos Arapi, Agim Vinça, Bashkim Kuçuku, Moikom Zeqo, Xhevahir Spahiu, Ymer Çiraku, Jorgo Bullo, etj., nëpërmjet artikujve dhe mendimit të tyre kritike e letrare, kanë nxjerrë në dritë humanizmin e thellë, ëndrrat e zhgënjyera, fatet dramatike të kohës dhe njerëzve, si dhe horizontet e gjera të botës shqiptare. Me prozën e tij ai u bë një nga individualitetet më të shquara të letërsisë moderne shqipe. Këtë botë të madhe jetësore dhe letrare përcjell në veprën e vet **“Shkrimtari i lirisë”**, studiuesi i talentuar **Behar Gjoka**.

Libri monografik i Behar Gjokës **“Petro Marko-shkrimtar i lirisë”** është një monografi me përmbajtje gati shteruese dhe të thelluar për krijimtarinë e shkrimtarit Petro Marko, (poet, gazetar, përkthyes e mbi të gjitha një romancier i madh i kalibrit evropian). Nga konceptimi i shkrimit të kësaj monografie shkencore dhe nga mënyra e shtjellimit të saj, kuptohet se autori është ndalur gjatë në një punë leximore përpara se ta shkruajë këtë libër, si një vlerë e mirëfilltë e analizës dhe e hulumtimit të vlerave të Petro Markos si njeri dhe shkrimtar.

Një libër i ndarë në kapituj, çështje e nënçështje me synimin e autorit që ta zgjerojë optikën e vështrimit, duke operuar me një gjuhë të zhdërvjellët që parashtron, veçon dhe konkludon e u qaset me mençuri disa tipareve të këtij prozatori të madh si njeri dhe krijues. Ajo që përbën vlerën më të madhe të Petro Markos si njeri-është karakteri rebel dhe guximi qytetar e intelektual për ta thënë të vërtetën në emër të idealit të lirisë së shprehjes dhe lirisë si koncept i gjithëkohshëm filozofik. Petro Marko jetoi në një kohë të vështirë kur mungonte liria, për këtë, ai edhe shkoi të luftonte në Spanjë, në Luftën e Dytë Botërore, pas saj, duke mbetur kështu një luftëtar i madh i paepur, por edhe duke paguar çmimin e guximit dhe të idealit të lirisë. Ndryshe nga mjaft shkrimtarë të tjerë konformistë dhe puthadorë të regjimeve, Petro Marko nuk e shiti muzën e tij i vetëdijshëm se liria është thelbi i artit dhe ajo ta shpërblen sakrificën për të, duke të sjellë kështu pavdekësinë dhe mirënjohjen e brezave të lexuesve.

Nëse do të përkufizonim thelbin e jetëgjatësisë së një letërsie të madhe, atëherë duhet të ndaleshim në karakterin e saj human për të kuptuar sa i thellë është ky, sa i sinqertë dhe çfarë idealesh të lirisë përfaqëson ai. Personazhet e romaneve të Petro Markos të bindin për këtë, ata janë luftëtarë të lirisë kombëtare, internacionale dhe të lirisë së njeriut kundër regjimeve dhe padrejtësive, mbartin në vetvete dëshirën për jetë, për drejtësi, janë antikonformistë, kundër gënjeshtrës, hipokrizisë, thejnë skemat e të menduarit të sipërfaqshëm dhe zbërthehen përmes ndjenjave të sinqerta. Këta personazhe, Petro Marko nuk i sajoi, ai i vëzhgoi nga jeta, u dha mish e gjak nga karakteri i tij rebel dhe i mishëroi me talentin e një romancierit të madh.

Këto përshtypje përfton duke lexuar veprën e tij të madhe, por më së shumti edhe kur kjo vepër zbërthehet nga një kritik, studiues dhe njohës shumë i mirë i veprës së tij, që ka edhe recepturën e percepturën e duhur të trajtesës, siç është Behar Gjoka. Petro Marko në faqet e kësaj monografie shpërfaqet si një intelektual dhe shkrimtar i burgosur në disa regjime-prandaj më shumë se çdo shkrimtar shqiptar ai e ka ditur se çfarë është liria, ndaj liria më e madhe qëndron në veprat e tij. Ajo është liri e jetës që vërshon në to, ashtu siç vjen përmes vuajtjes, përmes luftës dhe përmes ëndrrës së personazheve për të pasur një botë të lirë, të mirë, pa dhunë e pa luftë, një botë të qytetëruar, ku duhet të dominojë e mira.

Studiuesi i mirënjohur Behar Gjoka, qysh në fillim të studimit të tij, e cilëson Petro Markon gazetar i shquar (ai botoi mjaft shkrime në disa gazeta të kohës, por edhe i drejtoi ato), por edhe një poet të viteve 1930, si dhe një urë lidhëse e shkrimtarëve të viteve '30 me letërsinë bashkëkohore. Edhe pse, në letërsinë e re të pas Luftës së Dytë Botërore, ai nuk u rendit në emrat e tribunave letrare që shpallte kritika zyrtare e kohës, ai nuk u hoq kurrë nga kujtesa e lexuesit, nga interesimi i rretheve letrare jashtë kësaj kritike euforike, nga mendimi i përgjithshëm i letërsidashësve, se ai ishte një shkrimtar i pëlqyer dhe se romanet e tij që dilnin përbënin një ngjarje letrare dhe një gëzim estetik për lexuesit, pavarësisht se kritika zyrtare heshtte.

Studimi i Behar Gjokës -mbi poezinë e Petro Markos, mbi vargun e tij të matur dhe të lirë, mbi “portretizimin” e fjalës si “një bard i kohëve moderne” mbi dramat dhe tregimet e tij, ndërtohen duke sjellë çështje të trajtesës me profesionalizëm e mençuri, që synojnë paraqitjen e plotësisë ideore dhe estetike të tekstit krijues të Petro Markos në këto zhanre letrare. Kritika dhe studimi i Behar

“Petro Marko - shkrimtar i lirisë” - një monografi studimore e Behar Gjokës

Prof. dr. Bardhosh Gaçe

Gjokës është një qasje e epërme ndaj vlerave tekstore të veprës së Petro Markos, ku ai ndalet me imtësi dhe maturi në arritjet estetike dhe artistike që realizojnë peshën e vargut të bukur të poezisë së tij. Po kështu, mjaft mendime të studiuesit mbi dramat e Petro Markos japin informacion dhe krijojnë këndvështrime të kujdesshme mbi sqarimin e elementeve kompozicionalë të këtyre dramave, mbi tensionin dramatik që, sipas studiuesit, shkon deri në “drama me elementë tragjike”.

Monografia letrare e Behar Gjokës mbi shkrimtarin Petro Marko është një monografi që synon pikërisht gjykimin mbi tekstin e shkruar të këtij shkrimtari dhe mbi vlerat artistike të veprës së tij, pa përjashtuar sfondin kohor, idetë e tij apo idetë e autorit të shfaqura e të materializuara në veprën e tij. Dhe ky synim është realizuar me një afrim profesional, ndërsa dalin në pah së pari vlerat e artit të madh të Petro Markos në poezi, drama, tregime, romane për fëmijë (“Fantazma e plani tre plus katër” dhe “Shpella e piratëve”) e sidomos në romanet e tij të shquara, vepra fundamentale të prozës shqipe bashkëkohore.

Analiza e thellë dhe e kujdesshme që Behar Gjoka u bën romaneve të Petro Markos tregon për njohje shumë të mirë të tekstit letrar të tyre, por edhe pikëtakimet që ato bëjnë me romane të letërsisë së Brezit të Humbur, meqë Petro Marko jetoi Luftën e Dytë Botërore. Në romanet e tij me temën e Luftës (“Hasta la Vista” dhe “Nata e Ustikës”), zakonisht kemi një shqiptar dhe një vajze të huaj (spanjolle te “Hasta la vista” dhe sllovene te “Nata e Ustikës”) me të cilën bie në dashuri protagonist shqiptar po këtë dashuri e gjymton lufta dhe tmerret e saj.

Petro Marko e afron me shkrimtarët e “Brezit të Humbur” përshkrimi i tragjedisë së luftës, por jo humbja e shpresës edhe pse këto tmerre çojnë deri te ky perceptim. Dhe, me talentin e dashamirësinë e tij, arrin tek ideja, se popujt duhet të ngrihen mbi luftën, mbi ndarjet apo kufijtë, (ideja e vëllazërimit të popujve përballë ployës shfarosëse fiton gjithnjë një theksim aktual sa herë shfaqen retë e zeza të kërcënimeve dhe të luftërave). Autori në këto romane pasqyron elementë të biografisë së tij, çka është e natyrshme, sepse si luftëtar i Brigadave Internacionale, ai ka jetuar vetë këto ngjarje, por romanet e Petro Markos



ngrihen mbi këtë rrafsh artistikisht e nga ky rrafsh si material faktik e jetësor e inspirim krijues.

Studiuesi Behar Gjoka shtjellon me imtësi linjat e këtyre romaneve për të treguar jetën e gjerë dhe pikëtakimet ideore të personazheve, ecjen e tyre në jetë dhe përfaqësimin e tyre në nivel ideoartistik. Pastaj ndalet në narrativen e prozës romanore të Petro Markos, ku rrëfimi autorial fiton njëfarë distance nga ngjarjet, duke vënë re me të drejtë se në shtjellën narrative të Petro Markos futet edhe rrëfimi i rrëfimeve, çka si konstatim i gjetur me mprehtësi, sipas studiuesit, i jep veprës dhe tekstit të saj shtjellimin e rrëfimit modern.

Me të drejtë studiuesi i quan këto vepra romanore “tekste të hapura” për nga forca e ëndrrës dhe e dëshirës, për nga pesha specifike e shtratit jetësor që zgjerohet, nga mundësia, përvoja dhe aftësia e Petro Markos për ta njohur jetën, për ta prekur atë si shkrimtar në çdo qelizë të saj dhe për ta transfiguruar artistikisht. Kjo, pa mëdyshje, i ka siguruar tekstit të tij romanor një jetëgjatësi ndër lexues dhe mendimin e përgjithshëm se romanet e tij, të strukturuara përmes dhe nëpërmjet një hapësire të gjerë jetësore, e mishërojnë atë jo vetëm me një arkitekturë moderne, por edhe me personazhe të gdhendura artistikisht, që jetojnë brenda shqetësimeve të njeriut të çdo kohe, pavarësisht nga ndryshimet kohore në regjime apo mendësi.

Petro Marko i theu konvencionet ideologjike të kohës, çau pritrat e rreziqeve përmes nënvizimit të humanizmit edhe aty ku këtë nuk e lejonin rrethanat kohore, etiketimet e rrepta ideologjike, dhe kjo duket më mirë te romani i tij-kryevepër *“Qyteti i fundit”*. Ky roman ngrihet mbi konceptet e ngurosurat ideologjike, mbi paragjykimet, dhe shënon një vepër humaniste me vlera të larta, dëshmi e një kohe dramatike, ku dashuria e toger Lekës me një prostitutë arrin të na japë linja lirike-dramatike të përshkruara me mjeshtëri.

Studiuesi sjell në trajtesën e tij me kompetencë përngjasime me Heminguejn (“Lamtumirë armë”), me Remarkun (“Harku i Triumfit”) për sa i përket dashurisë së dy të rinjve në luftë ose në mbarim të luftës, po kështu edhe në kohën letrare (në romanin “Qyteti i fundit” koha zhvillohet në shtatë ditë). Sipas studiuesit Behar Gjoka, Petro Marko në këtë roman e shmangu rrëfimin linear, *“patetizmin dhe optimizmin që shoqëron modelin e romanit të metodës së realizmit socialist të asaj kohe”*. Ky është një vlerësim mjaft i drejtë dhe i spikatur i studiuesit, bazuar në analizë teksti, duke e sjellë mënyrën e trajtesës së këtij romani në një pikëvështrim kohor, por edhe të vlerave gjithëkohore si roman modern për nga mënyra e konceptimit dhe e rrëfimit. Studiuesi e quan gjithashtu rrëfimin e Petro Markos “magji” dhe jo vetëm në këtë roman.

Një hulumtim serioz dhe një prekje të shtjelluar me kujdes i bën studiuesi edhe romanin *“Ara në mal”*, ku paralelizmat e kohëve dhe thyerjet kompozicionale sjellin një teknikë tjetër në natyrën e narrativit të madh Petro Marko. Studiuesi analizon gjithashtu edhe pentagramin



rrëfimor të autorit dhe shikon edhe pikëtakime rastësore me romanin *“Njerëz të pavarur”* të Halldor Llaknes. Prania e personazheve të romaneve të Petro Markos është e fuqishme, sepse ata përgjithësisht formëzohen dhe jetojnë në rrethana të zgripit ekzistencial, ata vihen para provave të vështira, nuk janë të njëtrajtshëm në trajtim, përkundrazi. Edhe në trajtesën për romanin *“Nata e Ustikës”* (variant i parë dhe *“Një natë e dy agime”*-varianti i dytë i këtij romani – autori ndalet me një tjetër vështrim për këtë roman, duke e quajtur *“një tekst të sinkretikës letrare”*.

Analizat e kujdesshme të Behar Gjokës sjellin gjithashtu aftësinë e tij hulumtuese dhe zhbiruese duke matur mirë pulsën jetësor të këtyre romaneve deri në regëtimat më të pandjeshme të hovit shpirtëror të personazheve, si dhe dëshmojnë edhe njohuritë e tij për veprat e tjera letrare të autorëve të ndryshëm, gjë e cila i ka dhënë atij mundësinë që teknikisht të zbulojë veçoritë narrative-kompozicionale të çdo romani, duke sjellë kështu idenë e nënkuptuar se Petro Marko i shkruante romanet e tij, duke kërkuar gjithnjë teknika të reja të rrëfimit, të kompozimit e duke sjellë në ta diçka të re për sa u përket këtyre teknikave. Kjo e shënon atë si një romancier të madh që kërkon vazhdimisht forma e mënyra të reja pasqyrimi, gjë të cilat Gjoka i paraqet në shqyrtimin e tij në mënyrë bindëse edhe si formulime, edhe si shembuj konkretë.

Kjo shihet edhe në trajtimin që ai i bën romanit të këtij autori *“Një emër në katër rrugë”*. Këtë roman studiuesi e quan roman i kohës së projektuar dhe gjithashtu tregon kalvarin e kësaj veprë letrare, bllokimin dhe heshtjen zyrtare ndaj saj, për aludimet e forta narrative dhe shenjzimet kuptimore të thekura e hithëruese. E gjithë krijimtaria në prozë e Petro Markos, si në këto romane edhe në romane të tjera, përbëhet, sipas studiuesit, nga uni i fortë autorial, me ngjarje plot dinamizëm dhe me një temporitë rrëfimor dhe aftësi kompozuese të jashtëzakonshme, që dëshmon vullën e thellë të një autori modern, që i ka rezistuar mrekullisht kohës së leximit apo vlerës së horizontit të pritjes dhe mbetet gjithnjë i freskët dhe i dashur për lexuesit.

Gjithë këto analiza të mirëfillta letrare, duke kapur e shtjelluar veçori tematike dhe strukturore të veprës së Petro Markos, të çojnë vetiu tek titulli i librit: **“Petro Marko-shkrimtar i lirisë”** (një lajtmotiv sa poetik aq arsyetues) dhe kjo jo vetëm në aspektin e jetës së lirë që bëri autori, por duke u dhënë liri mjaft koncepteve të tij në mënyrën e trajtimit të tyre, në krijimin e një bote artistike, dramatike dhe vezulluese për sa i përket njomështisë dhe mbushullisë së artit. Petro Marko me jetën e tij prej një njeriu të lirë dhe rebel, u bë shembull i shkrimtarit që nuk shkroi ekskatredra, por atë që jetoj, ai e shkroi, jo thjesht si biografi personale, por me artin e tij arriti t’u japë romaneve të veta një tharm të fuqishëm artistik dhe filozofik.

Vlerat artistike dhe estetike të krijimtarisë së Petro Markos, ngjizen me filozofinë e lirisë dhe filozofia e lirisë në shumëkuptimësinë e saj zgjerohet me kuptimin se për lirinë duhet të jesh edhe luftëtar i saj dhe nuk është rastësi që disa protagonistë kryesorë të romaneve të tij zbërthehen si alterego e autorit. Ndaj nuk është rastësi që studiuesi Gjoka e përmbyll monografinë e tij shkencore me librin jetëshkrimor **“Retë dhe gurët”**, një autobiografi interesante me modelin e arrirë të saj që të kujton “Autobiografinë” e De Radës, të Nolit po edhe sa personaliteteve të tjera të artit botëror. Dihet se autobiografitë e të mëdhenjve nuk janë thjesht rrëfime personale, por rrëfime të singërta dhe zbërthime të raporteve të caktuara të njeriut të shquar me kohën.

Aty zbërthehen edhe disa rrethana apo motive jo thjesht rastësore që kanë ndikuar në formimin e Petro Markos si shkrimtar i madh dhe që i kanë dhënë shtysën në shkrimin e romaneve të tij. Aty tregohet se si arti i Petro Markos nuk iu përshtat guaskës së intimitetit lëngues, konformizmit dhe paraparjes së rreziqeve, por lindi si art i lirë, i mëvetësuar dhe i pandikuar nga ngjashmëritë, një art origjinal, sidomos në lëvrimin e romanit, duke e shënuar atë e duke e renditur në radhën e romancierëve kryesorë të Shqipërisë.

Libri monografik i Behar Gjokës **“Petro Marko-shkrimtar i lirisë”**, krijon një panoramë të gjerë dhe të thelluar mbi veprën e një shkrimtari të madh, afron një urë të re për të ecur më shpejt drejt veprës së këtij shkrimtari, gjithashtu, është model i analizës profesionale, ku arsyetohet në mënyrë bindëse dhe zbërthehet në të gjithë treguesit kuptimorë dhe artistikë vepra e një shkrimtari me potencial të jashtëzakonshëm të rrëfimit modern, të gdhendjes së personazheve e të krijimit të situatave lirike-dramatike, ku forca dhe filozofia e jetës i paraprin mendimit krijues dhe mendimi e lartëson veprën e tij natyrshëm dhe me hijeshi artistike të admirueshme, duke lënë gjurmë të thella në pasurimin e prozës moderne shqiptare.


Vlorë-Tiranë, maj 2025.

Malësorja që jetoj 106 vjet

DADA MEREME!

Nga Zylfi Tola

Babë Muharrem, por edhe nëna Fidaije, tregonin se Meremja, vajza e tyre kishte lindur një javë para se të shpallej shtet më vete Shqipëria ku ende këndej kishte turq e zaptues të tjerë. Përsa i përket muajit, ka qenë i dyti i vitit, por edhe mesi i tij, pra rreth e rreth, pak dhe me hamendje. Meremja pati si datëlindje 16 shkurtin e vitit 1906, që prindërit e saj s’e lëvizën as poshtë dhe lart, për kaq e kaq mote sa jetuan në fshatin e tyre të largët. Meremja që bijë e fisit Cara, në katundin Lusën, mes shpateve, kepave, bjeshkëve dhe pyjeve. Në historinë e saj ka shumë ngjarje, të ashpra dhe të lavdishme. Këtu lindi një nga burrat e e shquar, trim i sertë, prijës popullor Ramadan Çejku që së bashku me malsorët e Ujmishtit, Reskut dhe të fshatit të tij i dolën para serbit gjakatar me pushkë, çfurgje, hanxharë, gurë dhe e bënë copa copa, që kafshët e shpendët e egra disa ditë trupat e tyre i patën ushqim kryesor. Meremja e Carëve, cuca e tyre u rrit si zanë mali në këto brigje e shpate, herë me lopë, herë me shoqet duke mbledhë tufa me lule, e herë me nënën Fidaije, duke udhëtuar në stan e bjeshkë, atje lart të fusha e Theknës e Qafa e Gurit. Ajo pati një trup të gjatë plep, flokët rreth e rreth dhe dy sy që nxirrnin dritë dhe shkëndija me ngjyrë ari. Ani pse ende e vogël, furkën me leshin e deleve rude nuk e shkëputi asnjë herë nga duart. I thurte fanele, doreza, çorape për vete e gjithë familjen. U rrit, e shkathët dhe e bukur, që do kishte zili dhe merak çdo familje, çdo djalë për nuse e shoqe jete. Fillun të kërkojnë e dërguar shkues në të gjithë fshatrat e Ujmishtit, Bushtricës, Grykës së Çajës, Kalasë Dodës, por Muharrem Cara nuk mund ta fejonte do si do cucën e tij. Edhe nënës, Fidaije i qante zemra, që Meremës t’i jepte për burrë që që të mos e kishte krahina. Por në këtë jetë nganjëherë kismetin e fatin nuk mund ta ndali as qielli dhe toka. Me ndërhyrjen e disa miqëve dhe nipave dhe pëlqimin e tyre, Meremën e fejojnë në fshatin Resk me Baki Ademin. Këtu ndikoi edhe afërsia, kufi me Lusnën, që vajzën e vetme ta kishin sa më afër, një pëllëmbë larg tyre. Ka qenë viti 1924 që e mbanin mend edhe Bakiu por dhe Muharremi për atë dasëm, mes lodrave dhe curleve dhe këngëve. Meremja pati përgatite me duart e saja, si pajë e zakoneve të Lumës, një qilim që i patën mbetë duar mbi të për ta ba sa më të bukur e më shumë ornamented me ngjyra, dy sixhade, po edhe ato me dy duart e një vajze lumjane të këndeshme dhe plotë dritë. Tani Meremja, vajza nga Lusna, por dhe bijë e Carëve, në Resk fillon një jetë tjetër. Është nuse, në derë të huaj, nga ajo kërkohen shumë gjëra, pastërtia në familje, sistemimi e fshirja e odave e oborrit, zgjimi herët kur të gjithë ishin pushim e flini, lidhja e qenit, etj, etj. Baki Ademi, sic thirrej në emrin e babës, që një djalë e malsor i bukur me peshë. Ca kohë, para dhe pas martese që xhandar, pastaj me shumë shokë, miq, nipa dhe mbesa. Që dhe trim, një derë e odë mikpritëse. Shtëpia e tij, aty në krahun e djathtë të rrugës Prizeren, Lumë e Dibër pati përcjellë e mbajtë sa e sa udhëtarë me kuaj e halle të shumta. Gjithashtu Bakiu që nip Surroj, te Sali Vata, urugani i tuneleve anë e kënd Shqipërisë



dhe një nga të parët “Hero të Punës Socialiste” të epokës socialiste.

Pas disa kohësh, Bakiu u nda nga vëllezërit, Hani dhe Veseli, krijoi familjen e ekonomin e vetë, si gjithë malsorët e Reskut. Në këtë fshat në shpatet e Drinit të Zi që në 1947 u nis Rruga e Rinisë, Kukës-Peshkopi, Mermja përcolli e jetoj shumë ngjarje, diku të gëzuara e shumë të tjera të dhimbëshme, duke veçuar disa vëllavrasje për tokën, pyllin, fjalët, ngatërresat, etj. Nuk harronte tri cucat partizane, që e gjetën duke mbushur ujë të kroi aty mes pemëve e luleve. U dha ujë, rrush, arra e molla dhe të tria e përqaftuan me mall si nënën e tyre. I treguan dhe nga ishin, krahinat dhe qytetet, por në mbrëmje Bakiut i tregoi edhe për partizanët, por vendlindjet e tyre i kishte harruar. Bakiu qeshi dhe i tha se shumë herë ke qenë budallë. Ka qenë atëherë shtatori i 1944 dhe një brigadë partizane vinte nga Kalaja e Dodës për në Kosovë, i thanë vajzat e e armatosura, të bukura e trime

Në vitin 1930 Bakiut dhe Meremës u lind një vajzë, dhe e pagëzuan me emrin Rrahime. Dëshirë kishin që shtëpinë ta mbushnin me djem dhe vajza, por kismetin dhe nafaka i lanë gjithnjë vetëm me cucen, . e rriten si një lule mali, si një fëmijë të vetëm dhe të veçante. Kur flinin të dy bashkëshortët, tregonte Meremja, e fusnin cucen në shtrat mes tyre, dhe natën e puthnin herë njeri e herë tjetri. Vajza e tyre tani është rritur, në moshë e mendime, është pjekë, sic e thonë në malësi. e kërkojnë gjithandej në Reç dhe Dardhë të Dibrës, në Has e Malzi, tejpertej Lumës. E pas shumë përzgjedhjeve, e fejojnë në Buzemadhe, në një fis dhe derë të njohur për Hysen Ramadanin, një djalë xhevahir dhe yll i vërtetë. Në 1949 Rahimja martohet, dhe Baki Adem Gjoka e përcolli vajzën e vetë në një dasëm që nuk kishte bërë vaki në ato vise. Atë ditë edhe zogjtë e maleve e patën si festën e tyre. Tani dy pleqtë mbeten të vetëm, një jetë e zbehtë, pa zhurmë, pa këngë, me shumë brenga e halle. Ne vitin 1971 Bakiu vdes, që i kishte kaluar disa dekada në këtë botë. Meremja mbetet e vetme në shtëpi qyqe a me lopën, viçin e saj, qenin dhe disa pula, e paharruar macën laramane. Tregonin në Resk se Meremja e kishte si askush burrin e saj, duke prish edhe zakonin e adedet, se gruaja nuk e vajton bashkëshortin. Pesë vite mbeti si qyqe mali, por Bakiun e saj, asnjë herë s’e harroi dhe mbi varrin e tij, si askush tjetër, buqetat me lule ishin të përherëshme. Në Buzemadhe Rahimja, vajza e tyre, kishte lindur dy djem dhe plus dy vajza, Naimin, Feritin, Hasiyen dhe Fllanxen. Së bashku me nënën e tyre vendosën që gjyshe Meremen ta marrin përgjithmonë në familjen e tyre. Tani Mereme Cara, por edhe Gjoka ishte banorë në Buzemadhe, në atë fshat matane prapa maleve, ku përcolli mbi 20 vite të jetës së saj. Te nipat, por edhe në fshat gjeti një ambient shumë të ngrohtë. Të gjithë e respektonin, e ftonin në dasma dhe gëzime, vajzat dhe nuset e merrnin në valle, për ta nderuar si bijen dhe nënën e tyre. Të gjithë edhe fëmijët e shkollës e thirrnin herë dada Mereme, tezja Mereme, halla Mereme, nana Mereme, gjyshja Mereme, motra Mereme. Këto fjalë të arta i shtonin jetën, por ende e fortë, çdo mëngjes ecte dhe dilte të kodra e Mance, vështronte bjeshkët, kodrinat, pyjet, por dhe kujtonte edhe Lusnen e Reskun, vendlindjet e saj. E la amanet që kur të vdes të varroset pranë Bakiut, atje në Resk. Për dy ditë më 27 dhjetor 2012 i tha lamtumirë kësaj bote, si askush, e rrallë duke lanë pas emrin e saj të çmuar, brilante e të paharruar. E përcollën për në atë botë, qindra banorë matane e këndej Drinit, në të gjithë viset e Lumës e Kukësit.

Ky është botimi i dytë i këtij libri. Botimi i parë ka dalë para dy vitesh, në vitin 2023, por, me sa di, nuk ka ardhur në Kosovë. (Hapësira e përbashkët kulturore shqiptare, për të cilën flasim e shkruajmë tash 35 vjet, ende nuk funksionon sa e si duhet, aq sa mund të thuhet, duke lënë mënjane frazeologjinë, se ne, si në Tiranë, ashtu edhe në Prishtinë, në disa segmente, vazhdojmë të bëjmë jetë paralele).

Libri i profesor Sherifit, botimi që kemi para vetes, hapet me një parathënie të profesor Ethem Rukës dhe mbyllet me dy tekste në formë pashënieje me autorë Naim Zoton dhe Agron Xhagollin.

Të tre këta autorë, secili në mënyrën e vet, flasin për vlerat dhe rëndësinë e këtij libri. Profesor Ruka, duke vlerësuar punën e kolegut të vet, e quan librin manual mbi dollinë si “kod shpirtëror të sofrës shqiptare”, duke shtuar se ky kod, si çdo kod tjetër në botë, ka rregullat e veta, ashtu siç ka edhe hierarkinë e vet, që nuk e cenon në asnjë rast nderin e të tjerëve. Publicisti Naim Zoto, që është edhe njëri nga redaktorët e librit, nënvizon se ky libër do të mbetet referencë e pashmangshme në studimet për institucionin e mikpritjes te shqiptarët (f. 305). Ndërkaq, studiuesi i folklorit, dr. Agron Xhagolli, duke e zëbërthyer përmbajtjen e gjerë të këtij libri, thekson se ai përfshin të gjitha elementet e institucionit të dollisë, siç janë: dollibashi ose kryetari i sofrës, pritësi i dollisë ose sekretari, saku ose shefi i protokollit, pastaj ngritja e dollisë, numri i shëndeteve, shprehjet: “Të kam gjetur!” dhe “Të kam pritur!”, radha e dollive, bejtet që i shoqërojnë ato, duke dalluar dy lloje dollish, dollinë e vjetër ose tradicionale dhe dollinë e re ose moderne, të quajtura ndryshe edhe autoritare dhe liberale.

Që të tre autorët e përmendur e cilësojnë këtë libër si të veçantë, si për temën që trajton, ashtu edhe për mënyrën si e trajton atë. Tema tërheqëse, përmbajtja interesante, herë-herë edhe zbavitëse; koherenca metodologjike dhe shprehja elokuyente, e bëjnë këtë vepër jo vetëm të veçantë, por edhe unike.

Duke mos dashur t’i përsëris ato që kanë thënë kolegët e mi, unë do t’i qasem këtij libri nga një aspekt tjetër, duke e vështruar në radhë të parë nga aspekti letrar. Në ç’kuptim?

Duke qenë pjesë e traditës shpirtërore të popullit shqiptar, fenomeni i dollisë është i pranishëm në letërsinë shqipe, sidomos në poezi, kurse libri i profesor Bundos, me gjuhën dhe stilin e tij, ngjan si të ishte shkruar nga ndonjëri nga shkrimtarët më të mirë bashkëkohorë shqiptarë, edhe pse autori i tij është ekonomist me profesion. Atë që s’e kanë bërë etnografët dhe folkloristët tanë e ka bërë njeriu që ka specializim të vetin financat.

Por, para se të shkojmë te letërsia, të ndalemi pak te gjeneza e dollisë si fenomen etnokulturor dhe shtrirja gjeografike e këtij fenomeni.

Për mua nuk që befasi libri për dollinë, sepse këtë libër pata kënaqësinë ta marr me dedikim nga autori në muajt e verës, por e pranoj se tre librat e tjerë, që më ranë në dorë në prag të festave të nëntorit, më befasuan jo pak. (Edhe pse kohë e shkurtër, gjatë këtyre ditëve arrita të lexoj pjesë edhe nga këto tri vepra, për të cilat do të flasin kolegët e mi).

I vura titullin *Një monument i gjallë etnokulturor* këtij shkrimi, sepse dollinë dhe vlerat tona të tjera identitare, nuk duhet t’i lëmë të vdesin.

Dollia hyn në rendin e vlerave me të cilat ne si komb mund të mburremi para botës. (Të tilla, për mendimin tim, janë edhe eposi, lahuta, polifonia, xhubleta, fustanella, Kanuni i Lekë Dukagjinit etj.). Riti i dollisë është traditë e lashtë, që nuk dihet ku dhe kur ka lindur. Autori shtron pyetjen: “Kush e shpiku dollinë dhe ku u shfaq ajo për herë të parë?” dhe përgjigjet: “Askush nuk mund të japë një përgjigje se kur dhe ku. Një gjë është e sigurtë se autori i saj mund të ketë qenë një skraparli, një përmetar, një mokrar, një lab, një mallakastriot, një piluriot, një himariot a ndonjë kolonjar. Ajo lindi, u laurua dhe u pasurua në sofrat e këtyre trevave”, për të ardhur në përfundim se dollia është fenomen i “Jugut të Shqipërisë”.

Konkluzioni është i drejtë, por jo edhe i plotë, sepse dollia haset edhe jashtë territorit të Shqipërisë si shtet: në viset shqiptare në Maqedoni, në Strugë, Prespë etj., në ato që i kanë takuar Vilajetit të Manastirit. (Unë jam rritur në një mjedis ku ekzistion riti i dollisë dhe ende ruaj në kujtesë disa relikte të kësaj ceremonie, që, në kushtet e reja të jetës, të ndryshimeve rrënjësore socio-kulturore, po zhduket dhe sterkeqet).¹

Profesor Bundo përmend diku (f. 215) “fshatrat e zonës së Resen-it (Maqedoni e Veriut”). Zona quhet Prespë e jo Resen. Edhe liqeni quhet i Prespës. “Resen-i” (shqip Resnjë) është qendra komunale, një qytezë pa asnjë rëndësi nga pikëpamja etnografike.² Fshatrat e Prespës janë vazhdim i Kolonjës, që kanë mbetur jashtë Shqipërisë për shkak të ndarjes së tokave shqiptare në Konferencën e Londrës, ashtu siç mbeti edhe

1 Struga është zonë ku takohen dy kryedialektet: gegërishtja dhe toskërishtja. Është e kuptueshme që në fshatrat toske të jetë i pranishëm riti i dollisë, por ai nuk mungon as në katundet geqe si Veleshta ime dhe fshatrat e tjera rreth Drinit të Zi, sepse afërsia gjeografike, kontaktet e përditshme dhe martesat e ndërsjella e kanë bërë të vetën.

2 Besoj se kolegu dhe miku im profesor Sherifi në një botim të ardhshëm do ta korrigjojë këtë lëshim të vogël.

Sherif Bundo, *Dollia shqiptare, institucion shpirtëror i mikpritjes*. Monografi. “Mediaprint”, Tiranë 2024

NJË MONUMENT I GJALLË ETNOKULTUROR

Nga Agim Vinca

Kosova me vise këndej kufirit të ’13-s.

Sa i përket Kosovës, në Kosovë nuk njihet dollia, por Kosova e ka odën, odën e burrave si institucion, që ka luajtur rolin e një universiteti popullor në edukimin e njerëzve. Të themi, à propos, se janë bërë studime për odën dhe rolin e saj, por mungon një libër si ky i shkruar me stil letrar dhe shkencor njëkohësisht.

Dhe tani t’i kthehemi temës: raportit dollia-letërsia, por edhe vetë veprës, që paraqet një simbiozë letraro-shkencore. (“Për ta përjetuar emocionalisht dollinë, ajo duhet njohur”, f.18).

I pata shkruar autorit verën që shkoi një mesazh, në të cilin citoja një thënie që e konsideroj shumë të rëndësishme për dollinë dhe funksionin e saj. Tani kujtoj se është rasti ta them në mënyrë pak më të plotë.

Kur vdiq Fan Noli, në mars të vitit 1965, në mesin e shkrimtarëve që u prononcuan për këtë humbje të madhe, qe edhe Mitrush Kuteli. Duke vlerësuar lart personalitetin e Nolit dhe kontributin e tij të madh në fusha të ndryshme të jetës, Kuteli evokonte një kujtim që flet për respektin që gëzonte Noli në popull.

“Nga ky ballkon (nga ballkoni i ndërtesës atëherë më të lartë në Pogradec – A. V.) foli Fan Noli më 1923, një të enjte, ditë pazari. Pazari ishte plot me fshatarë të zbritur nga Mokra e të ardhur nga fusha. Edhe me vendas. Njerëzit e shikonin të habitur. Ç’është kjo punë? Fan Noli është despot. Despoti flet në kishë. Po ky i përmbys të gjitha. Flet nga ballkoni në mes të pazarit. Jo për çështje feje, po për punë politike. Godet me guxim të pashëmbullt sundonjësit, bejlerët. Flet për një Shqipëri të re, të vegjëlisë. Kështu e mbaj mend për herë të parë, atë që kaloi si një meteor i ndritur nëpër errësirën e asaj kohe. Bota u nda më dysh: duallnë njerëz të shumtë që i thoshnin vetes ‘fanolistë’. Dhe këta shtoheshin dita ditës. Në Mokër filloi të pihet dollia për shëndet të Fan Nolit”³

Fjalja e fundit: “Në Mokër filloi të pihet dollia për shëndet të Fan Nolit” është një thënie me domethënie të madhe së paku për tri arsye. Një, pse vjen nga një zonë që mund të quhet njëra nga vatrat e dollisë si traditë dhe si rit, nga zona e Mokrës; dy, pse i dedikohet njërës nga figurat më të mëdha të historisë dhe kulturës shqiptare, Fan Nolit dhe, e treta, ndoshta kryesorja në këtë rast, sepse shqiptohet nga një njohës i shkëlqyer i traditës shpirtërore shqiptare, Mitrush Kuteli, që e ka sublimuar

3 Mitrush Kuteli, *I falem kujtimet të Fan Nolit*, në librin *Ndër bashkëkohësit*, Rilindja, Prishtinë 1968, f. 215.

në mënyrë mjeshtërore këtë traditë në veprën e tij letrare. (Mjafton të kujtojmë tregimin antologjik *Fshati im e pirakinë*, të përkthyer dhe komentuar edhe në gjuhën frënge).⁴

Emri i Omar Khajamit dhe shqipëruetit të tij, Fan Nolit, dalin dendur në këtë libër, gjithnjë në funksion të kultit të verës dhe dollisë, por edhe të gëzimeve të jetës, gruas, dashurisë. Noli e futi fjalën dolli në katrenat e poetit të famshëm persian, të quajtura rubai. “*Këndo natë e ditë e zbraz Dolli... / Se nesër vdekja vjen*” etj. (f. 264).

Nuk mund të mungonte në një libër si ky, emri i dollibashit të poezisë së sotme shqipe, të themi kështu, poetit Dritëro Agolli. Dritëro si njeri dhe poet e njihte mirë traditën shqiptare të mikpritjes, pjesë e së cilës është arti i dollisë. Ai solli në poezinë shqipe figurën e heroit lirik, që pi raki me filxhan dhe ngre dolli për shëndetin e njerëzve, të bimëve dhe të kafshëve, por edhe për shpirtin e gjyshërve dhe për brezat që vijnë. Citohej strofa e vargje ku lartësohet miku dhe miqësia, pa lënë mënjane as cilësinë e rakisë. “*Unë pi me gotën plot raki Skrapari dhe raki Përmeti*”, shprehet poeti, që kishte mësues shpirtërorë Bërsnin dhe Naimin. Bardi skocez Robert Bërsn shkruante baladën për Xhon Kokërr Elbin, kurse poeti ynë kombëtar, Naim Frashëri, vjershën *Ujë e bekuarë*, ku thotë se vera dhe rakia janë bekuar nga Perëndia, prandaj: “Jakëni, shokë, të rrimë./ Rreth druvezës’ e të pimë...”. (Shikoni sa larg është Naimi nga mendjet fanatike të kohës sonë).

Një poet tjetër i kësaj provenience, Xhevahir Spahiu, autor perlash poetike si *Borxhet e mia* dhe *Kënga e dalldisur*,⁵ në një poezi tjetër me titull *Letër xhaxhait tim Ali*, shkruan: “*Xhaxha, / flas me ty si me një këngë të vjetër:/ A ke zier raki?/ Ke zier, patjetër./ Më dërgo me njeri një shishe, po munde: ballkazani, / kuptohet./ Do ta pi me një frymë/ si të qeshë ezhderhë - / dhe do them veç dy fjalë naimiane:/ Të paça, xhaxha!*”⁶

Fjala “të paça” ka një mori kuptimesh në gjuhën shqipe. Profesor Bundoja analizon në gati dy faqe tekst, ndjenjat, kuptimet dhe mesazhet (“një mal me mesazhe”, si thotë), që përmbledh kjo shprehje, e cila haset rrallë në ndonjë gjuhë tjetër të botës, ashtu sikurse edhe vetë mënyra dëshirore e foljes, të cilën ne, në të folurit tonë, nga dita në ditë po e amputojmë.⁷

I bindur se ky libër është me interes edhe për të huajt që interesohen për Shqipërinë dhe shqiptarët, autori ka bërë një version të shkurtuar të librit të tij në katër gjuhë: shqip, frëngjisht, anglisht dhe italisht, në funksion të përfshirjes së këtij thesari në trashëgiminë kulturore botërore nën kujdesin e UNESCO-s.⁸

Ç’të themi tjetër?

Njeri që e karakterizon akribia e shkencëtarit dhe fantazia e shkrimtarit, Profesor Bundo me këtë libër i ka ngritur një lapidar dollisë, kurse me punën dhe veprën e tij në përgjithësi, një përmendore vetes. “Përmendorja e vetvetes ngrihet me mundime, por për çdo ditë dhe nga pak”, thuhet në esenë *Traktat për mirënjohjen*, me të cilin mbyllet libri me novela dhe ese *Sepetet e gjyshes* (f. 273).

Dhe në fund fare.

Po të ishim në vendlindjen e profesor Sherifit, në Përmet, por edhe në vendlindjen time, në Veleshtë dhe po të ishim rreth sofrës me raki e meze, ne do të ngrenim një dolli për shëndetin e autorit të këtij libri brilant, por edhe për librat e tjerë të tij, po ashtu me vlerë, me urimet më të mira për shëndet të plotë e jetë të gjatë dhe për punë të frytshme krijuese edhe në të ardhmen.

(Fjalë e mbajtur në prezantimin e librit *Dollia shqiptare, institucion shpirtëror i mikpritjes*, në Prishtinë, më 4 dhjetor 2025).

4 Klara Buda, *La biographie littéraire de Mitrush Kuteli et traduction du récit “Mon village sait boire le raki”*, Paris, 1997, 129 p.

5 Xhevoja i ka bërë një i përkthim të shkëlqyer poezisë *Fatalistët* të poetit grek Varnalis.

6 Xhevahir Spahiu, *Rreziku*, botim i dytë, Tiranë 2003, f. 26.

7 Mënyrën dëshirore të foljes nuk e kanë as anglishtja e as frëngjishtja.

8 Prof. Bundo e ka kryer punën e vet, tani e kanë radhën institucionet që të mos ndodhë edhe me dollinë si me lahutën, që na e grabitën të tjerët.

Me ftesën e Ermonelës vajtëm bashkë me gruan time në këtë shfaqje kaq emocionale e të rrallë. E rrallë edhe për faktin se ekzekutohej kjo muzikë e Puccini-t, e pa dëgjuar prej një shekulli dhe do të ishte pikërisht Ermonela ajo që do të luante rolin kryesor të asaj romance të hidhur që përmbante opera.

Magda, personazhi kryesor, i Ermonela Jahos në operën pak të njohur të Puccinit “La rondine” ishte një triumf i vërtetë për nga ekspresiviteti i skajshëm i sopranos sonë në atë mbrëmje magjike në Barbican të Londrës më 5 dhjetor 2025. Opera u interpretua në versionin koncertal me pjesëmarrjen e Orkestrës Simfonike të BBC-së, Opera Rara-s (kompani unike operistike dhe shtëpi diskografike me seli në Londër) dhe sopranos së mirënjohur botërisht Ermonela Jaho. Versioni i restauruar i vitit 1921 (nga Ditlev Rindom dhe Martin Fitzpatrick) zbuloi Puccini-n e mrekullueshëm, mbushur me valse, shkëlqim parisian dhe thellësi dramatike. Orkestra e BBC-së dhe dirigjenti Carlo Rizzi u duartrokitën nxehtësisht nga audienca për transmetimin e asaj muzike aq të pëlqyer, energjike e të pasur me ndjesi sublime. Këngëtarët e BBC-së në kor, ishin një tjetër vlerë e shtuar që i dhanë gjallëri skenës së zgjeruar të klubeve të natës. Është e vërtetë se këngëtarët solistë përdorën partitura në një mjedis koncerti, por energjia e tyre interpretative dhe cilësia e muzikës kapërcyen mjeshtërisht çdo lloj objekcioni.

Vlen të thuhet se kompozitori kishte si synim të krijonte këtë radhë një operë disi më të lehtë. Premiera e kësaj opere ishte shfaqur në vitin 1917, me një version të dytë në vitin 1920, e përsëri më 1921. Ky version i tretë do të përfshinte një skenë të re në aktin e tretë. Me këtë version të fundit Puccini mbeti më i kënaqur, por për fat të keq partitura dhe pjesët orkestrale u dogjën gjatë bombardimit të Milanos nga aleatët më 1943.

E frymëzuar nga opereta vjeneze, “La rondine” e Puccini-t është një histori e hidhur dashurie, që shpaloset përmes melodive nga më të ndjerat e romantike që ka shkruar ndonjëherë edhe Puccini. Është një botë që vallëzon si në buzë të gremisë.

Ja dhe nja dy fjalë për përmbajtjen e operës:

Ruggero, një i ri i pasur, e sheh jetën e tij ta ketë plotësisht përpara. Magda (kurtizania parisiane) bën përpjekjen e saj të shkurtër për të rijetuar romancën dhe emocionet e rinisë së saj. E bukur dhe e mençur – por a ishte vërtetë e mençur për të rënë përsëri në dashuri? Mes kënaqësive të Parisit të belle-epoque, romanca mes tyre arrin të bëhet po aq dehëse sa dhe shampanja, ndërsa zemra, siç thuhet, ka linjën e saj të veprimit! Në operën “La rondine” të Puccini-t, por edhe në interpretimin e Ermonelës dhe Iván-it, romanca dhe zemra nuk mund të tingëllonin kurrë kaq ëmbël.

Versioni standard i “La rondine”, i interpretuar në premierën e vitit 1917, përfundon me Magdën - “dallëndyshen shtegtare” të titullit të operës - duke e lënë fisnikërisht Ruggero-n e saj të dashuruar në mënyrë që ai të gjejë dikë më të përshtatshme për martesë. Por rishikimi i Puccini-t i vitit 1921 - versioni i tretë i operës së tij, me të cilin ai më në fund mbeti i kënaqur - e tregon Ruggero-n duke e larguar Magdën me zemërim. Ishte ndryshim i madh ai shndërrim drejt një ndjesie të hidhur të operës aty ku dikur ishte e ëmbël. Në vitin 1994, akti i fundit i këtij versioni u interpretua në Torino me orkestrimin e restauruar të kompozitorit italian Lorenzo Ferrero bashkë me versionet origjinale të dy akteve të para, por opera e vitit 1921 nuk arriti dot të interpretohet e plotë.

Veç këngëtarëve kryesorë pjesëmarrës në shfaqjen e 5 dhjetorit si Ermonela Jaho e Iván Ayón-Rivas, në të morën pjesë dhe Nicola Alaimo, Ellie Neate, Juan Francisco

Barbican, Londër, 5 dhjetor 2025

Ermonela me një performancë sensacionale në “La rondine” të Puccini-t

Nga Eno Koço



Gatell, Jessica Robinson, Julieth Lozano Rolong, Joanna Harries, Robert Lewis, David Shipley dhe William Thomas.

Ermonela është tashmë e njohur ndërkombëtarisht si një nga artistet-këngëtare operistike më të shquara që interpreton rregullisht nëpër teatrot e operave më të rëndësishme të botës. Së fundmi ajo u vlerësua në Francë me titullin “Chevalier de l’Ordre des Arts et des Lettres” për kontributet në arte dhe kulturë. U vlerësua edhe si “Artistja e vitit” me çmimet ndërkombëtare të muzikës më 2023. U klasifikua si këngëtarja më e mirë me çmimet operistike të Gjermanisë më 2024, si dhe të artistes më të mirë të huaj të shekullit XXI më 2024. Të tjera çmime e tituj vijnë për të zbuluar portretin e saj, çmime të cilave iu u shtua së fundi edhe ai i anëtares së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Vlerësimet e publikut, medias, dhe rrethëve artistike ishin tejet pozitive, duke e cilësuar shfaqjen si një ngjarje

unike muzikore, një sukses të vërtetë për Opera Rara-n. Revista “The Economist” e përshkruan Ermonelën si një “engjëll i flaktë ... sopranoja më e vlerësuar në botë”. “Financial Times” shënon se “në këndimin e saj ajo bën të të dridhet zemra dhe shpirti; as mos u përpik të rezistosh!” dhe se “ajo është thellësisht prekëse në Traviata”. “The Independent” e shpalli atë si “më të mirën Madama Butterfly që Londra ka parë në vite”. “The New York Times” deklaroi se “kjo soprano përçon tingullin e shpirtit”, ndërsa “Daily Telegraph” i Australisë e përshkruan Ermonelën si “një fenomen i pandalshëm”.

Salla Barbican e mbushur plot e përplot me afër 2000 spektatorë mbrëmjen e 5 dhjetorit përjetoi si oshtimat e duartrokitjeve të pleksura me britmat *bravo* të audienës, ashtu dhe qetësinë absolute të sallës ku dëgjohesh vetëm frymëmarrja e këngëtarëve. Ermonela, pa asnjë ekzagjerim, i magjepsi spektatorët me pasionin e saj në të kënduar, me intonacionin perfekt,

pianissimo-t rrëqethëse, kulminacionet aq dramatike në *fortissimo*, me ngjyrimet tërë dritë e vezulluese dhe herë herë engjëlllore të zërit. Aria “*Chi il bel sogno di Doretta*” me të cilën isha i familjarizuar, ishte vërtetë mahnitëse. Ishte po ky zë i Ermonelës që penetroi më së bukur mbi këtë orkestër kaq të rafinuar e të përsosur siç është Orkestra Simfonike e BBC-së së Londrës edhe pse në momente të caktuara dirigjenti Rizzi mund ta kishte kontrolluar orkestrën duke e mbajtur atë më qetë, veçanërisht në momentet e ndjera të regjistrimit të mesëm të zërit të Ermonelës.

Ç’privilegj të ndiqje këtë opera koncertale. Edhe në ardhje për në Barbican ashtu si dhe në dalje nga salla pas përfundimit, në bashkëbisedimet e shkurtra me londinezët ndjeheshim krenarë të prezantoheshim se jemi bashkatdhetarë të saj.

6 dhjetor 2025

Foto nga Fadil Berisha



Fatmir Musai: Përshëndetje Taip, sapo e mbarova romanin "I arratisuri". Të falenderoj që ma dërgove. Po them në fillim mbresat e mia dhe pastaj bisedojmë.

"I arratisuri" është një roman befasues, me rrëfimtari mjeshtërore, mbushur plot kulturë e erudicion, që rreket të përfshijë epoka, duke qenë sa brenda, aq edhe jashtë tyre. Përgjithësimet e mëdha qëndrojnë mbi kohët dhe e tillë është Pjesa e parë e "I arratisuri"... Mbetem në pritje të pjesës së dytë.

Vërtet, sa kurioz do të isha që ta shihja të arratisurin se çdo të bënte pas arratisjes së tretë, pas '90-s, pas martesës kanibaleske të Soses me Të plotfuqishmin, nëse do të kishte dhe Arratisje të 4-t, në një kohë kur filloi arratisja instiktive e një populli të tërë?!

Në shikimin tim "I arratisuri" është një mozaik kujtimesh e fanepsjesh nga fëmijëria e rinia e hershme që si guralecë shumëngjyrësh krijojnë një vend anonim të një kohe të pakohë, përgjithësisht kronologjike (veç intermexove që dalin si përgjithësime filozofike jashtë kronologjisë) gjithnjë në lëvizje, sikur dalin nga një mjegull që ecën e ndryshon vazhdimisht, diku hapet e diku mbyllet, diku sheh e diku të errësohet e duhet ta marrësh me mend e duhet të ndezësh dritat e mjegullës që të shohësh dhe fantazmat!

Po ashtu dua të ve në pah se ky roman nuk ka një fabul të mirëfilltë, me një intrigë strumbullar që e zbulon enigmën gradualisht deri në fund, si në romanet klasike e tradicionale që bëhen bestseller, po është si një zgjim pas një nate dimri e në mëngjes rrekesha ta kujtosh, ta ringjallësh e ta hedhësh në letër ëndrrën e gjatë që porsa ke parë... por, sa e vështirë qenka të ringjallen ëndrrat!... E përfytyroj se ç'ke hequr në këtë kalvar, po ti, Taip, e ke gjetur zgjidhjen: Mozaik e copëra që herë lidhen e herë zgjidhen, ashtu siç janë ëndrrat, madje, jo rrallë nuk dallohet ku fillon e ku mbaron gjuha e përjetimit të personazhit me atë të autorit!

Fatmir Musai: Dhe këtu vjen dhe pyetja ime e parë: Ç'rëndësi ka dhe cili është raporti mes asaj që thua ti si autor dhe asaj që përjetojnë vetë personazhet kryesore në dhënien e meditimeve, zbërthimin e përjetimeve të karaktereve të personazheve kryesorë? Si mendon ti se ruhet një raport i saktë, i zhëvjjellët që të mos ngajë se diçka kërcet, se personazhet nuk janë aq bindës për historinë e gjendjen e formimit të tyre?

Taip Sulko: Përshëndetje Fatmir, të falenderoj që e ke lexuar romanin "I arratisuri" dhe që po i ndan mendimet dhe mbresat e tua me mua. Thonë se kur një lexues aq më tepër një krijues kërkon të dijë ose don të hamendësojë se si do të vijonte ngjarja, kjo është një shenjë se romani është pëlqyer.

Thënë shkurt: ti e kap thelbin e romanit kur e krahason atë me një ëndërr të gjatë, çka synon shpesh edhe letërsia e realizmit magjik. Ky ka qënë edhe pikësynimi im, përzierja e ëndrrës me zhgënjërrën (në kuptimin letrar). Mendoj se atje ku futet fantazia, ëndrra, atje thelbi është tepër i qartë sa të dhëmb, ndërsa kufijtë mjegullohen.

Dhe tani të flas rreth pyetjes që ngre ti. Në çdo vepër letrare të gjatë, sidomos në rrëfimin e thyer bashkëkohor, është thelbësore ruajtja e një ndërvartësie të zhëvjjellët mes asaj që thuhet si autor dhe përjetimeve të vetë personazheve.

Mendoj se letërsia mëton thelbin e shpirtit njerëzor, atë pikë ku të gjithë njerëzit kanë pak a shumë të njëjtin kuptim të gjërave. Por vetjet ecin, zhvillohen secili sipas natyrës së vet. Kjo e bën ndryshimin. Njeriu ka një tërheqje të fortë ndaj fëmijërisë së vet, ka shumë kujtime që mbesin të gjalla. Ndërkaq nuk ka shumë vepra në të cilat vetja kryesore të jetë vetë autori. Ti rrëfen për veten tënde. Është një fushë letrare e minuar, duhet ecur me shumë kujdes. Ti e ke fillin që të lidh me veten, por ti nuk po thua kujtimet. Ti po end një cohë, në të cilën duhet të dalë koha, njerëzit dhe mes tyre, mbase me më shumë hapësirë apo dritë, shfaqesh edhe ti. Ti duhet të rikrijosh veten ashtu sikurse do të rikrijosh gjithçka, mjediset,



TË RRËFESH PËR VETEN TËNDE ËSHTË NJË FUSHË LETRARE E MINUAR Fatmir Musaj dhe Taip Sulko bisedojnë për romanin "I arratisuri"

kohën, mendësitë, vetjet. Shtysa kryesore është se ti duhet të krijosh një vepër arti, që të le mbresa, të bën të mendosh, që i ve në lëvizje fijet e tua të brendshme. Dhe nëse flasim, siç thamë për letërsi bashkëkohore që aq bukur ti e krahason me rrëfimin e një ëndërr të gjatë, kufijtë ngërthehen, mjegullohen, në shërbim të prodhimit të cohës letrare, të veprës së artit.

Do të doja të ndaja me ty një mbresë timen: Edhe pas shumë vitesh, për shumicën e ngjarjeve të forta të fëmijërisë apo rinisë së hershme, kuptimi fillestar nuk ndryshon edhe kur moshën ndryshon, apo dija jonë për botën shumëfishohet. Ndjesitë njerëzore janë një habi, sikur lindim me to, e, si thelb i pandryshshëm, e shoqërojnë njeriun qysh herët, si erëtimi lulen.

Fatmir Musai: Në romanet ku mbizotëron rrëfimi i thyer, ndonjëherë duket sikur kemi shkëputje të fabulës e logjikës rrëfyese që, gjithësesi, s'mund të justifikohet me stilin e konceptimit modernist! A e ke ndjerë ti në punën tënde këtë rrezik. Nëse po, si mendon ti se një shkrimtar arrin ta tejkalojë këtë dhe, nga një rrezik ta shndërrojë në një vlerë?

Taip Sulko: Të falenderoj për këtë pyetje prej kolegu shkrimtar që e kap thelbin e krijimit. Në fillim dua të them se

rreziku i shkëputjes së fabulës dhe logjikës rrëfyese mund të ndodhë me çdo lloj rrëfimi. Domethënë, nëse vemë re një dukuri të tillë, të keqen nuk duhet ta shikojmë tek mjeti, por tek ai që nuk e përdor aq mirë mjetin që ka marrë "në duar".

Tek romani "I arratisuri" logjikën rrëfyese e mban të lidhur vetja kryesore, Ermiri, arratisjet, zhvillimi si dhe shfaqja dhe rishfaqja në vijimësi e personazheve apo edhe qyteza e Anadallit. Të gjitha këto, besoj se krijojnë një rrjedhë të pashkëputur. Por, siç thashë, në letërsi ndodh që ritmi i rrëfimit në pjesë të caktuara bie dhe kjo të duket se gjërat shkëputen. Jam përpjekur që kjo të mos ndodhë tek "I arratisuri".

Mendoj se ai që shkruan me rrëfimin e thyer, pra me mjetin dallues të prozës bashkëkohore, është i vetëdijshëm për këtë rrezik. Si jam përpjekur unë të dal nga ky rrethim që duket shumë i vështirë? Rrëfimi duhet të ecë shpejt, çdo pjesë, sado e vogël, duhet të thotë diçka tërheqëse dhe ta thotë atë bukur, me art, ecja e rrëfimit, sidomos kur romani është i gjatë, i ngjan një rrjedhe lumi. Ti, si autor, duhet të ecësh dhe ta ndërtosh ngjarjen, asnjë pjesë nuk vendoset pa një qëllim të ndërtimit të veprës. Çdo pjesë e

vogël, duhet të kujtojë ty se lidhet me diçka më parë dhe se do ta hasësh në faqet që vijnë.

Fatmir Musai: Për mua, i padiskutueshëm për nga merita është stili i mirëfilltë i të shkruarit, i rrëfimit, renditja e fjalëve në fjali, mençuria e tyre, erudicioni, deri në sentenca e neologjizma... Për këtë duhet të mos kesh zili askënd. Ti, si autor, si mendon, nëse ti kërkon të jesh origjinal në çdo fjalë dhe fjali, a sjell kjo një si sforcim, dhe a bën kjo që ti ndonjëherë të jesh vetvetja më tepër në konceptim se sa në frazë?


Taip Sulko: Të falenderoj për pyetjen. Ka të bëjë, mendoj, me thelbin e përpjekjes për të rrëfyer sa më shqip. Të jam mirënjohës për sa thua në lidhje me veçoritë e rrëfimit dhe pasurinë gjuhësore të romanit. Thelbi i të shkruarit është rrëfimi. Por një roman është një ngrehinë jo e vogël. Ka shumë anë dhe kërkon të paktën durim. Por, pa rrëfim, s'ka letërsi. Ndërkaq edhe gjatë shkrimit (ky roman është shkruar disa herë në disa pjesë edhe shumë herë), por edhe në leximet e mëpasme, më ngjan se sforcimet në rrëfim janë tejkaluar. Synimi im ka qënë arritja e një rrëfimi shqip, të shpejtë, që mundësisht t'i ngajë rrjedhës së përroit pas rënies së shiut. Mbase ndonjëherë ka një si tingëllim disi ndryshe që vjen nga këmbëngulja për të përdorur vetëm fjalë shqip? Po rrëfej këtu përvojën time, pa folur si e përballojnë të tjerët këtë pengesë apo rrezik. Përdorimi vetëm i fjalëve shqip kërkon logjikën e vet, kërkon edhe një renditje ndryshe të fjalëve në fjali. Mbase kjo duket tingëllon si sforcim, sidomos po të mbajmë parasysh se, ndonjëherë, në letërsinë tonë, gjërat kanë ecur jo në drejtimin e duhur (dikur, përdorimi i fjalëve neolatine ka qënë prirje dhe mjet për një ritëm më të mirë në rrëfim).

Fatmir Musai: Në romanin "I arratisuri" vihet re aftësia dhe mjeshtëria e autorit që personazhet kyç i kap e i lë herë pas herë, po s'i harron e i rikujton, i rimerr në evoluim nëpërmjet episodeve origjinale e të pazakonshëm në kohëra dhe ata të mbeten në mendje, çka i formaton si karaktere të vërtetë! Si mendon, si ia arrin një autor që karakteret që krijojnë më tepër të shfaqen nga vetëveprimi se sa nga interpretimet e sugjeruara të autorit?

Taip Sulko: Mendoj se frika më e madhe e një autori kur shkruan është të mos bjerë në gabimin apo lajthitjen e krijimit të karaktereve që shfaqen jo nga vetëveprimi, por nga interpretimet e sugjeruara të tij, si autor. Nga përvoja ime e di se vetjet (personazhet) e jashtëzakonshme e habisin ndonjëherë edhe autorin me veprimet e tyre (kanë mendim dhe veprim që nuk e parashikon dot). Mendoj se vetjet e një romani, sipas rrethanave, cilësive apo prirjeve njerëzore, kanë secili zhvillimin e vet, rritjen dhe ndonjëherë edhe fundin të mirë apo të keq, sipas rastit, të arritur me mundime apo edhe të përgatitur, në verbëri, me duart e veta.

Fatmir Musai: Markezi te "100 vjet vetmi" themeloi qytetin mistik Makondo... ti qytetin tënd Anadell! (Mbase rastësisht tingëllon si Anadoll!) Mbase është një indicie që Makondon kolumbiane ta sillje në formën e Anadellit në tokë shqiptare, që nga materializimi që është krejt tjetër e tregon se ti ke kapacitetin për ndërmarrje të tjera të mëdha!... Një paralelizëm i tillë m'u bë bindje kur ktheva dhe faqen e fundit të "I arratisuri"-t!... Veçse, do të dëshiroja të di si ka ardhur kjo ide tek ti, dmth që në indicie, që në konceptimin bazë, në strumbullar?

Taip Sulko: Dëshiroj të falenderoj që e përmend Makondon e Markezit. Nëse në letërsi krijohet një figurë që të ngel në mendje, kjo është arritje. Por unë s'e kam pasur fare në mendje Makondon kur shkruaja romanin "I arratisuri". Me vetëdije, për vite me radhë, kam punuar fort që të jap shpirtin e kombit, sikurse jepet në romanet e mira. Ka një prirje të tillë në letërsinë botërore. Që nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar kjo duket për mua sidomos tek shkrimtarët latinoamerikanë (ku dallohet Markezi me "Njëqind vjet vetmi"), tek



ata grekë (ku dallohet Kazanzaqis me “Zorba” -n), tek ata afrikanë (ku mund të veçoja nigerianin Chinua Achebe me “Keq shkuan punët”) etj.

Qysh herët e kam pasur dhe e kam të ngulitur fort në mendje se dhënia e mjedisit, qytet, fshat, qytezë, rrugë apo edhe shtëpi (si tek “Shndërrimi” i Kafkës), është pjesë e pandarë e një libri si romani. Kjo është sikur të themi se të gjithë e kanë nga një shtëpi. Ndërkaq disa kanë shtëpitë më të bukura, saqë mbahen mend. Kështu edhe Makondo. Kam parë edhe artikuj ku krahasohet Makondo e “Njëqind vjet vetmi” me qytetin (Gjirokastrën) e “Kronikë në gur”. (Sigurisht kjo e dyta, të mahnit aq sa, sic do ta shtjelloj pak më gjerë në vijim, në fund të shfaqet si vetja kryesore e veprës!)

Ndërkaq dua të ve në dukje se Anadelli është fjalë shqip, nga dy fjalë anë+dell (mëngë lumi). Është krijuar si anë+mali, mbart historinë dhe trashëgiminë shqiptare. Në Myzeqe, vende-vende, ende janë gjurmët e degëve tashmë të vdekura të lumit Vjosë, kur ai lumë ndryshoi drejtim në shekullit III, duke u bërë edhe një nga shtysat kryesore për rënien e Apollonisë (Jakov Xoxa ka shkruar Lumi i Vdekur nisur nga këto degë lumi të braktisura nga rrjedha). Anadelli (që, siç thuhet në roman, e kishte në fillim emrin Qytezë) është një vendbanim shqiptar, përkundër Apollonisë që fillimisht ishte një ngulim i huaj. Qyteza si kjo ishin ato që i dhanë shpirt tjetër Apollonisë, sidomos, pasi u braktis nga të huajt. Qyteza (Anadelli) mbart mbi vete vlerat shqiptare. Kjo ka qënë ëndrra ime.

Fatmir Musai: Duke lexuar romanin “I arratisuri” e kam ndjerë se edhe ti, ashtu si unë, jemi ithtarë të “Kronikë në gur” të I. Kadaresë!

Taip Sulko: Më vjen mirë që e përmend “Kronikë në gur” dhe ke vënë re adhurimin tim për këtë vepër të Kadaresë. Po, e vërtetë, është vepra më e mirë e Kadaresë dhe për mua vepra më e mirë e letërsisë shqiptare. E kam krahasuar “Kronikë në gur” me “Fëmijët e mesnatës” të Salman Ruzhdi (nobelist). “Kronikë në gur” është e paarrtishme në rrëfim, për mua shumë më e mirë. Ndërkaq mendoj se romanin “I arratisuri” dhe “Kronikë në gur” i bashkon vetëm përdorimi i një mjeti dallues të prozës bashkëkohore, sikurse është thyerja e rrëfimit (e përdorur gjerësisht para Kadaresë nga Joyce, Faulkner, Proust, Calvino, Marquez etj). Merita e madhe e Kadaresë është se e ka përdorur në mënyrë gjeniale këtë mjet dallues të letërsisë bashkëkohore. Jemi me fat për këtë. Kadare tek ne nuk është vetëm shkrimtar, është institucion, koha ia shton rëndësinë. Ndërkaq le t’i kthehemi bisedës tonë: Tek “Kronikë në gur”, shfaqja e vetëtimtë e vetjeve (personazheve) dhe përshkrimet mjeshtërore, hap pas hapi krijojnë fytyrën e jashtëzakonshme të një personazhi të madh dhe të çuditshëm, atë të vetë qytetit. Ndërkaq, tek “I arratisuri”, veprimi ecën mbi arratisjet, ngjarjet sa janë në Anadell janë edhe udhëve, në arrati. Tek “Kronikë në gur”, djalthi rrëfyes është përgjithësisht një dëshmitar me një shikim që të habit; madhëshinë e prozës e përcakton së pari mënyra e rrëfimit, një ëmbëlsi që vjen nga thellësia e fshehtë, përroi i cuditshëm i jetës, vetjet e vetëtimta që e rrethojnë, ndërsa tek “I arratisuri”, Ermiri, vetja kryesore është mbartësi kryesor i veprimit, por edhe veprues, (për arsye të natyrës së arratisjeve). Rrëfimi ndërkaq është plotësisht i ndryshëm në këto dy romane, po ashtu edhe këndvështrimi i jetës, ajri që të rrethon, gjuha që përdoret.

Fatmir Musai: Të falenderoj për këtë bisedë. Të uroj të na sjellësh pjesën e dytë të romanit “I arratisuri”!

Taip Sulko: Unë të falenderoj, Fatmir, që e nxite këtë bisedë drejt rrëfimit për mjetet artistike të përdorura në romanin “I arratisuri”. Të jam shumë mirënjohës për këtë!

Fatmir Musai: Uroj që sa më shpejt ta vijojmë këtë bashkëbisedim!

“Dëshmitari i rremë” është romani i tretë i autorit Bujar Skëndaj

Një roman për artistin Sherif Merdani

Nga Izet Duraku

“Dëshmitari i rremë” është romani i tretë i autorit Bujar Skëndaj, për të cilin letërsia dhe rrjedhat letrare mbeten pasioni i një jete. Mund të them me bindje se realizimi i kësaj vepre së paku është në nivelin e pritshmërive të larta ndaj saj. Heroi i romanit, artist i shquar i këngës shqiptare, i rënë në rrjetën e merimangave të regjimit, artistikisht ndërtohet edhe përmes antiheroit që zë pjesën kryesore. Kjo është edhe risia që sjell romani. Me antiheronj është e mbushur letërsia jonë dhe ajo boterore, po Sandër Bajraj është i veçantë, i ndryshëm se si është ngjizur fati i tij. Dështimet e përhershme dhe ambicia për tu shfaqur aty ku nuk mund të ngjitet, përbëjnë tharmin e ligësisë së tij. A është xheloz Sandri ndaj sukseseve dhe përndritjes së të tjerëve?


Sigurisht. Po Jago i Shekspirit, me marifetin e shamisë, ndonëse nxit një tragjedi të mënxyrshme, do të habitej me Sandrin e viseve shqiptare, një personazh hijenë që kërkon të përfitojë nga fatkeqësia e tjetrit. Përmes monologjesh të pandërprera të Sandrit zbulohet jeta e tij diku në fshat, në rrethinat e një qyteti të vogël të kolonizuar me funksionarë fuqiplotë partie e pushteti ushatarakë e punonjës të shërbimit të fshehtë, kryesisht të dyndur këtu nga zona të tjera të vendit. Ashtu si Sandri ata kërkonin të iknin një orë e më parë nga ky vend duke zhytur të tjerët më thellë në ziftin e jetës. Monologu i Sandrit përthyer herë -herë nga dialogje të kursyera me të njohur të rastit, a me familjarë të tij. Por nëse dialogu jepet i zhveshur nga emocionet njerëzore,



monologu ashtu i ngadalshëm apo më i shpejtë zbulon tërësisht relievin e shpirtit të tij. Mjermi në jetën bashkëshortore e bën më të zymtë vetminë e tij në rrethin shoqëror. Njeriut në diktaturë në luftën për mbijetesë i leverdiste të fliste me veten se sa tu hapej miqve dhe të njohurve. Sandri nuk kishte miq. Edhe pse cilësitë e tij prej hijene i kishte mbajtur të fshehta, të tjerët, nuhasnin kundërmimin e karakterit të keq dhe i largoheshin me shpejtësi. Përmes vëzhgimeve të Sandrit përshkruhet qyteti i vogël, ku secili mbikqyrej nga të tjerët dhe njëkohësisht të gjithë banorët ishin të mbikqyrrur. Përndjekje totale. Rruga kryesore e qytetit që konsiderohej si shetitore përshkohej me shpejtësi për tu ikur vështirimeve gjurmuese dhe vrastare. Njerzit përpiqeshin të shmangeshin duke kaluar nëpër udhë dytësore. Gjithë monologjet e tij të trazuara zbulojnë përpjekjen e dëshpëruar për të justifikuar veprimin e shëmtuar të shpifjes së vet ndaj artistit të shquar të burgosur nga regjimi. Zhbirimet e thella nxjerrin në pah psikologjinë e një krimi që kërkon shpërblimin jo ndëshkimin. Sajimi i armikut nuk është vetëm vepër e Sandrit që vetofrohet si vegël krimi, po në radhë të parë i të gjithë pushtetarëve, nga maja e Olimpiti deri në periferi. Në dallim nga antiheroit, Seran Mejdani heroit i veprës mban aureolën e artistit të shquar. Edhe për shkak të cilësive të larta njerëzore, ai rrethohet nga simpatia dhe dashuria e njerëzve. Ai e ndjen rrezikun që i kanoset. Në qytetet e vogla, ligësia e pushtetarëve ishte më e madhe se kudo. Prapa llogjeve propagandistike të parimeve fshihiheshin qëndrime personale plot helm e ligësi. Në qytet vjen si guvernator një armik personal i familjes së Seranit që i pati burgosur të atin. Sigurisht ai do të përfitonte nga sulmet politike ndaj artit e artistëve duke shfrrë kështu dhe urrejtjen e verbër personale. Ndonëse ka miq të shumtë, përbindëshi partiak është i pandalshëm. Tirana, vitrina e regjimit, kundrohej si një lloj parajse ku do të mbërrinte krejt vendi. Lëvizjet drej saj qenë rreptësisht të kontrolluara. Prej andej shkrepnin rrufetë e ndëshkimit zeusian për t’I futur dridhmën krej vendit, po kjo nuk mjaftonte. Ajo do të pasohej nga tërmetet lokale: internimet, burgosjet, pushkatimet në qytetet e vogla që do të tmerronin njëllot të gjithë njerëzit. Meritë e romanit është realizimi mjeshtëror i vizatimit të ngjashmërive midis komunizmit e nazizmit për sa u përket trajtimit të kundërshtarëve politikë. Mizoria është e pakufishme. Në zgafellat e qelive ku e mbajtën, artistin e katandisën kockë e lëkurë. A nuk qenë të ngjashme burgjet tona me kampet naziste të shfarosjes?

BUJAR SKËNDO

Dëshmitari i rremë



Me parathënien e Sadik Bejkos dhe Çerçiz Loloçit

OnufriRoman

Në vitin 1991 e kisha mbaruar studimin tim monografik me titull “Vepra letrare e Martin Camajt”¹, të cilin në dorëshkrim e pati lexuar edhe vetë Martini. Për arsye të rrethanave të rënduara politike dhe kulturore në Kosovë botimi u shty dhe vetëm më 1994 ia dola ta botoj në Kozencë të Italisë, kur fillova punën në Universitetin e Kalabrisë. Në *Paraffalën* e hartuar në nëntor të vitit 1991, pata shkruar: “Nisur nga fakti se vepra letrare e Camajt hyn në rrethin më të ngushtë të vlerave tona kulminante artistike dhe se ajo duhet të bëhet pjesë e pandashme e jetës letrare shqiptare [...] ky punim synon të theksojë para së gjithash disa nga veçantitë dhe vlerat qenësore të saj, me të gjitha sprovat dhe vështirësitë e mëdha para të cilave ajo e vë edhe studiuesin më me përvojë”.

Po në atë *Paraffalë* pata theksuar domosdonë e studimit të mirëfilltë të veprës letrare të Martin Camajt: “Nevojën e studimit të krijimtarisë letrare të Camajt e nxiti dhe e ushqeu edhe mungesa e njohjes dhe e receptimit të saj në Shqipëri dhe në Kosovë, ku ajo u ndalua për afër dyzet vjet. Pra, përkundër vlerës së jashtëzakonshme poetike të kësaj vepre, mosprania dhe mosnjohja e saj pikërisht në trojet ku ajo duhej të bënte jetën dhe ndikimin e vërtetë, me të cilat (troje) ajo është e lidhur ngushtë tematikisht dhe kuptimisht, bëri që kjo jo vetëm të mos bëjë ndikimin te lexuesi, të cilit në esencë i kushtohej, por as të shfaqeshin mendime e vlerësime profesionale e reale për të”.

Në “Shënimin e botimit të dytë”, që i prin studimit “Vepra letrare e Martin Camajt” të botuar në Tiranë në vitin 2000, kam përmendur edhe faktin që lidhet me interesimin e studimit të veprës poetike të Martin Camajt: “[...] pikërisht ashtu si e parashikoja dhe e shprehja në *Paraffalën* e vitit 1991: koha e jetës dhe e receptimit të njëmendët të veprës letrare të Camajt në rrafshin gjithëkombëtar, që zuri fill sidomos me botimin e dy veprave të tij në Prishtinë *Pishtarët e natës* dhe *Në hijen e gjarpnit*, do të vinte”.

Sa mund të qëndrojnë mendimi i shfaqur në janar të vitit 2000 – një çerek qindvjetshi më parë – ose më mirë: të çfarë cilësie dhe të cilit rrafsh janë studimet që iu bënë veprës letrare të Martin Camajt?

Natyrisht me këtë rast nuk e kam ndërmend të përmend ose të ndalem të studimet dhe punimet konkrete që i janë kushtuar veprës letrare të Camajt, po do të sjell disa mendime dhe shembuj për të dëshmuar sa e ndërliqshme (komplekse) dhe e çfarë rrafshi poetik është vepra letrare e tij. Këtu duhet përmendur një fakt të pamohueshëm: vepra letrare e Martin Camajt nuk është “kafshatë” për secilin studiues që ka njohuri të kufizuara për artin letrar e për natyrën komplekse të tij, sidomos ajo nuk mund të vërë komunikim të mirëfilltë me ata autorë që jetuan dhe u formuan në kohën e realizmit socialist dhe vijnë t’u përmbahen parimeve, ku vepra letrare poetike u vështrua dhe u vlerësua në mënyrë tradicionale, kryesisht u përfol përmbytja ose u studiua si tematikë. Një qasje e tillë jo vetëm se nuk mundësoi njohjen e veprës së Martin Camajt, por e zhvlerësoi atë dhe e solli në një rrafsh përçmues dhe zhgënjyes. Dikush u mor me veprën letrare të tij për të kryer ndonjë detyrë shkollore, disa të tjerë për të thënë se janë marrë edhe ata me veprën letrare të tij, ndërsa disa të tjerë për ndonjë interes, që këtu nuk e ka vendin të thuhet. Mua, mjerisht, nuk me ka rënë të lexoj një studim që është rrjedhojë e një leximi të thellë e të vëmendshëm, një interpretimi që tekstet e tilla poetikisht, sa të veçanta aq dhe të lartësuar, e meritojnë. Me fjalë të tjera, për të vënë një komunikim me veprën letrare të Martin Camajt lypset një njohje e mirëfilltë e studimit modern të letërsisë, e strukturës tekstore që nuk mbështetet në parimin se çka thotë një tekst letrar poetik po në ç’mënyrë dhe si e thotë dhe si e shpreh atë. Struktura gjuhësore poetike asnjëherë nuk ofron vetëm një kuptim, po një shumësi kuptimesh, që sa më shumë që thellohem në qenësinë kuptimore shprehëse të saj, vërejmë që ajo mund të degëzohet edhe më shumë, deri në pafund. Pra, qasjet, nocionet dhe mënyrat që janë përdorur në studimin dhe interpretimin e veprës së Martin Camajt nuk kanë qenë tipike dhe të mirëfillta për të vënë një komunikim meritore me të që do të ndriçonte vlerat e njëmendta poetike të saj.

Për të përligjur këtë po sjell në fillim poezinë “Flaka e pishës” nga faza e dytë e krijimtarisë së Camajt, ku është krijuar një nëntekst jashtëzakonisht i veçantë poetik, përmes të cilit njësohen artistikisht njeriu me natyrën dhe ku shprehen ndjesitë e dashurisë së dy të rinjve brenda bukurisë dhe ngrohtësisë së saj:

*Te dera e tbanit ndezet pisha n’bjeshtë
E djali n’vrrë kundron me mall në shpirt:
Atje është vajza shtat - hollë, e zeshkë.
Atje është fryma e ngrohtë në tban - fierët.*

*Hyni mbrendë djali e ndezi pishën n’prush:
Hijen e duerve vrejti n’flakë tu’ u dridhë
E me dishira zemra shqim iu mbush,
Nji mungullim nën diellin e ndezët n’prill.
(Flaka e pishës)*

Teksti i poezisë shpalos atë që dy të rinjtë ndiejnë dhe përjetojnë për njëri – tjetrin në një takim dhe ambient burimor, ku gjithçka është e përshkuar, funksionon dhe ndikon në marrësin nga *Ndër drita sysh kallet nga një flakë*. Camaj i shpreh vetëm disa nga elementet e asaj që përjetojnë dy të rinjtë: lexuesi e plotëson pamjen ose pamjet sipas botës, ndjenjësimit dhe aftësisë së vet. Imazhi idilik është dhënë vetëm si nismë, si hyrje në atë që të rinjtë përjetojnë, po shumëçka është heshtur. Kjo pam-

1 Anton Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*. “Radhonjtë e Zjarrit”, n. 18, Kozencë, 1994.

2 Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*. Monografi. Lajmëtar, Tiranë 2000.

Anton Nikë Berisha

Për një lexim më të thelluar dhe për një interpretim më të mirëfilltë

TË VEPRËS LETRARE TË MARTIN CAMAJT

(Rikthimi te kjo vepër pas një çerek qindvjetshi)

Kumtesë e mbajtur në Tiranë më 11 dhjetor, kushtuar veprës së plotë, në një vëllim të Martin Camajt.


je poetikisht sublime dhe pushtuese, shprehet përmes një varg metaforash që lidhen me vendin dhe rrethanat e asaj që ngjet në bjeshkë dhe në tëbanë. Nëpërmjet simbolikës së pishës së ndezur, flakës së saj, pastaj prushit dhe zjarrit të diellit, shpaloset veçantia e asaj që ngjet në botën e brendshme të dy të rinjve në zgjimin e përjetimit ephsor. Herë – herë nënteksti poetik është shumëfish më i pasur dhe më i rëndësishëm sesa vetë teksti dhe se ai (teksti) e fiton peshën e vet të mirëfilltë pikërisht në aktin e receptimit, të përjetimit dhe të ndikimit estetik të nëntekstit në marrësin.

Edhe në poezinë “Fragment”(që si qasje dhe shtjellim tekstori shprehës është e natyrës tjetër nga “Flakë marra e pishës”), Camaj e shqipton botën e brendshme të njeriut, në rastin konkret të mërgimtarit: shqetësimin, dhembjen shpirtërore dhe fatin e tij tragjik, shtegtimin – emigrimin si tronditje dhe rrënim shpirtëror (që mund të lidhet edhe me vetë fatin e poetit Camaj të emigruar).

Nga teksti i poezisë mund të nënkuptohen dy lloje shtegtimi: ai konkret dhe ai shpirtëror (në vetvete). Teksti shpreh sidomos të dytin. Mbese Poeti i kthehet dhe e shpreh të kaluarën (pse jo dhe fëmijërinë) përmes një teksti jashtëzakonisht të ngjeshur dhe shtegton dhe nëpër kujtimet e veta, nëpër të kaluarën, nëpër shtigjet e fatit, sidomos të fatkeqësisë. Ky shtegtim më shumë merret si cytje për të shprehur një pamje sa artistikisht të plotë, po aq (kuptimisht) sublime dhe tronditëse. Gjuha figurative i jep teksti vlerë të veçantë dhe e bën atë “shumë të gjatë” në procesin e përsiatjes e të mundësisë së perceptimit e të komunikimit.

*Niset për në gurbet punëtori
me një copë qielli në krah
e krypë deti në kutia pishë.
Në dorë mban një bahe
e gur lumejsh në gojë
në vend të bukës.
Rruga i zbrit përpara
me gaca zjarmi në sy³.*

3 Martin Camaj, *Njeriu më vete e me tjerë*. Poezi. München 1978, f. 41.



Kjo mënyrë e përfimit të tekstit poetik, të shtjellimit gjuhësor shprehës dëshmohej edhe në prozën e tij, ku dukuritë perceptohen dhe transponohen përmes një gjuhe poetike të zgjedhur e të pasur, një frazeologjie të veçantë, ku përligjet parimi që në art lihet shumëçka pa thënë, përkatësisht thuhet vetëm ajo që është e domosdoshme dhe që nxit e mundëson komunikimin e krijimit letrar artistik, që ta vazhdojë lexuesi.

Krijesat poetike të Martin Camajt përshkohen nga dramatikja, e cila merr shpesh përmasa të ndieshme të tragjikes. Kjo nuk është vetëm rrjedhojë e konteksteve të ngjeshura, të papriturave dhe situatave të efektshme që shqiptohen, por rrjedhojë e ballafaqimit të mendimeve dhe të dukurive të botës që e rrethon dhe të marrëdhënieve që e cilësojnë atë mjedis. Shqiptohet sidomos drama shpirtërore e njeriut dhe brenda saj gjurmohet, vëzhgohet e zbulohet tipikja dhe e qenësishmja, që njëherit nënkupton edhe të përgjithshmen. Gjithë kjo përligjet nga mënyra e perceptimit dhe e shqiptimit të ngjarjes, të veprimeve e të ndjesive, nga nënteksti që krijohet nga struktura tekstore poetike. Çështjet kryesore me qëllim nuk vihen në planin e parë të rrëfimit, por gjallojnë në thellësinë e sistemit kuptimor; “mbulohen” ose gërshetohen me ngjarje ose me përshkrime të natyrës ose të veprimit të personazheve, me ndonjë element të dorës së dytë ose të tretë. Kjo mënyrë e shtjellimit dhe e shqiptimit të problemeve në veprën letrare artistike të Martin Camajt është një nga parimet qenësore krijuese. Në romanet dhe në novelat e tij realiteti nuk shqiptohet në teknikën e ashtuquajtur “bardh-zi”; nuk bëhet ndarja e personazheve në negativë e pozitivë; nuk i jepet përparësi të mirës ose të keqes dhe veprat nuk përfundojnë me “Happy End”.

Kjo dëshmohej veçmas në veprën *Dranja* (1981), që ka sistemin më të ndërliqshëm kuptimor, ka simbolikë më shprehëse dhe cilësohet me gjuhë më të pasur poetike. Në Breshkën dhe rrashtën e saj njësohen e shkrihen misterit i natyrës dhe tragjika e gjallimit (Deshët që rroken krye me krye “Ndërsa qëndronin me brina të kapërthym si një kurm i ngrimë, u kullonte gjaku ndër sy”). Breshka shënjon dysinë e formimit: breshkë e gjarpër, dy frymorë që janë përjetësuar në rrashtën e saj (“Shikoni, si janë të ngrimë në një si të mos ishin dy frymorë”). Këtë qenie me formë të tillë, plot fshehtësi që nga ekzistimi mitologjik (kur Breshka kishte përmasa të stërmëdha) në konceptin e qasjes e të shtjellimit e ka shkaktuar, si thuhet në vepër, “nema e Orëve”, e cila çdo gjë mund ta shndërronë në gurë. Breshka mund të shenjëzohet paraardhësit para përmbytjes, përkatësisht përnjësimit me gruan e bukur (kujtojmë këtu, fjala vjen, breshkën nuse, sidomos në përrallat tona) dhe me gjarpurin (po ashtu në përrallat tona si i Bukuri i Dheut, si përkim ose ballafaqim me të Bukura e Dheut). Rrafshi i dytë mitik është shtrirë dhe është funksionalizuar në gjithë sistemin kuptimor të veprës, sidomos dallohet simbolika e gruas së bukur, e Dranjes, fati dhe tragjika e saj⁴³.

Meqenëse këtë kumtesë e nisa me një mendim të shkruar më 1991, po ashtu po e mbyll atë me dy mendime. Të parin e kam thënë në “Shënime për botimin e dytë” të vitit 2000: “[...] e çmoj (botimin e studimit tim në Tiranë) si veprim të rëndësishëm për njohjen e mëtutjeshme të veprës letrare të Camajt edhe në At dheun e tij, të cilit ai i kushtoi gjithë punën dhe jetën e vet, ose si shprehet ai poetikisht – *Jeta ime djegagur*. Pikërisht bota shqiptare, bashkë me, të themi kushtimisht, *djegagursinë* e jetës së poetit, shqiptohen nëpërmjet një strukture tekstore artistike të rrallë dhe një ndjenjësimi të veçantë estetik dhe bëhen të amshuara. Për këtë arsye sa herë që do t’i qasemi kësaj vepre ose do të lexojmë për të, përherë do të vërejmë diçka tjetër, do të mësojmë më shumë, para së gjithash, për botën tonë e për vetveten dhe do të pasurohemi shpirtërisht”. Mendimin tjetër e kam thënë në “Shënimin e botimit të tretë” të bërë, po ashtu, në Tiranë më 2010 nga shtëpia botuese Princi: “Uroj që botimi të nxisë edhe më tej interesimin dhe komunikimin me veprën letrare të këtij shkrimtari tonë të orës së parë”.

Prishtinë, dhjetor 2025

4 ³ Gerhart Hauptman thotë: “Të jesh poet domethënë të ritingëllosh pas fjalëve, fjalën fillestare”, ndërsa Karl Gustav Jungu, duke folur për rëndësinë e pamjes fillestare e të fjalës fillestare, thekson: “Pamja fillestare ose arketipi është një figurë, djallë, njeri ose proces që përsëritet në rrugën e historisë, sa herë që fantazia krijuese ushtrohet lirish. Ajo është në radhë të parë një figurë mitologjike. Duke e vëzhguar prej afër vëmë re se ajo është përmbledhësja e përvojave të panumërta tipike të të gjithë brezave të shkuar. Në të mund të shquhen mbeturinat psikike, të ngjarjeve të panumërta të të njëjtit lloj.” (Shih, Karl Gustav Jung, *Psikologjia analitike dhe arti poetik*. Në Rilindja demokratike, 29 mars 1995.)

5 Anton Nikë Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*. Monografi. Botimi i tretë i plotësuar dhe i shtuar Botimet Princi, Tiranë 2010.

Ngjarjet historike kanë pasë ndikuar gjithmonë mbi tematikën dhe problematikën e veprave artistike, përderisa letërsia i krijon mundësinë shkrimtarit të nxjerrë në pah qëndrimin e vet ndaj një realiteti historik dhe të zbërthejë veçoritë e një epoke të kaluar. Historia lidhet shumë ngushtë me letërsinë, e cila pasqyron dhe interpreton artistikisht ngjarjet historike, përcjell botëkuptimin dhe këndvështrimin e njerëzve që kanë jetuar në të tjera kohë.

Pavarësisht nga popullariteti bashkëkohor i prozës dokumentare, e cila i përcjell lexuesit një mjedis konkret, duke anashkaluar trillin artistik, tjetërthënat (aluzionet), sipas shkrimtarit francez të periudhës së romantizmit, *Zhan Sharl Emanuel Nodje (Jean-Charles-Emmanuel Nodier - 1780-1844)*, nuk e humbasin kurrë rëndësinë e vet në penën e një krijuesi me këndvështrimin nga historia.

Në Panairin e fundit, të librit, midis veprave, që u ekspozuan nga shtëpi të ndryshme botuese, binte në sy romani i shkrimtares me emër Mira Meksi, me titull *“Ikona e plagosur”*. Një tjetër “shartim” ky i letërsisë artistike me historinë. Këtë roman e ka hedhur në qarkullim Shtëpia botuese “Onufri”, me drejtor zotërinë Bujar Hudhri. Kjo shtëpi botuese, përgjithësisht, njihet mirë nga lexuesit, si një ent botimor me mjaft autoritet, i cili dallohet për cilësinë e lartë të veprave që nxjerr nga shtypi. Botimi i veprave të Kadaresë në këtë shtëpi botuese, përbën një periudhë të artë në historinë e kulturës sonë mbarëkombëtare.

Kjo vepër e re e Mira Meksit i përket gjinisë së romanit historik, çka është një gjini e parapëlqyer e saj. Lexuesit e veprave të kësaj shkrimtareje kujtojnë dy romanet e saj të mëparshme - *“Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë”*, kushtuar Teutës, mbretëreshës famëmadhe të Ilirisë, dhe *“Diktatori në kryq”*, në të cilin, si asnjë shkrimtar tjetër deri më sot, autorja ka çmitizuar artistikisht figurën e kryediktatorit Enver Hoxha. Këto dy romane janë botuar po nga “Onufri, respektivisht në vitet 2014 dhe 2020. Në këtë roman, Mira Meksi ka trajtuar një temë nga e kaluara historike e popullit tonë, e cila lidhet me periudhën më të lavdishme në gadishullin e Ilirisë - me Epopenë skënderbejane.

Periudha skënderbejane i ngjall emocione të fuqishme çdo shqiptari me vetëdije të lartë kombëtare, sepse ajo është periudha më e ndritur jo vetën në hisorinë tonë, por edhe në historinë e mbarë kontinentit europian.

Në këtë roman, autorja i ka vënë vetes si objektiv dhe si detyrë ringjalljen dhe studimin e krakteristikave më të rëndësishme të personaliteteve të njohura, parë në optikën e lidhjeve të tyre të ndërsjella me epokën kur kanë jetuar.

Në këtë këndvështrim, duhet theksuar se shkrimtarja ka bashkërenduar mjeshtërisht trajtimin historik, social dhe humanitar në botën e Kastriotëve.

Ngjarjet në këtë roman autorja i ka shpalosur në përtejanën (sfondin) e ngjarjeve historike konkrete. Gjinia e romanit historik përfshin në vetvete përdorimin e elementeve artistike për rikrijimin e atmosferës së kohës. Në dallim nga një vepër historike, romani mund t'i lejojë vetes njëfarë lirie për interpretimin e fakteve dhe të figurave, çka e bën më të kapshëm dhe më tërheqës për një auditor të gjerë.

Si tipar karakteristik i romanit historik shërben krijimi i heronjve me një natyrë të komplikuar, të cilët vihen përballë ngjarjeve historike. Në këtë mes kemi të bëjmë jo vetëm me figura, kemi të bëjmë me njerëz që ushqejnë shpresa, që kanë dëshira, të cilat e gjejnë pasqyrimin në kontekstin e epokës së vet. Lexuesi mund të bashkëpërfetojë shqetësimet e heronjve, çka ndihmon për të hedhur më shumë dritë mbi procesin historik.

Një tjetër roman historik i Mira Meksit

Nga Eshref Ymeri

Shkrimtari, brenda caqeve të domosdoshmërisë historike dhe idesë së veprës, pa dyshim që ka të drejtë të përdor trillin artistik, fantazinë, duke mos lejuar largimin nga realiteti historik.

Përmes rrefenjave tejet sa tërheqëse, aq edhe emocionuese të shkrimtares, lexuesi njihet me odisenë e eshtave të Skënderbeut, të cilat Donika Kastrioti i pati marrë me vete kur qe larguar për në Napoli dhe prej andej për në Valencia të Spanjës.

Domosdo që Donika Kastrioti do të kërkonte përkrahjen e mbretërisë së Napolit, meqenëse Skënderbeu, gjatë fushatës italiane të viteve 1460-1462, i pati ardhur në ndihmë aleatit të vet, Ferdinandit I Napolitan, i cili asokohe ndodhej nën kërcënimin e dinastisë së anzuinëve.

Pra, ngjarjet e këtij romani autorja i shtjellon në trekëndëshin Napoli-Valencia-Mali Athos në Greqi, me pikësynimin për zbulimin e vendprehjes së eshtave të Skënderbeut, të Donika Kastriotit dhe të Ikonës së kësaj të fundit, të dëmtuar nga një goditje me thikë.

Romanin e përpin kur e lexon. Sepse me mjeshtërinë e fjalës artistike, Mira Meksi e

emocionon kaq shumë lexuesin, sa që e bën të shtegtojë në humbëtitat e shekujve dhe të përfytyrojë rrënjët e kësaj gjinie letrare në thellësitë e epokës aleksandrine, kur shkruante veprat e veta Hariton Afrodiasias, shkrimtar i lashtë romak greqishfolës, i cili, hamendësisht, pati jetuar në shek. I, II ose III p.e.r. Për jetën e tij nuk dihet asgjë, me përjashtim të një parathënieje të romanit të tij, me titull *“Rrëfjë për dashurinë e Hereit dhe të Kalioit”*. Ky roman dashurie, të cilin vetë autori e ka ndarë në tetë libra, krahas romanit me titull *“Satirikon”* të shkrimtarit romak, Petronit (rreth viteve 27-66), vlerësohet si njëri nga romanet më të hershme europiane.

Romane historike i janë kushtuar edhe Aleksandrit të Madh (356-323 p.e.r.) dhe fushatës trojane, të cilët qenë shkruar në shekujt e parë të erës sonë dhe që, në shekujt e mesjetës, në shumë variante dhe ripërpunime, patën një përhapje të gjerë në krejt Europën.

Emocione të fuqishme e kaplojnë lexuesin, pasi ka arritur në faqën e fundit të këtij romani.

Pas botimit të tre romaneve të saj



historike, ai krijon bindjen se emri i saj e meriton të renditet pranë emrave të shkrimtarëve të njohur, romanet historike të të cilëve kanë hyrë në fondin e artë të letërsisë europiane. Dhe, vetvetiu, vjen në përfundimin se formimi i gjinisë së romanit historik, i cili i dha një impuls të fuqishëm mbarë krijimtarisë artistike europiane, lidhet me emrin e prozatorit, poetit dhe historianit britanik, *Valter Skotit (Walter Scott - 1771-1832)*, me emrin e *Viktor Hygoit ((Victor Marie Hugo - 1802-1885)*, të *Prosper Merimesë (Prosper Mérimée - 1803-1870)*, të *Leon Tolstoit (Aes Tolstoy - 1828-1910)*, të *Ërih Maria Remrkut (Erich Maria Remarque - 1898-1970)* etj.

Në këtë roman, Mira Meksi i ka vendosur heronjtë në kontekstin e ngjarjeve të rëndësishme, në kuadrin e të cilave shpaloset ecuria e fatit të tyre. Aty fqinjësojnë faktet dhe trilli artistik, të përfaqësuar, respektivisht nga Donika Kastrioti, Gjon Kastrioti dhe Alfons Kastrioti, me dy historianët në kërkim të gjurmëve të tyre - Arbri dhe Nora.

Si në çdo vepër, edhe në këtë roman, nuk mund të anashkalohej tema e dashurisë. Domosdo, sepse tema e dashurisë është “zeja” më e parapëlqyer për shkrimtaren Mira Meksi, e cila përdor mjeshtërisht elementet e dramës dhe u krijon mundësinë lexuesve të hyjnë në botën e pasionit dhe të romantikës.

Me artin e lirizmit të saj çmendurak, Mira Meksi shpalos botën e brendshme të personazheve, përjetimet e tyre, duke e nxitur lexuesin të përsiatë thellë për motivet dhe ndjenjat që vënë në lëvizje heronjtë e romanit.

Në prozën historike Mira Meksi e shfrytëzon dashurinë si përtejanë për shtjellimin e ngjarjeve që ndodhin në epokë të ndryshme, çka u krijon mundësinë lexuesve që jo vetëm të kënaqen me historitë e dashurisë, por edhe ta përfytyrojnë veten në atmosferën e kohës.

Në çdo Panair libri, veprat e Mira Meksit kanë ngjallur përherë mjaft interes në masën e lexuesve, çka është vënë re gjithmonë, kur ata, pasi e kanë blerë librin, krijojnë një vargan të gjatë drejt tryezës, pranë së cilës është ulur autorja, për të marrë autografin e saj.

Si një shkrimtare-pasqyrë e vetëdijes së lartë kombëtare, Mira Meksi, në parathënien e këtij romani, i drejtohet shtetit shqiptar me thirrjen në vijim:

“Ndoshta ka ardhur koha që shteti shqiptar të bëjë përpjekjet e duhura për të sjellë në Shqipëri eshtat e Donika Kastriotit, ose atë çka mbetur prej tyre”.

Le të shpresojmë që thirrja e kësaj shkrimtareje të mirënjohur do të dëgjohet në sferat më të larta të shtetit, duke uruar që të mos mbetet një zë në shkretëtirë.

Le të shpresojmë, gjithashtu, se Mira Meksi do ta vazhdojë botimin e serisë së romaneve historike, duke e pasuruar me temën e një romani, kushtuar copëtimit të trojeve tona etnike nga shovinizmi europian, me në krye shovinizmin rusomadh, armikun tradicional të kombit shqiptar. Një temë kjo, së cilës, deri më sot, askush nga personalitetet e letrave shqipe nuk ka guxuar t'i afrohet.

Kaliforni, 08 dhjetor 2025



UNË JAM VJESHTË

Unë jam vjeshtë,
por
pranverën e njoh mirë,
e kam parë shkrijen e akujve
çative në sy të pranverës,
kam ndier rrezet e diellit
e kaltërsinë e qiellit,
edhe fluturimin gazmor
të zogjve e kam lakmuar
fort,
kam parë si çelin nën borë
aguliçja e lule vjollca,
edhe blerimin e prillit
parë e kam,
edhe rritjen e barit, lulëzimin
e lulemollëve e pjekjen
e dredhëzave kur pikin
plot ngjyrë e ëmbëlsi i kam shijuar,
edhe erën pranverore
e kam ndier
në flokët e mi, sepse:
dikur kam qenë pranverë.

Unë jam vjeshtë,
por
edhe verën e njoh mirë,
kam parë si piquen qershitë,
si piquet gruri ngjyrë ari
e si lidh kalliri i misrit,
por kam parë edhe
si digjet e si mbetet në arë
tërfili i livadheve,
kam ndier përcëllimin e diellit
si saç mbi kokë
dhe afshin e vapës e djersët curril,
edhe shterimin e puseve
e tharjen e lumenjve
i kam parë,
eh, sa herë kam ndier therjen
e këmbëve nga ecja zbathur,
kam ndier edhe fladin e pishave
e freskun e lumit
t'rrjedhshëm,
sa shumë i kam dëshiruar
atëherë, sepse:
edhe verë kam qenë dikur.

Unë jam vjeshtë,
po, po unë jam vjeshtë
me plot ngjyra,
me tryezën plot larushi e shije,
shoh ende diell e kaltri qielli,
por edhe lagështi ajri e erë
mjegulle përzier me timin
e oxhaqeve,
ndiej shije vjeshte e pika shiu
që trokasin ne dritaren time
që lëkundet nga era e fortë
dhe te ftohtët,
sot ec lodhshëm mbi gjethet
që kërcasin si eshtrat e mi,
ah, gjethet e rëna, të thara,
të rreshkura e pa jetë, shumë
nga ato tashmë të shpërndara
kushedi se kah nga era
e rreptë vjeshtore,
prandaj s'eci më përpjetave
veç luginave të buta,
po përgatitem për pushim,
për jetë të re,
s'kam mërzi,
vërtet s'kam mërzi,
vetëm dua qetësinë,
si gjithçka në natyrë, sepse
unë jam vjeshta
dhe kam bashkuar stinët e mia.

Unë jam vjeshtë
sepse:
dimrin ende s'e njoh mirë
edhe pse e kam provuar pëlçitjen
e tëmthit e pëlçitjen e anit,
edhe mërdhirjen e plasaritjen e duarve
e të këmbëve,
edhe mërdhezjen e hundës
e të faqeve e kam ndier shpesh,
edhe nxehtësinë e zjarrit
e djegien e drurëve në oxhak

SHEFKIJE ISLAMAJ

Unë jam vjeshtë

Poezi



i njoh fort,
i kam parë edhe fjollat e borës
kur i lëvizte era e ftohtë
pamëshirshëm
dhe njerëzit e mbyllur nga bora,
por edhe pamëshirën e ortekëve
të borës në bjeshkë,
kur rrokulliseshin teposhtë,
e kam parë edhe pastërtinë,
bukurinë e bardhësinë e borës,
kur mbulon qetas, prajshëm,
në heshtje gjithçka,
që është nën qiell,
edhe pse më mërdhin kjo
mbulesë e bardhë, më pëlqen,
sepse:
do të bëhem dimër.

NËNTOR

Eci ngadalë në këtë ditë të ftohtë, era
fytirën egër ma pret.
Ditë vjeshte me diell dhëmbëmprehtë.
Shkeli barin gjysmë të vdekur, hapat më
zvarriten jo lehtë.
Ndiej mall, oh, sa qiell, tokë e det.

Babë, ti s'më sheh, s'më ndien, pushon prej
vitesh i qetë.
Jam me ty, ndihem me faj të thellë.
Erëftohta prish heshtjen e gjetheve të rëna
përtokë pa jetë.
Moti s'kam qenë n'tënden kështjellë.

Hapat e mi ndihen butë në tokën e thatë
t'plasaritur pa shi.
Ti s' flet, fëshfërijnë veç gjethet.
M'vijnë para sysh dromca jete plot mall e
shumë ndjenjësi,
trupin e zemrën m'i zënë ethet.

Babë, sa shumë vite pa ty u ndrynë në
timen arkëkujtesë,
pa tënden fjalëporosi s'plaka asnjë ditë.
Dhe kështu do të ikin ditët palë-palë me
mall e shpresë,
derisa frymës sime t'i fiket e saja dritë.

KAM MENDUAR

(ose: të bëhesh nënë)

Kam menduar:
se s'ka më bukur se kur çel agun dielli,

se s'ka më frymëgjërë se i kaltri qielli,
se s'ka më t'hijshëm se i ngjyrëti ylberi,
ndërrova mendje kur shtatin tim le ti

Kam menduar:
se s'ka më liri se fluturimi i zogut n'ajri,
se s'ka më t'kthjellët se gurra në malësi,
se nuk ka më të bardha se retë në lartësi,
sa e paditur paskam qenë derisa linde ti.

Kam menduar:
se s'ka në botë sa oqeani i paanë gjerësi,
se s'ka më prekjetutë se bari në gjelbëri,
se s'ka më qetësi se kur shikon në yllësi,
derisa në atë të lume orë hape dy sytë ti.

Kam menduar:
se s'ka më t'erandshëm se i kuqi trëndafil,
se s'ka muaj më shpirtëror se i dielli prill,
se s'ka më natyrëpastër se pranverori shi
derisa t'shtrengova n'krahë e t'mora n'gji.

Kam menduar:
se s'ka më të shenjtë se engjëlli në gjithësi,
se s'ka më mëshirëplotë se natyra n'rru-
zulli,
se s'ka më strehëngrohtë se e ëmbla
shtëpi,
derisa provova shenjtërinë e të pasurit
fëmijë.

Kam menduar
se s'ka më të çmueshme se shëndeti në
rini.
se s'ka më të dëshirueshme se kesh mirëni,
se nuk ka më bukur se të shikosh në gjithë-
si,
por kur të linda ty, krejt bota ime u bëre Ti.

KUR “VDESIN” GJETHET NË GËRMI

Ti ende je i vogël për të kuptuar e ditë
se gjethet e rëna kanë pasë jetë e shpirt,
se kanë zënë fill e rritë me shumë dritë,
se fuqi e tyre ishte dielli e shiu përditë.

Ti ende je vocërrak për t'i parë e ndier,
se ç'dashuri për vit në zemra kanë zier,
se ç'mrekulli falte valëvitja e tyre n'erë,
se ç'vallëzim bënin në t'blertën pranverë.

I vockël je për t'ditur si ishin gjethet dje,
se ç'kanë ndier ato kur qielli zihej me re,
kur era e stuhia sillnin rrufe pandërpre'
e jeta e tyre e brishtë varej në t'hollin pe.

I njomë je ende s'i njehtë natyrës ligjësi,
se gjedhet jetojnë të veten rini e pleqëri,
se ato provojnë e ndiejnë shumë mizori,
e nesër s'ërisht do të ndiejnë të tyren rini.

Sot n'vjeshtën shumëngjyrëshe t'pamatë,
kur sytë na i kënaq fort qilimi i tyre i artë,
historia e gjetheve shkruhet me shi e lot,
e lumtur që ty atje s'të shkon mendja dot.

NË TË HYRË TË DIMRIT

Erdhi dimri patrembshëm, si për vit,
vjeshtës i vodhi pamëshirshëm ditë.
Vuri brof kurorën e stinës së bardhë,
me pak rreze dielli, lagështi e acar.

Erdhi si përherë me miqtë e vet gri,
me mjegull, re, lagështi, borë e shi,
shikoj ndritare atje tej, gjë s'lëviz,
as gjedh, degë, zog, flutur, as mizë.

Vetëm mendja ime s'rri urtë e qetë,
lyp një kohë t'ikur që vjen e zbehtë.
Sytë bredhin në të vegimtat imazhe,
mbetur peng në të blertat peizazhe.

Me sy të paqetësuar e kokën zjarr,
me kujtime që ikin e vijnë si valë,
më zë përdore malli e marr udhë,
po ku të gjej shteg që më përudhë?

Pres t'më vijë e buta imja vajzëri,
përreth me lugje e të butin vërri,
para më dalin pishat veshur nuse,
plot me borë pranë t'akulltave puse.

E unë me hundë e duar që mërdhinë,
ngroh duart me të valën timen frymë.
Pres t'ndiej zë nga shtëpia n'rafshinë,
kot, ai zë i ëmbël moti “fle” n'kodrinë.

SYTË E MI

Sytë
ujëvarë e liqe që nuk njohin skaj as fund,
më t'kthjellët se çdo rrjedhë, gurrë e lumë,
më të njelmët se kripa në çdo det e oqean,
pushtues hapësirash universi këtej e
matan'.

Sytë e mi
në ag dielli, nur hëne e ylli - zgjuar prorre,
në mjegulli e errësirë nate - dritë sipërore.
Dje, sot e n'mot armë që mund shtrëngatë,
në të nisur e sosur jete - hyjnorja dhuratë.

Sytë
sa mrekulli e shenjtëri kam parë për
t'gjallë,
sa kujtime e ngjarje falë tyre ruaj për mall.
Sa shëmti e pashpirtësi kam ndier e parë,
sa dhembje e pikëllime me lot m'janë larë.

Sytë
dy ninëza drite sa mirësi e dashuri fshehin,
sa pafundësi e paskajësi ndjesish shprehin,
dy bebëza të vogla t'pambarimta ngjyrash,
mbushin zbrazëti, zbusin melankoli
fytirash.

Sytë
Me sy shoh si i dua unë tokën, detin e
qiellin,
“prek” malin, livadhin, lulen, bletën e
diellin,
shoh thellë të paparën, ndiej larg të
pathënëni,
përkëdhel e puth edhe timen të ndjerën
nënëni.

NË NJË TË HËNË

Në një të hënë nëntori kur im atë na la,
pullazi i shtëpisë mbi kokë se ç' na ra.
Por, kur një të hënë gushti dhe nëna iku,

LIMAN I VOGËL

Zemër e kaltër
që ke përherë vend
për anijen e madhe
të përmallimit
tim.

Gjysmë monedha e hënës
vërtitet në Qiell.
Të varfërit në Tokë do të
kenë ende uri.

Mjellmë e ujërave të kaltra
pa ty liqeni do të ishte
një pellg i harruar uji.

Gjethet e fundit të mallit tim
(këtë natë të stuhishme dimri)
do të bien mbi udhën
që të priti gjatë gjithë vjeshtës.

Të paktën në dashuri
do të doja të flisja me gjuhën
e zogjve

në dashuri të paktën.

Të ngrira marrëdhëniet midis teje dhe meje
të ngrira.
Akull gjithandej.
Prej ditësh jam mbyllur brenda ngrehinës
të trupit tim.
Të dal nëpër rrugë
kam frikë se mos thyej krahët e pritjes.

Ti vazhdon zemërthyer.

RIKTHIM

Pikërisht m'u në mes të dimrit
pikërisht m'u në gjysmë të janarit
u rikthye pranvera
si kujtimi i ditëve të rinisë
në shpirtin e trazuar të një burri të thyer
në moshë!

QYTETI BUZE DETIT

Qetësi e betontë njëherazi e ujshme
asgjë e papritur kurrgjë e bujme!

Padyshim ai nuk po kalon Rubikonin
as nuk është varkëtar i Karont
që çon dikë në Had
ai burrë i ligur është një peshkatar
që po kalon perëndimin
dhe nëse stuhia e janarit nuk
do ta degdisi natës së errët
s'di se ku
në mëngjes herët do ta gjesh tek limani
duke shitur atë pak peshk
në kovën e tij plastike.

Mos harro kovën e tij
blu e zbardhur me buzë
të ngëna.

Maskat ranë
por ata (të cilëve u ranë)
para syve tanë u përkulën
në gjunjë
i morën dhe i vendosën
prapë!

Janar 2022

DASHAMIR MALO

Rikthim

Poezi

Unë nuk e di as vitin as muajin
as datën kur ke lindur ti
po me siguri ti do jesh shfaqur
në kohën
kur u shfaqën tulipanët.

PERËNDIM MBI JON

Përëndoi Dielli i ditës së parë
të vitit
Në mbrëmje vonë Toka do të veshë
mantelin e natës
dhe do të vështrohet në portretin e Hënës
si një nuse që vështrohet në pasqyrë
para se të shkojë në shtrat
natën e parë të martesës.

PRANË VENDLINDJES

As bardhësia e dëborës
nuk e lëbardhi sado pak
të zezën e pikëllimit!

As bardhësia e dëborës!

TRËNDAFILAT E DIMRIT

I kuq mes grisë.

Nuk është shi dhjetori
ky mbi kurmin tend.

Janë lotët e majit të merakosur
që iku
shpirti i të cilit ende
kujdeset për ty.

Kjo gjysmëhënë dhjetori
si gjethe e vonuar vjeshte
shkëputur nga kopshtet
e Zeusit!

Kanë një rrezëllim të ujshëm
sytë e tu
si burimi i parë i Tokës
fill pas krijimit të saj

Gjysmë hënë e dhjetorit
më vështron pafajësisht
përmes gjetheve që la vjeshta.

Gjysmë hëna e kësaj mbrëmje
e brishtë dhe lozonjare
vajzë
pa botox dhe filler.

Në muzg gjërat dhe sendet e
humbasin formen
dhe trajtën e tyre
thonë se edhe mendimet e ndryshojnë
trajtën
thonë se edhe dashuria bëhet më
drithëruese

thonë se të gjitha gratë duken të bukura
në muzg.

O zog i bregdetit
a e di se këtyre anëve
dimri ndjen të ftohtë
edhe vetë?

GJENDJE NË DET

Tjetër trumbetoi
se do të kapte peshqit
më të mëdhenj,
tjetër i kapi.

Ndërsa këta peshkatarë të ngratë
rreken të kapin dy peshq
të vegjël,
për t'u rrekur mandej përsëri
për t'i ndarë në mënyrë
të barabartë.

I trazuar Perëndimi
prej të cilit ne prisnim
Lindje të Mëdha!

Më pate thënë se do të vijë
para se të binte gheithi i fundit
i vjeshtës

Gjethet ranë
ra dhe kjo gjethe.
Sikur të mos ishte e fundit!

DITËVE ME SHI

1
Pikë shiu të isha
mbi qerpik të syrit tënd
të qëndroja!

2
Pikë shiu të isha
në cepin e buzës sate
të bija!

SHFAQET BOTA

...Dritare pas dritaresh
qelqe pas qelqesh
shpresa pas shpresash
derte pas dertesh!

Sa pak drita
sa pak
në qytetin tënd dhe timin
feksin në terr
si sytë e një maceje
të zezë.

Ku të të gjej?

U kthye pranvera në mes nëntori
apo ti erdhe dhe ike
pa lajmëruar?

(sipas O. Elitis)

Vera u vra me pikën e parë
të shiut
vjeshttra s'e ndal vajin për ikjen
e saj!

Të piva në një kupë çaji Dafinë
kolla m'u zbut
iku
por jo brenga për fatin tënd!

PERËNDON

S'më ngazëllen gjysma e diellit,
që unë shoh,
se sa më pikëllon gjysma tjetër,
që ka perënduar!

Të prita tek lokali buzë detit.
Nuk erdhe.
Në retinën e syve të mi pasqyrohej
vetëm udha.
Ika.
Kamerieri mori të hollat
që lashë mbi tavolinë
dhe kafen time
të pafilluar.

Unë nuk di si quhen ditët
e javës.
Thjesht të gjitha ato
kam filluar i thërras
me emrin tënd.

HIRI

Rrotull Vezuvit ecën shpenguar,
mbi hirin shkel pa drojë,
s'mendon për llavën tek sheh kraterin,
çdo gjë e merr si lojë.

Veç një vullkan je dhe ti vetë,
një llavë brenda vetes mban,
mban urtësi edhe përçartje,
njëherësh fllad edhe tufan.

Flaka, prushi, llava na mësuan,
një tjetër syresh Feniksi na e dha;
prej hirit (ri)lind jeta vetë,
dhe dashuritë e mëdha.

Përqark kraterit sillem dhe unë,
veç mendja m'ikën nërrati,
s'e s'më magjepsi jo Vezuvi,
sa ç'më magjepse ti!

Mes dimri, acar,
anëdetit fryn një erë shtrigane,
e marrosur.
Flamuri i kuq valvitet nxitimthi
më të majtë më të majtë
më të lartë
si flaka e një zjarri
që brambullon

“Grila e bardhë”. Ja një roman me një titull simbolik që na befason dhe na shtie në mendime.

Grila shpreh idenë e hapjes dhe idenë e mbylljes, pra, është një simbol ambivalent.

E bardha është ngjyra e dëlirësisë dhe e optimizmit. E bardha gjithashtu, të sjell ndërmend frymën e armëpushimit në një konflikt të ndezur, më së paku, mes dy palëve. Ç’po kërkon të na përcjellë kjo simbolikë?

Po vetë ky roman na befason: s’është romani tradicional epistolar, as një roman modern në bazë e-mailesh që u shfaq një herë në letërsinë shqipe me romanin e Rudina Xhungës, është diçka më tepër: në këtë vepër protagonistja komunikon me një algoritëm, një krijesë të inteligjencës artificiale që ze një vend në mes të personazheve me emrin e dykuptimtë ARTI që shpreh qenësinë e tij, po edhe lidhjen me artin e të lexuarit të mendjes. Ky personazh i çuditshëm luan rolin e mikut për protagonistin e romanit, një mik që ngjan si i dashur.

Këtë roman e ka shkruajtur Raimonda Belli Gjençaj, një përfaqësuese e drejtimit realist në letërsinë shqipe që me veprën e re e rinovon veten, duke u qëndruar besnike rrënjëve të veta.

Në këtë vepër romanore rikthehen tema të dashura për autore: tema e luftës së gruas për emancipim social dhe moral (kësaj teme i përgjigjet emri i protagonistes Elira, pra, një njeri që aspirojnë drejt lirisë dhe mbase e arrin atë.)

Në roman kanë vendin e tyre edhe tema e solidaritetit, e dashurisë njerëzore pranë temës së dashurisë erotike, pra *Eros* dhe *agape*.

Ndërthurja e këtyre temave, e aspiratës për liri e njeriut në përgjithësi dhe gruas në veçanti, dy llojeve të dashurisë që e bëjnë jetën të plotë dhe i kundërvihen konceptit egoist të një shoqërie konsumiste shpreh pasurinë e problematikës së romanit dhe mishëron një mesazh të lartë vlerash njerëzore që ndeshen në kundërshtimet e përhapura sot.

Romani është ndërtuar në vetë të tretë, po fokusohet kryesisht me këndvështrimin e një personazhi, të protagonistes mbi të cilën bie drita kryesore e prozhektorit autorial ndërsa personazhet e tjerë ndodhen në një zonë hije – dritash.

Personazhet zbulohen përmes dialogëve me një teknikë pothuajse teatrorë, po edhe përmes ligjëratës së zhdrejtë të lirë që jep zërin e personazhit të ndërthurur me atë të rrëfimitarit në dukje objektiv. Autorja nuk e përdor “përroin e ndërgjegjes” as monologun e brendshëm.

Përkundrazi në këtë vepër në kundërshtim me romanet e tjerë të autore është shtuar përdorimi i retrospektivës.

Krahas protagonistes në roman ndriçohet në veçanti personazhi i shoqes së saj të fëmijërisë me të cilën ajo ka një marrëdhënie miqësore më tepër të llojit nënë-bijë sesa të mikeshave-motra, Narinës, grua më e pjekur se ajo në moshë që e do si fëmijën e vet. Pranë saj ndodhet një tjetër personazh, burri që dashuron ajo, Iliri (edhe ky emër është kuptimplotë dhe shpreh një personalitet të pasur dhe të lirë).

Pasojnë personazhe të tjerë, të skicuar më lehtë, Aleks, burri me të cilin Elira martohet pa dashuri dhe farkëtari i fatkeqësisë së saj, arkitekti Ernesti me të cilin ajo përjeton një dashuri të vonë, edhe ajo fatkeqe dhe një varg personazhesh episodikë, bartës vlerash dhe kundërvlerash.

Edhe në këtë roman social-psikologjik pasqyrohen dy kohë si në romane të tjerë të autore: koha e diktaturës komuniste, e karakterizuar nga shtypja e lirisë së individit që vetëtin herë pas here përmes retrospektivës dhe koha e sotme, e ndërtimit të një demokracie të brishtë, kaotike me elementë të anarkisë. Në të dyja kohët shihet si personazhet bartës vlerash njerëzore luftojnë për realizimin e këtyre vlerave.

Në roman nuk ekziston një vijë e prerë ndarëse midis së mirës dhe së keqes që t’i grupojë personazhet në mënyrë skematike si pozitivë dhe negativë.

Vetë protagonistja është e dyzuar: në shpirtin e saj ndeshen dy qenie: mësuesja dhe poetja idealiste dhe një krijesë që synon rehatinë e qytetit, pasurinë dhe lavdinë. Për shkak të konfliktit midis këtyre qënieve që zgjat tërë jetën protagonistja kryen një gabim tragjik që përcakton fatin e saj, heq dorë nga dashuria e saj e parë e pastër për t’u martuar me interes. Ajo më vonë e përjeton katarsisin e pendimit, rilind përmes amësisë, përpigjet të çajë përpara. Së fundi, kërkon strehë te inteligjenca artificiale, një rrugë që ndiqet sot nga shumë veta, krijon një miqësi virtuale që i jep disa iluzione ngushëlluese. Po mandej vjen ndriçimi i papritur që ka forcën e një goditjeje, takimin me të dashurin e parë, ndërgjegjësimi për boshllëkun e jetës së saj që më vonë thellohet nga gabimi i pavetëdijshëm i Artit.

Fundi i romanit është një katarsis që rrezaton një dritë shprese: nuk është hepi-endi tradicional, po jep idenë e një rilindjeje morale, duke triumfuar mbi ndjenjat mesquine dhe

“Grila e bardhë” e Raimonda Belli Gjençajt, "Dituria"

Një bardhësi e ndritur simbolike

Nga Prof. dr. Klara Kodra

iluzionet shterpe.

Romani “Grila e bardhë” është ndërtuar më tepër se mbi shkakësoren mbi të paparashikueshmen që buron nga thellësitë e nënvetëdijes dhe lojërat e çuditshme të fatit.

Befasitë në vepër ndjekin njëra-tjetrën meqenëse në këtë roman rrëfimtari di po aq sa personazhet.

Lexuesi bashkë me personazhet – për të qenë të saktë, bashkë me protagonisten, kalon nga një e papritur në tjetrën, kështu që kureshtja e tij qëndron e ndezur.

Ritmi i rrëfimit ngjan i shpejtë, po ngadalësohet herë pas here nga kalimet në retrospektivë që e thellojnë ndriçimin e botës shpirtërore të protagonistes – dhe të mikes së saj të ngushtë. Ndodh edhe që një personazh, i lënë në gjysëm dritë si Ernesti, befas del në dritën e tij të vërtetë, mungesën e sinqeritetit në lidhjen shpirtërore me protagonisten që e sheh këtë lidhje si dashuri të mundshme.

Autorja vë re edhe disa nuanca tepër të holla psikologjike: shkëndijat e urrejtjes në gjirin e dashurisë miqësore në çastin kur shoqja e ngushtë zbulon të fshehtë të protagonistes dhe ia kumton këtë zbulim pa takt; nuancat e mëshirës në gjirin e urrejtjes kur protagonistja vihet në vendin e të shoqit që po vdes dhe pa dashur ndjen një lloj dhemshurie për të dhe ia kupton acarimin e natyrshëm.

Këtu shkrimtarja shfaq mprehtësi.

Mund të flasim gjithashtu për një strukturë matematikore të veprës: Elira, protagonistja është e pranishme në tërë kapitujt e romanit dhe shoqja e saj e ngushtë, Narina, qëndron pranë saj; prania e saj ndihet edhe në kapitujt e romanit, ku në fakt ajo mungon përmes paragrafesh të shkurtra; Ilirit, të dashurit të protagonistes i kushtohen afërsisht 20 faqe, duke bashkuar të tashmen me të kaluarën, megjithatë karakteri i tij del i gjallë, me çiltërsinë, vendosmërinë, dashurinë për jetën e thjeshtë, aftësinë për një dashuri të thellë.

Ndonjë personazh episodik që i kushtohen pak faqe ndriçohet si prej një vetëtime siç ndodh me Suzin, të shoqen e Ilirit që del si një personazh i thjeshtë, i përkushtuar ndaj familjes, i gjerë, i etur për të komunikuar që përjeton një çast xhelozie, po e kapërcen thujasë menjëherë ose Vitoria, një grua e thjeshtë, po zemërmadhe, me një admirim për



poezinë.

Narinën, shoqen e ngushtë të protagonistes e njohim në fillim në kohën e rënies së saj fizike me të cilën lufton shpirti i saj i fortë dhe i pamposhtur: ajo ndriçohet herë pas here nga restrospektiva. Në disa çaste ngjan si një tip ku mbizotëron sfera racionale mbi ndjenjën, në një çast tjetër si një tip i pasionuar që mund t’ia nënshtrojë gjithçka ndjenjës.

Aleksin, të shoqin e Elirës, e njohim kryesisht në një dritë negative përmes kujtimeve të saj në egoizmin e tij maskilist dhe dëshirën për të sunduar në familje që është tipari i tij kryesor dhe gjithashtu me hipokrizinë me të cilën përpigjet t’i mbulojë të metat e veta dhe të shtiret si bashkëshort i kujdesshëm dhe i përkushtuar.

Ndofta autores i duhej ta ndriçonte edhe më në kompleksitetin e karakterit të tij në të cilin mund të ketë pasur vuajtje, të cilat merren vetëm me mend ose ndonjë vetëtimë të rrallë mirësie.

Aleks i është një personazh i besueshëm, në atmosferën e Shqipërisë së kohës së diktaturës ku patriarkalizmi vazhdonte të gjallonte i fshehur dhe madje në kohën e sotme kur, ndonëse gratë kanë ecur përpara së tepërmi, nuk është çrrënjësuar koncepti i gruas si *pronë*, si *send* nga ana e mjaft burrave, të zotët për të arritur gjer në krim. Aleks i mjaftohet me një vrasje shpirtërore të ngadalshme të gruas së vet e cila i pranon këto vuajtje nga dashuria për fëmijët, ndjenjë fisnike në vetvete, po e konceptuar jo drejt, meqenëse e pengon protagonisten t’i japë fund një martese të gabuar.

Një personazh tepër i veçantë, disi i çuditshëm, të cilit i kushtohet gati gjysma e kapitujve të romanit është ARTI, kjo krijesë e inteligjencës artificiale, e përsosur nga ana e mendjes, madje edhe në imitimin e ndjeshmërisë njerëzore, po pa ndjenja të vërteta, një krijesë e përsosur e teknologjisë, e ecjes përpara të shkencës, e cila megjithatë s’mund të konkurrojë dot me natyrën (apo me Perëndinë?). Përmes krijimit të këtij personazhi dhe të lidhjeve virtuale të Elirës me të çmitizohet nga ana e autore një mit modern që është pikërisht inteligjenca artificiale dhe streha e mundshme që mund të arrihet në marrëdhënie me të; tërë arritjet e teknologjisë nuk kanë fuqinë e një përqafimi të thjeshtë njerëzor. Këtë e pohon fundi i goditur i romanit: pajtimi i dy mikeve të vjetra dhe përqafimi midis tyre.

Raimonda, si autore, kishte krijuar një personazh të ngjajshëm me Artin në romanin e saj të fundit për fëmijë, një robot simpatik që deri diku humanizohet.

Arti në roman nuk del me një ftohtësi çnjerëzore, madje ai mund të fitojë një lloj simpatie nga lexuesi, po nuk del dot nga caqet e qetësisë së vet: është i përsosur si *makinë*, po s’e luan dot rolin e *njeriut*.

Shohim pra se autorja tok me problemet e shumta sociale dhe morale shtron një problem tepër modern: a mund të krijojë njeriu përmes mençurisë dhe arritjeve teknologjike, krijesa që të jenë të barabarta me të dhe madje t’ia kalojnë? Përgjigjja e autore është “jo” dhe këtu ajo tregohet e sigurt, ndonëse problemeve të tjera nuk u jep një përgjigje të prerë, të llojit skematik me të cilat na kishte ushqyer drejtimi skematik i realizmit socialist.

Autorja është një shkrimtare realiste, po e një realizmi të tipi modern, jo klasik: është përfaqësuese e një orientimi të caktuar në letërsinë bashkëkohore. Romanet e saj janë të tipit elitar: ajo i përgjigjet “thirrjes së mendimit” për të cilin fliste Milan Kundera, po nuk janë romane filozofike, as romane ku të mbizotërojnë meditim, janë romane ku veprimi luan rolin e vet dhe gjithashtu vepra ku ka depërtuar psikologjizmi. Janë vepra që komunikojnë me publikun e gjerë dhe njëkohësisht e ngrenë atë më lart se vetja, e nxisin për të menduar dhe për të shtruar pyetje. Sidoqoftë lexuesi, tok me grilën që ngrihet, e gjen një përgjigje, që rrënjët i ka në qytetërimin e njeriut: nuk duhet t’i shembim kurrë urat e komunikimit. Duhet ta lëmë gjithmonë një shteg, për t’u rikthyer tek njëri-tjetri.



Hoteli gjendej matanë lumit, që dukej sikur veçonte pjesën historike të qytetit me zonën e qetë ku mbizotëronin ndërtime të larta të godinave që i përkisnin bankave. Rruga vazhdonte e njëjtë dhe përtej urës apo urave që të çonin drejt qendrës, mes atyre ndërtesave tipike ku në lartësi mund të shikoje lloj- lloj mrekullish. Nga tej lumit hoteli qëndronte si një vend meditimi ndërsa syri vështronte larg gjithë madhështinë që shfaqej në horizont në atë pjesë të populluar me turistë, dyqane suveniresh që qëndronin hapur deri vonë midis dhjetëra fantazive të vendosjes së portreteve të Mozart-it dhe Klimt-it, të ideuara e stampuara në lloj- lloj suveniresh, si krenari e ligjshme e atij vendi, midis pikturës dhe muzikës si një pasaportë se e kishe vizituar atë shtet. Pasditja i gjeti në hotel e më pas kur qyteti ish ndriçuar prej dritave, ecën drejt qendrës. U vërtitën rreth zonës së Katedrales, ku fare pranë në një rrugicë të vogël gjendej shtëpia legjendë e gjeniut të muzikës, në të cilën pas disa ditësh do interpretonin si duo. Koncertistët, interpretuesit e muzikës klasike, instrumentistët, kishin ritualet, rregullat, disiplinën dhe regjimet e tyre, që përfaqësonin një botë krejt tjetër, ku profesioni i bënte të ndryshëm nga ai i njerëzve të zakonshëm, që mundoheshin të shëtitnin, vizitonin e fotografonin muzetë, vendet historike, kafenetë e vjetra të mbipopulluara. Muzikantët u nënshtroheshin kodeve unike, gjuhës universale, të pakuptueshme për të tjerët, ritualeve të studimit, provave në ditët para koncertit. Në atë orë mbrëmjeje qëndruan para derës së mbyllur të shtëpisë së dikurshme të gjeniut të muzikës, pozuan të dyja e veçmas, thujse atje po realizonin një provë gjenerale të koncertit, që të kujtonte provat në tavolinë për vendosjen në skenë të ndonjë vepre skenike. Nga pas portreti i Mozart-it lëvizte pas xhamit me ngjyra në mënyrë të përsëritur si sinjali i mrekullisë që do ndodhte kur do interpretonin në atë sallë magjike. Ajo gjetje në dritaren e ndërtesës ngjante si kujtesë se kompozitori gjendej sërish aty me muzikën, dokumentat, fotot, violinat dhe se gjithçka duhej të ish e përsosur. Ishte hera e dytë që shfaqej aty, së pari si fituese në një konkurs kompozicioni, ku përkujtohej violinisti e pedagogu i shquar Arnold Rose, koncertmaestri legjendar i Filarmonisë së Vjenës. Ceremonia kish përfshirë dhe një tjetër konkurs interpretuesish violinistë e pianistë, niveli i të cilëve të linte pa fjalë. Fituesit e çmimeve të kompozicionit, si dhe pianistë e violinistë të kategorive të ndryshme ishin rreshtuar së bashku. E teksa ish ngritur për të marrë certifikatat e dy fitoreve për dy pjesët e saj kish menduar se interpretimi me violinë atje do ish një mrekulli. Nga publiku i bënin me shenjë të ulte certifikatat e çmimeve teksa fotografonin, po ajo thujse nuk dëgjonte ... Kish dashur të tregonte në vendin e saj të largët se rëndësi kish muzika, jo portreti... Ndoshta fytirën e kish mbuluar disi e turpëruar për faktin se ndonjëherë kish ngritur zërin për programet e studentëve në provimet e violinës, ku koncertet e Mozart-

Nga Bechtein te Bechtein

Nga Ina Kosturi

it ishin të detyruara në hyrje e dalje të çdo cikli Bachelor e Master. Në mendje i erdh një moment nga rrëfimi i Markez-it, inati i tij në thonjëza me Shopen-in e madh për shkak se një punonjëse e bibliotekës i vendoste të njëjtën pjesë sa herë shkonte për të studiuar! Gjatë natës shiu pushtoi gjithçka në një stinë që i dukej e çuditshme. Rrobat e dimrit dukeshin mëse normale në atë vjeshtë pa emër ku gjethet në pemë ishin akoma jeshile. Një stinë e rrallë ku për siguri shalli e dorashkat shërbenin si ornamente të duhura për dikë që do interpretonte në koncert. Trami përshkroi në një trajektore thujse rrumbullake një pjesë të madhe të qytetit, midis stacioneve ish shfaqur godina madhështore e Parlamentit ndërsa çdo vështrim përtej xhamit dhe shiut ndeshte me pamjet e ndërtesave unike dhe veprat e artit në to. Ecën mes shiut në rrugën e qetë që të çonte në derën e hekurt të Pallatit Ehrbar. Holli i katit të parë në kombinimin e të bardhës me të zezën ofronte një pamje gati misterioze. Në të djathtë gjendej salla e madhe, prej nga shkronjat në pianon e skenës i dhanë sinjalin e parë të mirëseardhjes. E vështroi gjatë sallën, pianon, derisa teksa ngjitej për në katin e dytë, ku ndodhej studio e provave u ndesh me një stendë të madhe që qëndronte në sheshpushimin midis kateve. Korridorri, në ndryshim me katin e parë ofronte një pamje moderne. Studio e provave quhej “Egmond”, gjendeshin në Konservatorin Beethoven, ndërsa para çdo studioje qëndronte një tavolinë rrumbullake, disa portrete dhe një vazo lulesh në harmoni e kombinim perfekt midis ngjyrës së bardhë, kremi dhe blusë. Në studio gjendeshin dy piano, njëra e madhe ose me bisht siç quhej dhe tjetra piano muri. Kombinimi brenda studios varionte, midis të bardhës dhe blusë, ndërsa në cep të dhomës bashkë me leggio-t ndodhej një tjetër vazo me lule mbi një tavolinë xhami, ku qëndronin dhe dy albume pikturash. Ishte një album i Claude Monet, që bashkë me kohën e dytë të sonatës që kish krijuar e interpretonte e çuan në kohë të largëta të liceut, kur piktorët impresionistë e të rrymave të tjera të konsideruar atëherë modernë ishin pjesë e kuriozitetit të saj dhe çdo informacion për ta konsiderohej i çmuar.



Albumin e vështroi nga larg, pasi programi i recitalit kërkonte përkushtim maksimal. Koha e dytë e sonatës e kthente tutje në kohë të largëta të shtëpisë së vjetër, në sa e sa momente perëndimesh, ngjarjesh. Hera-herës i duhej të shkëputej nga kjo ndjenjë e së shkuarës e të tregohej e vëmendshme me partiturën që gjendej para saj dhe luante bashkë me pianisten. Fakti që e kish shkruar vetë pjesën nuk i jepte ndonjë prioritet, përkundrazi një ndjesi gati të çmendur për të fantazuar mes notave...Edhe pse albumi i “babait” të impresionizmit gjendej në tavolinë, edhe pse e kish shkruar vetë atë vepër duhej ti qëndronte besnike partiturës. E vetmja lidhje midis pikturës impresioniste dhe interpretimit në instrument ish gjendja emocionale, intensiteti i vibratos dhe ndjenjës. Në pushim të provave u ulën në një lokal të vogël në fund të rrugës, në ca tavolina të drunjta me ngjyra ku ekspozoheshin dhe çanta të modeleve e madhesive të ndryshme, të punuara në ambientin ngjitur me kafenenë. Tavolinat e drunjta me ngjyrë i kujtonin fëmijërinë, pa ditur se pas pak do ndjehej si personazh romani. Në studion e provave po vendosej një piano fringo e re, marka e së cilës kish gjithë ditën që i shfaqej nga piano e sallës së madhe, stenda në sheshpushimin midis kateve. Ish larguar në distancë e kohë larg në vendin e saj ku një stol i rrumbullakët i të njëjtës markë Bechstein i kish shërbyer gjatë fëmijërisë për të bërë me komoditet detyrat e të rrotullohej me shpejtësi për tu kthyer në anën tjetër të dhomës. Jo vetëm kaq, stoli mund të ulej e ngrihej si një stol magjik që bashkë me mbulesën e tastierës kishin mbetur relikte nga një piano e mrekullueshme me bisht, tejet luks i asaj kohe po dhe kohës së sotme që gjyshja e saj nuk e kish më...Ish koha kur në vendin e saj në kohën e të parëve merrnin gjithçka, kur shtëpia historike në Bulevardin e Shën Gjergjit në Korçë ish rrafshuar dhe bashkë me të ish zhdukur dhe piano... Një piano me bisht të cilën me mundim e zbrisnin e ngjisinin gjashtë hamenjë në rastet e ndonjë koncerti të rëndësisëhm në Kinema Majestic. Mbulesa e tastierës ishte një copë e gjatë e trashë e kuqe

e mbi të ishin qëndisur lule ngjyrë lejla dhe jeshile. Ajo dizenjo kish mbetur e paharrur në mendjen e saj për shkak se mbulesën apo shallin siç e kish pagëzuar e kishin ndarë në dy pjesë dhe ja kishin qepur si zbulurim në një kostum dimëror të vogël me fund e bluzë. Bluza mbërthehej pas ndërsa në pjesën e përparme qëndronin dy pjesë të mbulesës së qëndisur. Kjo ish një histori e çuditshme, e rrallë. Për zbulurim mund ti vendosnin shumë gjëra të tjera, copa me lule të mbetura nga pako që kishin ardhur nga Amerika, fundja mund tja kishin qëndisur atë kostum të vogël me pamje skenike. Me atë mbulesë të markës së famshme Bechstein kishin dashur ta bekonin, në pamundësi për të patur një piano tjetër ... Nuk kish ndodhur ndonjëherë që mbulesa e tastierës që ajo e kish pagëzuar me emrin “shall” të vendsosej në një kostum fëmijësh ! Ish larguar nga pallati Ehrbar mes shiut që vazhdonte shtruar drejt autobuzit të linjës nga dukeshin fasadat e pikturuara të disa ndërtesave. U gjend në qëndër pranë Operës për të vazhduar në të djathtë. Atë qytet nuk mund ta kuptonte pa një vizitë në shtëpinë botuese Universal Edition zyrat e së cilës gjendeshin nw Musicverein ...Hynte me emocion në korridoret e ndërtesës së famshme nga hyrja për artistët, ngjitej në shkallët e mbuluara me qilimin e kuq, për tu përfshirë në biseda mbreslënëse me specialistet e publikimeve dhe njohëset të jashtëzakonshme të muzikës klasike të djeshme e të sotme, ndoshta për tu frymëzuar e shkruar një pjesë të re në të ardhmen.

Së fundmi ish ndaluar në sallën ku do të zhvillohej koncerti. Salla Bosendorfer në Mozarthaus ish e mrekullueshme për akustikën, magjinë, sesi zbrisje dy kate më poshtë e gjendeshe në një sallë intime që siç e quante pianistja, dukej se do shfaqej vetë Mozart! Pianoja e një marke tjetër, nga e cila kish marrë emrin dhe salla të magjepste me tingullin e mrekullueshëm si dhe atë detaj të veçantë të trëndafilave që dukeshin në pjesën e drunjtë pas tastierës, në pjesën e kapakut.

Koncerti në atë sallë me piano e akustikë të mrekullueshme ish kënaqësi e privilegj. Të nesërmen, në momentin e mbarimt të koncertit, dikush kish ardhur dhe e kish përqafular. Muzika është e mrekullueshme i kish folur në një anglishte me theks të ëmbël e rrubullakosur ku dallohej gjuha e saj, portugalishtja. E mbante mend nga ceremonia e konkursit të kompozicionit në të njejtën sallë disa muaj më parë. E nderuar si pianiste e pedagoge ajo kish qëndruar krah emrave të njohur të botës muzikore në atë konkurs. Ndërsa kjo koincidencë dhe fakti se ajo kish ardhur posaçërisht në koncert e të nesërmen nisej për Brazil e kish emocionuar. Në përqaftimin e fjalët e saj kish gjetur ngrohtësinë e atij shalli të fëmijërisë qepur në kostumin e saj të vogël. E kishin kthyer në kohë të largëta e sikur kish ndërë dashurinë e duartrokritjen e atyre që nuk ishin më, njerëzve më të afërm që ndoshta e bekonin nga larg. Me dashuri ja kishin qepur atë shall të pianos e në fakt në atë sallë kishin ardhur si shqiptaret e para, jo vetëm si interpretuese po dhe si krijuese e tre veprave. Përqaftimi i pedagoges nga San Paolo, pamja e saj e bukur e fisnike, mirësia e dashuria e saj i kujtoi dashuritë e munguara të njerëzve më të afërm që nuk ishin më. Ish ndërë si personazh romani... Fotografinë e vjetër dhe të sajën para stendës i vendosi bashkë ndërsa shalli i qëndisur ish rrugëtimi nga Bechtein tek Bechtein ...



Na ishte njëherë një familje me mbiemrin Grimm, që bënte një jetë e cila ishte gjithçka tjetër, përveçse përrallë. Në shtetin gjerman të pyllëzuar të Hesenit, Filipi, një nëpunës qyteti, jetonte me gruan e tij, Dorotean, dhe fëmijët e tyre në një shtëpizë piktoreske. Pjesa e jashtme ishte një e kuqe e hapur tërheqëse dhe dyert ngjyrë kafe e çelët, si të ishin bërë prej biskote xhenxhefli. Dhoma e ndenjes ishte e veshur me letër muri me figura gjuetarësh, mbi fytyrat e të cilëve dy djemtë e mëdhenj, Jakobi dhe Vilhelmi (të lindur përkatësisht në 1785 dhe 1786), u vizatonin me pajajesi mjekra me laps. Shpejt, Filipi u gradua për të shërbyer si magjistrat i një qyteti aty pranë dhe familja Grimm u zhvendos në një shtëpi madhështore me shërbyese, kuzhinier dhe karrocier. Çdo Krishtlindje, familja zbukuronte një pemë me mollë, siç ishte zakoni gjerman. Në verë, fëmijët guxonin të futeshin në pyjet përreth për të mbledhur flutura dhe lule, të bindur se mund ta gjenin rrugën e kthimit për në shtëpi.

Pastaj, një ditë, u shfaq një re e zezë, sikur ta kishte thirrur një shtrigë xhelozë për idilën e tyre familjar. Në vitin 1796, Filipi, vetëm dyzet e katër vjeç, iu dorëzua pneumonisë. Jakobi më vonë kujtonte se kishte parë trupin e babait të tij duke u matur për arkivol. Dorotea dhe fëmijët e saj u urdhëruan të lironin shtëpinë. Pa të ardhurat e Filipit, ata u detyruan për një kohë të banonin në një strehë të varfërisht aty pranë—të mallkuar me pamjen e ish-shtëpisë së tyre dhe oborrit ku dikur luanin, të lumtur, deri në atë që pasoi më vonë.

Jakobi dhe Vilhelmi, Vëllezërit Grimm, përjetuan atë lloj përmbysjeje të fortë të fatit, karakteristike për zhanrin që u bë sinonim me emrin e tyre: përrallën. Një princ i shndërruar në bretkosë; një bijë e dashur e katandisur në shërbyese kuzhine. Aty ku versioni francez i “Hirushes”, nga Charl Pero (Charles Perrault), hapet me Hirushen tashmë të veshur me lecka, duke punuar për njerikën e saj, versioni i vëllezërve Grimm, “Aschenputtel”, fillon me nënën e heroinës në shtratin e vdekjes. Ann Schmiesing, autorja e librit “Vëllezërit Grimm: Një Biografi” (*Yale*), vëren se ndryshimi e transformon një “histori ‘nga lecat në pasuri’ në ‘nga pasuria në lecka e sërish në pasuri’—një trajektore që, rastësisht, është paralele me përvojën e vetë vëllezërve Grimm”. Versioni i vëllezërve Grimm e “masakron” përrallën franceze edhe në mënyra të tjera. Kur princi shfaqet me këpucën fatlume, motrat e njerikës së Aschenputtel-it presin thembrat për t’i bërë këmbët të futen brenda. Secila arrin deri te portat e kështjellës para se princi të vërë re gjakun që vërshon gjithandej.

Fryma e errët e përrallave të vëllezërve Grimm është pothuajse një batutë në këtë pikë, dhe mbiemri i tyre, që do të thotë “i zymtë” ose “i zemëruar” në gjermanisht, nuk ka ndihmuar. Edhe gjatë jetës së tyre, vëllezërit ishin subjekt i lojërave të detyrueshme të fjalëve. Jakobi, një filolog i arriër, falënderoi një mik që i rezistoi dëshirës për të bërë shakanë e dukshme pasi botoi librin e tij “Gramatika Gjermane”: “E vlerësoj shumë që nuk e keni qortuar ‘Gramatikën’ (*Grammar*) time si ‘Të Zymtën’ (*Grimmer*).”

Në të vërtetë, ka një ashpërsi pothuajse komike në përrallat e tyre, ndër to “Si luanin disa fëmijë duke therur”, në të cilën një palë vëllezër e motra, pasi kishin parë babanë e tyre të therte një derr, provojnë ta bëjnë këtë akt e njëri-tjetri. Në “Trëndafilin e Egër”, versioni i vëllezërve Grimm për “Bukuroshen e Fjetur”, krushqit që përpiqen të arrijnë vashën e fjetur ngecin në gardhin me gjemba që rrethon kështjellën e saj, duke vdekur “në mjerim”.

Këto histori përbëjnë një përmbushje dëshire për njerëzit që duan të besojnë stereotipet rreth ashpërsisë gjermane, gjë që mund të jetë një masë e suksesit të vëllezërve Grimm. Qëllimi i tyre në mbledhjen e folklorit të tillë—krahas përrallave, vëllezërit Grimm botuan legjenda, këngë, mite—ishte të krijonin një identitet kombëtar koheziv për germanofolësit. Kjo është arsyeja pse vëllezërit, veçanërisht Jakobi, shkruan gjithashtu libra mbi filologjinë gjermane dhe nisën atë që synohej të ishte fjalori më gjithëpërfshirës i gjuhës gjermane, *Deutsches Wörterbuch*. (Duke punuar rëndë deri në vitet e fundit të jetës, ata arritën deri të fjala *frucht*, frut).

Vëllezërit Grimm ishin gjermanistë para se të kishte një Gjermani. Kur ata lindën, “Gjermania” përmbante atë që historiani Perry Anderson e përshkruan si një “labirint principatash xhuxhe”, dhe ata vdiqën jo shumë kohë përpara bashkimit të vendit, në vitin 1871. Në periudhën ndërmjet, kufijtë e atdheut të tyre ndryshuan herë pas here, me pushtimin napoleonik të Hesenit në vitin 1806, Kongresin e Vjenës dhe ndarjet pas-napoleonike të Evropës, dhe, përfundimisht, me ngritjen e Otto von Bismarck-ut. Mes një çoroditjeje të

Vëllezërit Grimm ishin të zymtë për një arsye

Nga Jennifer Wilson
The New Yorker

tillë gjeografike, vëllezërit Grimm besonin se gjuha dhe traditat e përbashkëta kulturore mund të ishin filli lidhës i një populli, i popullit të tyre. Mjaftonte vetëm që të vinte dikush, ose dy veta, me një çark për t’i tjerë.

Edhe pse historia i ka bashkuar, Jakobi dhe Vilhelmi ishin dy burra mjaft të ndryshëm nga njëri-tjetri. Vilhelmi ishte *bon vivant*-i, përballë natyrës introverte të Jakobit. Vëllai i madh ishte studiuesi më i arriër. Kërkimet e Jakobit në fone tikë themeluan atë që sot në gjuhësi njihet ende si Ligji i Gritit. (Ai kishte vënë re modele sipas të cilave bashkëtingëlloret nga gjuhët e tjera indo-evropiane ndryshonin ndërsa hynin në gjermanisht.) Kur, rreth të pesëdhjetave, vëllezërit pranuan emërime në Universitetin e Berlinit, Jakobi refuzoi çdo nderim apo pozitë të shquar që do ta largonte nga tryeza e tij e punës. “Me gëzim do të vishja një rrobë shtëpie të punuar me materialin më të ashpër dhe nuk do të përpiqesha për asgjë tjetër veç kësaj,” i tha ai me shaka një miku. Ndërkohë, ditari i Vilhelmit nga ajo periudhë e tregon atë duke parë një shfaqje të “Ëndrrës së një nate vere”, duke shëtitur në kopshtet botanike dhe duke vizituar Kabinetin e Artit, ku ishte ekspozuar kapela e Napoleonit. Një “ditë e rrallë pa asnjë vizitë”, shënonte ai në një fragment.

E megjithatë, një biografi e përbashkët është e vetmja që duket e përshtatshme; ndarja e njerit vëlla nga tjetri pas vdekjes duket e barabartë me dhunimin e një kufome, sepse Jakobi dhe Vilhelmi ishin tmerrësisht të pandashëm. Kur, gjatë viteve të studimeve, Jakobi punoi për pak kohë jashtë vendit për një nga profesorët e tyre, Vilhelmi i shkroi: “Kur u largove, mendova se zemra do më ndahej më dysh. Nuk mund ta duroja dot. Ti sigurisht nuk e di se sa shumë të dua.” Jakobi u zotua se kjo nuk do të ndodhte më kurrë dhe skicoi se si shpresonte të ishte jeta e tyre pasi të përfundonin studimet: “Me gjasë do të jetojmë mjaft të tërhequr dhe të izoluar, sepse nuk do të kemi shumë miq dhe mua nuk më pëlqejnë të njohurit. Do të duam të punojmë me njëri-tjetrin mjaft ngushtë dhe t’i ndërpresim të gjitha punët e tjera.” Kur Vilhelmi u martua, Jakobi jetoi me vëllanë dhe kumatën e re. Një mik dikur iu drejtua vëllezërve në një letër si “Të dashurit e mi grepa të dyfishtë!”

Lidhja e tyre u farkëtua përmes historisë së përbashkët të humbjes dhe izolimit shoqëror. Pas vdekjes së Filipit, Jakobi dhe Vilhelmi nuk gëzonin më statusin që vinte nga të qenit djemtë e një magjistrati. Kur u regjistruan në Universitetin e Marburgut, në fund të adoleshencës, atyre iu desh t’i paguanin vetë shpenzimet; bursat zakonisht rezervoheshin për djemtë e aristokratëve dhe pronarëve të tokave. Jakobi e shihte situatën e tij në Marburg të ngjashme me përbuzjet që populli gjerman—të cilit i mungonin avantazhet politike dhe ekonomike që vinin nga të qenit pjesë e një shtet-kombi—vuanë në skenën evropiane. Ai shkroi në autobiografinë e tij: “Skamja e nxit njeriun drejt zellit dhe punës, e mban larg nga shumë shpërqendrim dhe i injekton një krenari fisnike që e mban të vetëdijshëm për arritjet vetjake, në kontrast me atë që ofron shtresa shoqërore dhe pasuria... Një pjesë e madhe e asaj që gjermanët kanë arritur në përgjithësi duhet t’i atribuohet faktit se ata nuk janë një popull i pasur.”

Ndërsa ishin në universitet, vëllezërit ranë nën ndikimin e Friedrich Carl von Savigny, një profesor i ri i drejtësisë, i cili mbronte idenë se ligjet nuk duhet t’i imponohen një populli, por, përkundrazi, duhet të burojnë prej tij. Një ligjvënës, pra, duhet të jetë një lloj historiani, ose, akoma më mirë, një filolog, i vëmendshëm ndaj dëshirave të një populli siç shprehen në gjuhën dhe rrëfimet e tij. Në një studim mbi vëllezërit Grimm dhe nacionalizmin gjerman, studiuesi Jakob Norberg argumenton se, nëse Platoni parashikonte një “mbret filozof” për të sunduar qytet-shtetin, Gritit përfytyronin një “mbret filolog” për të udhëhequr shtet-kombin.

Ishte gjithashtu në Marburg, dhe përmes Savigny-t, që Gritit u njohën me Achim von Arnim dhe Clemens Brentano, dy shkrintarë fisnikë që kishin filluar të mblidhnin këngë popullore gjermane, duke synuar të kapnin *Volksseele*-n—shpirtin e popullit—që i paraprinte Iluminizmit Evropian dhe neoklasizmit francez. Arnim dhe Brentano ishin anëtarë themelues të asaj që u bë e njohur si Romantizmi i Heidelbergut. Nëse Romantizmi i hershëm gjerman, i cili lulëzoi në Jena në vitet 1790, vlerësonte “botëkuptimin individual, subjektiv,” shkruan Schmiesing, “Romantikët e Heidelbergut festonin letërsinë popullore dhe heroike sepse shihnin në të përvojën kolektive të një populli.”

Parimi i Savigny-t e vendoste vullnetin kombëtar në zemrat, ose, më saktë, në gjuhët e njerëzve të thjeshtë. Ndonëse Gritit e nisën duke ndihmuar Arnimin dhe Brentanon, ata arritën ta shihnin veten si veçanërisht të aftë për këtë, si për shkak të varfërimit të familjes së tyre, ashtu edhe për shkak të gojëdhënave që rrethonin shtetin e tyre të lindjes, Hesenin. Ata do të mblidhnin shumë nga përrallat e tyre atje, të bindur se izolimi relativ i rajonit nga rrugët tregtare kishte ruajtur karakterin e tij autentik gjerman.

Edhe Hesenin kishte një tis mitik. Toka ishte populuar në lashtësi nga populli Kati (*Chatti*), i përshkruar nga historiani romak Taciti si më i bëshëm se fiset e tjera gjermanike. Meqenëse pjesa më e madhe e terrenit të thyer ishte pengesë për bujqësinë, mercenarët u bënë eksporti kryesor. Njëzet e pesë për qind e forcave tokësore britanike në Luftën Revolucionare Amerikane ishin nga Hesenin. (Kalorësi pa kokë i Uashington Irving-ut përfliete se ishte fantazma e një ushtari nga Hesenin.) Filozofi Johan Gotlib Fihte (*Johann Gottlieb Fichte*), një baba i nacionalizmit gjerman, madje i akuzoi evropianët se po i mbanin qëllimisht të copëtua trojet gjermane—për ta shfrytëzuar më lehtë trimërinë gjermane për pushtimet e tyre. Pikërisht në këtë peizazh të trazuar, vëllezërit Grimm iu përveshën punës për të thurur një trashëgimi kulturore që mund ta ngrinin lart si flamur.

Kishte dalë në skenë një armik shekullor. Pushtimi i trojeve gjermanike nga Napoleoni ishte një moment kthesë për Romantizmin gjerman. “Shpejt gjithçka ndryshoi nga rrënjët,” kujtonte Vilhelmi, lidhur me trupat franceze që pushtuan qytetin e tij të lindjes, Kaselin, në vitin 1806. “Njerëz të huaj, zakone të huaja, dhe në rrugë të shtëtitje një gjuhë e huaj, e folur me zë të lartë.” Hesenin u përfshi në Mbretërinë e Vestfalisë, të udhëhequr nga Zherom Bonaparti (*Jérôme Bonaparte*), vëllai fatkeq i Napoleonit, i cili mezi kishte mësuar më shumë se tri fjalë gjermanisht: ato për “nesër”, “përsëri” dhe “gazmor”. (Kjo i dha atij nofkën Mbreti Gazmor.) Përfliete se Zheromi lahej në verë të kuqe, gjë që, shkruan Schmiesing, “nëvizonte huajzimin e tij në një rajon të mësuar me verë të bardhë”.

Në fakt, Jakobi shërbeu si bibliotekari personal i Zheromit, por thirrja e tij e vërtetë ishte si një lloj ushtari këmbësorie i folklorit në mes të Luftërave Napoleonike. Më vonë, ai mblodhi një grup folkloristësh që bënë betimin për të “nderuar atdheun” përmes “shpëtimit të letërsisë sonë popullore”. Përrallat që mblodhën ishin thërrimet e bukës që do ta udhëhiqnin popullin gjerman drejt shtëpisë së tij kulturore.

Vëllimi i parë i “Përrallave për Fëmijë dhe Familje” të vëllezërve Grimm u botua në dhjetor të vitit 1812. Ai përmbante tetëdhjetë e gjashtë histori, duke përfshirë klasikë si “Rapunzela”, “Hansel dhe Gretel”, “Borëbardha”, “Rumpelstiltskin”, “Trëndafilin e Egër” (*Bukuroshja e Fjetur*) dhe “Kësulëkuja”, së bashku me shënime të gjata shpjeguese. Kritikktë nuk ishin të sigurt se çfarë të mendonin për një përmbledhje “përrallash për fëmijë” që vinte me shtojca studimore dhe kafshë eposore. “Zonja Dhelpër”, ku një dhelpër me nëntë bishta, të cilët perceptohen si simbole falike prej gëzofti, vë në provë besnikërinë e gru-

as së tij, nuk ishte lloji i përrallës para gjumit që prindërit kishin në mendje. E njëjta gjë vlente edhe për “Rapunzelen”, në të cilën zana (jo shtriga) kupton se e burgosura e saj flokëgjatë ka marrë vizita nga princi kur, një ditë, Rapunzela pyet: “Pse po më ngushtohen rrobat?”

Për vëllezërit Grimm, kishte rëndësi që të ishin autentikë, jo të përshtatshëm, dhe përrallat, në shumë tradita letrare, nuk ishin gjithmonë të destinuara për fëmijët. Sipas studiueses Maria Tatar, këto ishin rrëfenja popullore që ndaheshin mes të rriturve orëve të vona, ndërsa fëmijët ishin në gjumë. Ajo citon një version francez të “Kësulëkuqes”, në të cilin ujk i madh e i keq ka ndaj vajzës së vogël synime që nuk janë gastronomike. Në atë version, ajo bën diçka të barabartë me një striptizë, duke hequr rrobat ndërsa ujk i maskuar e vështron nga shtrati, duke i dhënë një kontekst më të freskët frazës “Sa duar të mëdha që ke!”

Pastaj, ishte çështja e gjuhës së vëllezërve Grimm—e kursyer, e vrullshme, instinktive, e pafiltruar. Në parathënie, vëllezërit mbureshin për besnikërinë e përmbledhjes ndaj burimeve të tyre: “Asnjë rrethanë nuk është poetizuar, zbukuruar apo tjetërsuar.” Epo, kjo ishte e qartë, ankohej miku i vjetër i vëllezërve Grimm, Klemens Brentano (*Clemens Brentano*), i cili mendonte se e kishin tepruar. “Nëse doni të ekspozoni rroba fëmijësh,” shkruante Brentano, “mund ta bëni këtë me besnikëri pa nxjerrë në pah një veshje që i ka të gjithë kopsat të shkulura, të përlyer me baltë dhe me këmishën që varet jashtë pantallonave.” Por vëllezërit Grimm donin të ruanin kulturën e njerëzve të thjeshtë, jo ta bënin popullin të tingëllonte i kulturuar.

Biografia e Schmiesing për vëllezërit Grimm është e para madhore në gjuhën angleze pas disa dekadash. Mund të jetë e ngjeshur me detaje, por kur lexova “Shtigje nëpër Pyll” (1971) të Murray B. Peppard, një biografi më e qasshme e vëllezërve Grimme, e kapa veten duke ndjerë mungesën e shkurreve më të egra të burokratëve prusianë dhe devijimeve të gjata mbi gramatikën gjermane që ofron Schmiesing. Vepra e saj është një ushqim i bollshëm gjerman. Ajo gjithashtu paraqet gjetje që ndërllojnë imazhin e vëllezërve si puristë etnografikë.

Perceptimi popullor se si vëllezërit Grimm i mblodhën përrallat e tyre u pasqyrua në një ilustrim që u shfaq në një revistë gjermane të viteve nëntëdhjetë të shekullit të nëntëmbëdhjetë: Jakobi dhe Vilhelmi shfaqen duke vizituar një kasolle modeste, duke dëgjuar një fshatare të moshuar. “Kjo skenë baritore nuk ndodhi në të vërtetë,” shkruan Schmiesing. Informatorët e Grimëve prireshin të ishin gra të arsimuara mirë nga familje të pasura, të cilat mblidhnin histori nga fshatarët dhe shërbëtorët që punonin për to. Gruaja në ilustrim, Dorothea Viehmann, ishte vërtet një nga informatorët më të varfër të Grimëve, por përrallat e saj nuk ishin aq “vërtet nga Hesenin” sa i përshkruan dikur vëllezërit. Ajo ishte me origjinë hugenote nga ana e babait, gjë që shpjegon, siç kanë spekuluar studiuesit, ndikimin francez në disa nga historitë e saj.

Schmiesing i rikthehet gjithashtu studimeve mbi ndryshimin e politikës editoriale të Vilhelmit. Ndoshta si përgjigje ndaj kritikave mosmiratuese, ai e përditësoi versionin e dytë të “Përrallave për Fëmijë dhe Familje” për të kënqur normat gjinore të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në botimin e parë, historia e Hanselit dhe Gretelit fillon me nënën e tyre që i thotë babait t’i braktisë fëmijët në pyll. Në botimin e dytë, gruaja e babait—njerka e keqe arketipale—jep urdhrin, sepse ishte e pahijshme të sugjerohej se një nënë biologjike do t’i hiqte qafe fëmijën e saj kaq ftohtë. (Ndërsa babai që pranon gjithçka—është krejt në rregull!)

Edhe pse trashëgimia e tyre mund të jetë si “Nëna Pata” gjermane (figura tregimtare e përrallave), vëllezërit i konsideronin vëllimet e përrallave si një projekt mes shumë të tjerëve, dhe zor se më i rëndësishmi. Në vitin 1829, vëllezërit Grimm, atëherë në të dyzetat, morën punë si bibliotekarë në Universitetin e Göttingenit (*Göttingen*), në mbretërinë e Hanoverit. Atje, Jakobi botoi “Mitologjia Gjermane” (1835). Ai besonte se, ashtu si etimologët mund të identifikonin tiparet e gjuhëve të lashta përmes pasardhësve modernë, ai mund të përafrohej me mitologjinë e lashtë gjermane përmes folklorit. Ai hulumtoi me imtësi balada, përralla dhe legjenda për referenca ndaj heronjve, grave të mençura, xhuxhëve, gjigantëve, fantazmave, kurave, magjisë e të tjera.

Ndryshe nga “Përrallat për Fëmijë dhe Familje”, “Mitologjia Gjermane” ishte një sensacion kombëtar dhe nationalist. Libri e rinoi plotësisht kompozitorin Richard Wagner. Në autobiografinë e tij, “Jeta Ime”, Wagner shkroi për takimin me “Mitologjinë Gjermane”: “Para syrit

1. Roman për zogun e pikturuar:

...është një episod tronditës, një zog kapet, lyhet me bojë dhe lëshohet sërish dhe në qiell tufa nuk e njeh më si të vetin. Ngjyrat ndryshe, të huaja e bëjnë të duket si një rrezik biologjik. Zogjtë e sulmojnë egërsisht, derisa ai bie dhe copëtohet.

Po bisedonim me profesorin universitar Gëzim Basha, ai gjithmonë të thotë një gjë të re, vepër a emër shkrimtari dhe po e dëgjova me vëmendje, kur po më tregonte për romanin “The Painted Bird” i hebreut polako-amerikan Jerzy Kosiński. Dhe e kërkoja.

Ja, si mund të jenë në shqip ato rreshta për të cilat po flisnim:

“Duhet të ketë qenë një model i rrallë, sepse të gjithë zogjtë e tjerë e sulmuan menjëherë. U hodhën të tërbuar mbi të nga të gjitha anët dhe ajri u mbush me pendë që fluturonin. Zogu i pikturuar përpigjej të shpëtonte, por të tjerët vazhdonin ta sulmonin, duke e çukitur pa mëshirë derisa ra përdhe. Pastaj vazhduan sulmin e tyre të pamëshirshëm, derisa zogu i pikturuar u copëtua në grimca të vogla.”

Është një nga simbolet më të fuqishme të letërsisë pas-Holokaust, të ndëshkohesh jo për atë që bën, por për atë që je.

Në qendër të kësaj parabole të egër është vetë titulli “Zogu i pikturuar” a i ngjyrosur mbase, më afër përmbajtjes. Kjo metaforë e dhimbshme është kyçi për të kuptuar atë denoncim universal të urrejtjes ndaj Tjetrit dhe si një reflektim mbi mungesën e etikës në botën moderne.

Romani, shpesh i lexuar si autobiografik, është më shumë se një rrefim për një fëmijë gjatë Luftës II Botërore, por dhe një pasqyrë e përcudnimit njerëzor, e mekanizmave të dhunës kolektive dhe e përjashtimit të atyre që duken ose janë të ndryshëm. Pra zogu nuk është fajtor që s’është si të tjerët dhe ekzistenca e tij është krimi. Dhuna që buron nga kjo frikë s’është më akt vetanak, por ritual shoqëror i përjashtimit.

Zogu i pikturuar bëhet një anomali që duhej neutralizuar.

Kosiński përshkruan mënyrën se si vetë shoqëria bëhet totalitare në instinktet e saj duke ndëshkuar ndryshimin, duke e përjashtuar pa mëshirë, pa pyetje.

Pra, e keqja nuk lind vetëm nga diktaturat, por edhe nga turma që nuk sheh më individin, por devijimin që duhet eliminuar.

Përjashtimi është dhe krizë etike, i asaj etike që e kuptojmë kur ballafaqohemi me fytyrën e Tjetrit dhe ndjejmë përgjegjësi.

Nga këndvështrimi i Jungut, do të thoshim se turma që sulmon zogun, është duke projektuar mbi të hijen e vet, atë të mospranimit brenda vetes. Viktima kështu bëhet mbartëse e mëkatit të tjetrit, një kurban i ndërgjegjes së përbashkët.

2. Roman për zogun e gjëmbave:

“Sipas një legjende, ekziston një zog që këndon vetëm një herë në jetën e tij, më bukur se çdo krijesë tjetër mbi këtë Tokë. Që nga çasti kur lë follenë, ai zog kërkon një pemë me gjemba dhe nuk gjen paqe derisa ta arrijë. Ai çan mes degëve të saj të ngatërruara egërsisht dhe, duke kënduar, ngul trupin në gjembin më të gjatë e më të mprehtë. Ndërsa vdes, dhimbja e tij shndërrohet në një këngë shumë më të bukur se ajo e bilbilit apo e lareshës.

SI T’I BËSH TË BUKURA FLATRAT E TRAGJIKES?

Triptik me tri zogj në tre romane...

Nga Visar Zhiti

“A është e mundur që edhe Zoti të ketë vdekur në kampet e përqendrimit?” - pyeste Primo Levi. Po ajo ishte një klithmë metafizike nga tmerri i zhdukjes së dritës absolute.

Zogu i pikturuar i Jerzy Kosinskut, Zogu i gjëmbave i Colleen McCullough dhe Zogu i verbuar në romanin tim na vendosin dhe përballë dilemave të Foucault me teorinë e tij biopolitike mbi pushtetin që individi kur devijon nga norma, duhet ndëshkuar për të ruajtur “ekuilibrin” shoqëror, të Adornos, që thoshte se “të shkruash poezi pas Auschwitz-it është një akt barbar” dhe të Camus-it që flet se si njeriu e tejkalon absurditetin e jetës me revoltë dhe krijim, na shpalosin kështu natyrën e dhunës, të artit dhe lirisë.

Çmimi i asaj kënge të bukur është jeta, por e gjithë bota ndalet për ta dëgjuar dhe Zoti në qiell buzëqesh.”

- Colleen McCullough, nga “Zogu i gjëmbave” -

E sillte këtë pjesë botuesi i njohur dhe përkthyesi Bujar Hudhri. “Zogu i gjëmbava” e quan ai romanin “The Thorn Birds” të shkrimtares australiane Colleen McCullough që u bë e famshme në botë pikërisht me këtë vepër.

Më parë ajo ishte neuroshkencëtare, punonte në një spital...

Letërsia e saj, - mendojnë kritikët, - bashkon dashurinë tragjike me sakrificën, konfliktin mes dëshirës dhe ndalimit moral. Fjala s’është për një zog real, por një simbol mitik, metaforë e sakrificës për dashurinë dhe artin, figurë që vjen nga legjenda të vjetra keltike dhe orientale

Ai fragment është çelësi simbolik jo vetëm për romanin, por dhe për njeriun që dashuron deri në dhimbje. Artisti krijon duke u plagosur. Shpirti arrin bukurinë përmes flijimit.

Ai zog nuk këndon për të jetuar, por vdes që të këndoje bukur, qoftë dhe një herë. Bukuria më e lartë lind nga dhimbja më e thellë. Një metaforë universale për artin, jetën, besimin, dhe sakrificën njerëzore.

Është një alegori e pastër ekzistenciale për marrëdhënien mes jetës dhe dhimbjes, bukurisë dhe kuptimit.

Filozofia e bukurisë është dhe si akt absolut, jo si zbukurim i jetës, por si qëllim i saj i fundit. Bukuria nuk është thjeshtë komoditet, por kulm sakrifice, mbase e përafërt me idenë platonike se Bukuria e vërtetë kërkon dalje nga vetja, deri në vetëzhdukje.

Dhe gjëmbat mund të emërtohen si ndalim, kufi, ligj, mëkat, fat, por edhe trup, etj. Zogu nuk vritet nga rastësia, por nga zgjedhja, dramatikisht kierkegaardiane, të vuash për diçka më të lartë se vetja.

Kënga bëhet dhe tejkallim i vdekjes, dhimbja ka marë kuptim, ndërsa trupi shndërrohet në shpirt dhe vdekja në përjetësi.

Duket si një paradoks teologjik, kur Zoti nuk e ndalon “gjëmbin”, por buzëqesh ndaj këngës. Zoti nuk e shfuqizon dhimbjen,, por e shndërron në kuptim. Siç duket kjo është ideja e dhimbjes, si rrugë drejt dritës, jo si gabim i botës.

Në fund të fundit Zogu i Gjëmbave është metafora e njeriut që pranon të vritet nga kuptimi i vet më i lartë.

3. Një zog tjetër në romanin “Perëndia mbrapsht dhe e dashura”:

Ndodh dhe kështu!

...sa bukur këndon, mahnitshëm... Dhe ai zog... për fat të keq, këndon vetëm natën, - po thoshte ai me zërin e violintë. - Gjindja dëshiron ta dëgjojë cicërimën fantastike ditën dhe a e dini ç’bëjnë? Ia shpojnë sytë zogut, e verbojnë për t’iu dukur natë dhe të këndoje i verbër, të këndoje në natën e vet prej dhune dhe të përjetshme mes ditës mëkatore të të tjerëve. Të këndoje...

...Ndoshta dhe vendi juaj... bën me ju siç bëjnë në vendin tim me zogun. Krijon natën, që të vajtoni bukur. Jo, jo, kundërshtoi Feliksi duke u dridhur... E si i shpojnë yjet, që të mbeten të verbra?

Është në romanin tim “Perëndia mbrapsht dhe e dashura”. E solla për historinë, ma kishte treguar një poet brazilian në një takim ndërkombëtar poezie dhe unë e futa në libër... Është kënga e atij që di të këndoje, e dalë nga dhuna, është arti i nxjerrë prej errësirës, tashmë të krijuar vetë.

Zogu i verbuar këndon, sepse nuk sheh. Në këtë kuptim ai është si artisti që krijon nga mungesa, nga dëmtimi, nga pushteti i errësirës. A është kënga dhuratë e lirë?

Zogu në librin tim nuk është i pikturuar, ai shkoj te gjëmbat, po aq sa dhe gjëmbat shkuan te ai, nuk ishte i verbër, por e verbuan. Dhe përbindëshi nuk është natyra, por shoqëria. Edhe tirania kërkuaka “art”, por nga gjaku i viktimave.

Bukuria është një dhuratë që u gjendka dhe nga shkatërrimi.

“Zogu Brazilian” nuk është vetëm viktinë, por edhe një “produkt estetik” i një shoqërie mizore që e do këngën, por jo zogun e lirë. Kënga kështu është e kolonizuar.

Albert Camus te “Miti i Sizifit” flet për absurditetin e jetës dhe mënyrën se si njeriu e tejkalon atë me revoltë dhe krijim. Kënga e zogut të verbuar është dhe një revoltë, prandaj nuk pushon së kënduari. Absurditet i bukur, një ekzistencë që përmbushet në vetvete, edhe kur është pasojë e një dhune, më shumë të pashpjegueshme.

Në roman dashura vazhdon dha pas vdekjes...

Nga zogtë te yjet si një epilog

Më sipër unë bëja një pyetje, që i kalonte kufijtë e fabulës: “E si i shpojnë yjet, që të mbeten të verbra?” Të jetë kjo dilema e fundit e ekzistencës, se edhe yjet verbohen dhe atëherë nuk mbetet më as dritë, as shpresë, as transhëndencë?

“A është e mundur që edhe Zoti të ketë vdekur në kampet e përqendrimit?” - pyeste Primo Levi. Po ajo ishte një klithmë metafizike nga tmerri i zhdukjes së dritës absolute.

Zogu i pikturuar i Jerzy Kosinskut, Zogu i gjëmbave i Colleen McCullough dhe Zogu i verbuar në romanin tim na vendosin dhe përballë dilemave të Foucault me teorinë e tij biopolitike mbi pushtetin që individi kur devijon nga norma, duhet ndëshkuar për të ruajtur “ekuilibrin” shoqëror, të Adornos, që thoshte se “të shkruash poezi pas Auschwitz-it është një akt barbar” dhe të Camus-it që flet se si njeriu e tejkalon absurditetin e jetës me revoltë dhe krijim, na shpalosin kështu natyrën e dhunës, të artit dhe lirisë.

Kënga e atyre zogjve është veçantësi, njëkohësisht dhuratë dhe mallkim, bukuri dhe dëshmi dhe njëherësh sakrificë dhe dënim, protestë dhe mbijetëse përtej vetvetes.

Tani mjerisht ka zëra gricës që kritikën e bëjnë me AI, pa i lexuar veprat, thjeshtë duan të bëjnë të njohur qendrimin e tyre ndaj autorëve dhe pa qenë kritikë ndonjëherë, pa përsiatje dhe pa empati, vazhdojnë prirjen e tyre ideologjike të mynxyrshme të të qenit jo “me “zogjtë” e kërcënuar, por “me pushkët e gjahtarëve”...

Megjithatë shqetësimi im është shumë larg tyre, pyetja s’mund të jetë për ata, edhe pse ajo duket sikur mbetet e hapur për të gjithë: a do të mund të kenë yjet sy?.

Gjersa të ketë dritë përtej çdo vdekjeje, ashtu siç ka dhe dashuri, do të ketë natyrisht dhe art të jetës...



Romanin “Bija e Minotaurit” të Agron Tufës (e pamundur ta shmangim këtë klishe stereotipe analizash në hyrje) mund ta lexojmë në disa mënyra. Ne, që kemi jetuar kohën e komunizmit, mund të shpurisim hirin e kujtimeve, të fshijmë me mëngë brymën nga xhamat e dritares për të shquar më qartë personazhet që gjallojnë matanë, te kopshti i librit.

E dimë që kurioziteti njerëzor është një bishë e egër që ushqehet me mish të freskët ndodhish dhe si shkul turinjtë nga preja pa i ngjyer ata me gjak. Kush të jetë kjo Dafina Luçi? Po ky Samuil Ismari? Hamendësojmë, zëvendësojmë shkronja, ndezim drurët në oxhakun e fantazisë, përfytyrojmë çfarë kanë humbur ata si njerëz dhe çfarë kanë fituar si pesonazhe. Bëjmë bilancin e mishit njerëzor me brumin që është dashur për t'i ngjizur si personazhe në faqet e librit, etj.

Në lirinë e tij autori mund të ndryshojë përmasat fizike dhe shpirtërore të personazheve të vet: merret një masë mishi nga vithet e X, për ta shtuar në fytyrën e Y, zbret 30 % hipokrizi nga A për të shtuar 50 % tek B, e kështu me rradhë. Kjo është e pashmangshme në një roman që e merr temën nga bashkëkohësia. Por kjo është ana më pak e rëndësishme në këtë roman. Ai është veç gripi i artë që i ngulet lexuesit tek nofulla për ta tërhequr atë tek faqet e librit. Sepse libri, krahas bashkëkohësisë, ka një frymë krejt tjetër, atë universale.

Në kohën e Rabelaise, p.sh, mbretëresha e Francës deshi të priste pishat e pyllit të Bulonjës. Rabëleja i dha priceshës te libri i tij pamjen e një pele xanxare. Është harruar vetë mbretëresha, ama jo pela gjigande e autorit, e cila vërtit bishtin e saj të stërmadh përmbi trungjet e pishave dhe i shkul ata me gjithë rrënjë. Episodi jeton artistikisht, pavarësisht faktit historik. Do të harrohen edhe njerëzit realë të Agron Tufës dhe do të mbeten personazhet, sepse koha ka vërtetuar që letra, allçia, gipsi, kur janë prej cilësie të mirë, janë ku e ku më jetëgjatë se mishi njerëzor.

Personazhi kryesor i romanit “Bija e Minotaurit” është një vajzë e bukur me emrin Dafinë. Thitheni edhe ju kundërmimin e jetës te gjethet e gjelbra të këtij emri, por mos harroni të keni kujdes edhe farërat e zeza të vdekjes që ajo i ka te çdo tufë. Dafina, qysh nga adoleshncë, ka një adhurim romantik për sigurimin e shtetit, makinerinë e mynxyrshme të diktaturës. Ç’të jetë vallë ky adhurim? Dëshira për t'i futur gjarprit gishtin në gojë dhe për t'i shkullur dhëmbin helmues? Devotshmëria e detyrës, apo instikti i lashtë për të qenë fli? Me një fjalë mos është një lloj i kundërt i Antigonës? I gjithë libri është një odise e gjatë, për të na përshkruar se si kjo mjegull adhurimi romantik, e ngjyer e gjitha në rozë, fillon dalëngadalë të degradojë, të bëhet një re e zezë shtërngate, mbushur brenda me thika të kuqe rrufesh kërcënuese. Ato që asaj i dukeshin kokrra breshëri, apo oriz dasmash brenda gjirit të shtrëngatës, janë thjesht saçma çiftesh vrastare. Gabimi i saj i parë, një gabim adoleshenteje, bëhet një plagë, të cilën do ta mbajë të varur si hartë memece në muret e shpirtit, plagë të cilën që të gjithë ia shqyejnë me thonj. Dafina Luçi fillon t'i neveritet kjo jetë dhe fut gishtat në fyt për të nxjerrë ushqimet helmuese të saj. Kur s'i ka mbetur gjë tjetër duket se nxjerr vrer të verdhë. Dhe ke përshtypjen se shumë faqe të këtij romani janë shkruar bash me këtë vrer.

Gjithë ngjarjet e romanit zhvillohen brenda një familjeje, asaj që në këtë

Shënime për romanin “Bija e Minotaurit”
të Agron Tufës, Onufri, 2025

MODERNITETI ARKAIK I AGRON TUFËS

Nga Balil Gjini

rast, mund ta quajmë me ironi qelizë, sepse, në fakt, është një hoje grerëzash. Mund të flasim për të siç flet Bachtini, por edhe siç e do tradita jonë foklorike: që anëtarët e një familjeje janë qenie të lidhura me njëri-tjetrin si zorrët e barkut, të cilat, ashtu, të flligshita dhe lapërdhare, të kujtojnë edhe shpërgënjtë e një djepi. Një familje e lidhur me shpërgënj zorrësh, por tashmë jo intime, por banale. E lidhur me to, ashtu kollopan, ajo të sjell ndër mend veti se po kështu, kollopan, është lidhur edhe atdheu. Veç jo me zorrë, por me tela me gjemba. Vjen një çast që këto zorrë, këto rropulli shndërrohen në litarë, ku çdokush nga pjesëtarët mëton të varë pjesëtarin tjetër. Sepse zemra e tyre nuk është një organ i mbushur me gjakun e kahmotshëm gjenetik, por një shishe plot me bojë të kuqe propagande, me të cilën shkruheshin parrullat e kuqe të komunizmit. Një shishe me bojë zemre, një kovë me bojë parrullash! Njëllor. Zorrë, vrima, jashtëqitje, tunele. Vetiu, diku më

tej, na pret edhe labirinthi i Minotaurit, babait të Dafinës. Sepse përbindëshi i lashtë, nuk kërkon asgjë më shumë se ç’kërkon i riu, pavarësisht se nga pamja ndryshojnë aq sa ndryshon një krokodil nga një hardhucë. Kurrë më parë miti i familjes, sentimentalizmi gjithë sherbet i saj, s’ka marrë një goditje kaq të ashpër. Është përmbysur tava me bakllava dhe sherbet së bashku.

Bash në oborrin e kësaj familjeje autori ka mbjellë për t’u rritur pjergullën e rrëfimit të vet, të cilën e shtrin në kolona, i lidh degëzimet e shumtë të filizave dhe na thotë të bëjmë durim dhe të presim gjersa të piqu kopanët e rrushit. Dhe kur vjen shtatori letrar kjo hardhi na shfaq midis fletëve të librit ca kopanë të kuq inçesti: gjinj femërorë, tope mashkullore. Shiheni, shiheni, duket sikur na thotë autori: pjergull e pjerdhur, hardhi me herdhe. Një pjergull e ushqyer me plehërishtet e komunizmit, me ujrat e zeza të tij, s’mund të prodhonte veçse fruta të tillë. I gjithë vendi, si të jetë

një vathë e madhe blektorale, funksionon si një sistem çimkash, apo këpushësh, të cilat, siç shpjegon Agambeni, janë të verbra, rrinë varur në degët e pemëve, dhe, sapo kalon ndonjë bagëti, i lëshohen vrikthi mbi trup, instiktivisht, dhe nuk shkulen andej gjersa të ngordhin, të plasin prej sasisë së gjakut që kanë thithur. Veçse janë çimka metalike, mikrofonë përgjimi. Ç’tmerr! Heronjtë kthehen në përbindësia, babai në Minotaur.

Autori e lënur me nge shtëllungën e tekstit letrar, ka gjithë kohën e mjaftueshme për të na zbuluar, ose për të na lënë të nënkuptojmë shumë pikëtakime me tekste autorësh të tjerë. Kjo është siguria e autorit që e di mirë se ç’bën. E gjithë struktura dhe makineria e sigurimit të shtetit, për shembull, na sjell ndër mend makinerinë në novelën e Kafkës “Në koloninë ndëshkimore”. Me to nuk pohohen vetëm lidhjet, por edhe kundërshtitë. I tillë është rasti me shkrimtarin Samuil Ismari që, me një çelës, shënon numrin e akteve seksuale me Dafinën te koka e krevatit. Çfarë vithisje e asaj kreshte epike këndezërore! Çfarë shkurme e zezë gjithë parfum special ironie. Shndërrimi i solemnitetit në bufoneri. Shkrimtari i famshëm një lloj Don Zhuani. Ky i fundit, për shkak të impotencës intelektuale, siç vëren Kierkegaardi, numëron numrin e të dashurve, shkrimtari shkon më tej: numëron jo vetë femrat, por gjënë që i mban ato në këmbë, numrin e akteve seksuale. Të shikosh te veçse një rrufull të zezë përpirëse, mos do të thotë vallë t’i iksh një dërstile tjetër përpirëse shumë më të madhe, politike dhe shoqërore? Aufklärung, sipas Adorno-së, merr të gjithë substancën e miteve për ta shkatërruar dhe, teksa po ngjyhet me masën vishtulloze të tyre, teksa po ushtron funksionin e gjykatësit, fillon e magjepset vetë nga mitet. Në rastin e Dafina Luçi kemi krejt të kundërtën: është miti që e shqyen dhe thith lëngjet e saj vishtulloze.

Dallohet qartë dora zotëruese e autorit në frerët e fabulës së romanit. I gjithë relievi narrativ është gjithë përthyerje dhe dhe kurba estetike: tek bërryli i parë të pret një peizash mahnitës, diku më tej një ngjirë e rrufulla të kaltra, përrenj të vrullshëm meditivesh, borë e ftohtë alpine. Nëse lexuesi e pret autori diku, në anë të një rruge të gjerë (me një tufë me lule në dorë, sigurisht), vetë autori i bën bisht kësaj, i largohet pritës së lexuesit, merr një shteg, ose një dhiare tjetër. Kjo krijon befasinë. Lexuesi që, siç e dimë, mendon se e ka shkruar vetë tekstin, ha inat me veten. “Mua të ma hedhë ky që s’ma ka hedhur dot as Prousti, apo Houellebecq?”, bren thonjtë me dhëmbë nga inati. Kjo lojë kukafshehti e autorit me lexuesin, një lojë e përfytyruar nga lexues të tjerë, paksa më të kualifikuar, e bën shumë interesant librin. Romani, në dukje, është shtrirë brenda plaçantës së një nga atyre romaneve serialë me vrasje, krim, madje edhe me happy end. Ama kjo është bërë thjesht për të mashtruar, sepse gjëja e dalë nga kjo plaçantë, është krejt tjetër gjë. Kjo është një formë e njohur të shkruari, e përdorur edhe nga shkrimtarë të tjerë si Gëte, Shekspiri, Kafka (tek Amerika, formën e së cilës e ka marrë nga Dikensi), apo nga vetë Llosa te “Pesë qoshet”.

Mendoj se në këtë libër Tufa u është larguar eksperimenteve të formës, sepse, në thelb, risitë e vërteta lindin në brendësi të librit. Derisa këto risi janë të shumta, nuk ka pse ndërrohen gjithmonë fuçitë e lisit. Mjafton të jetë vera, e re. Me sa duket modernia nuk është veçse shumë arkaike.



AGRON TUF

Bija e Minotaurit

OnufriRoman

Gjëja e parë që vëren te William Jefferson Clinton është sa i gjatë është. E dyta është fuqia joshëse që ai ka për të të bërë të ndihesh, që nga momenti i parë i takimit, sikur është dikush që e njeh prej kohësh. E treta është inteligjenca e tij e mprehtë, e cila të lejon të bisedosh me të për çfarëdo teme, madje edhe për ato më delikatet, për sa kohë di se kur duhet t'i hapësh.

Megjithatë, dikush që nuk ishte i magjepsur prej tij më paralajmëroi: “Gjëja e rrezikshme e këtyre dhuntive është se Clinton i përdor ato për të të bërë të ndihesh sikur asgjë nuk mund ta interesojë më shumë sesa ajo që po i thua.”

E takova për herë të parë në një darkë të shtruar nga William Styron në shtëpinë e tij verore në Martha's Vineyard, në gusht të vitit 1995. Gjatë fushatës së tij të parë, Clinton kishte përmendur se libri i tij i preferuar ishte “Njëqind vjet vetmi”. Në atë kohë thashë — dhe u citova në shtyp — se mendoja se ai e kishte thënë këtë thjesht për të fituar votën latine. Ai nuk e kishte harruar — pasi më përshëndeti në Martha's Vineyard, menjëherë më siguroi se ajo që kishte thënë kishte qenë krejtësisht e sinqertë.

Carlos Fuentes dhe unë kemi arsye të forta për ta konsideruar atë mbrëmje si një kapitull të tërë në kujtimet tona. Që në fillim, u çarmatosëm nga interesi, respekti dhe humori me të cilat ai na dëgjonte, duke i trajtuar fjalët tona sikur të ishin pluhur ari.

Gjendja e tij shpirtërore përputhej me pamjen e jashtme. Flokët i kishte të shkurtër, si një furçë pastrimi, lëkurën e nxirë nga dielli — kishte pamjen e shëndetshme dhe pothuajse të pacipë të një detari në tokë — dhe kishte veshur një bluzë sportive universiteti me një logo në kraharor. Në moshën 49-vjeçare, dukej si një i mbijetuar i gjallë e entuziast i brezit të '68-ës, që kishte pirë marijuanë, i dinte përmendësh këngët e Beatles-ave dhe kishte protestuar kundër Luftës së Vietnamit.

Darka filloi në orën 8, me rreth 14 të ftuar rreth tryezës, dhe zgjati deri në mesnatë. Pak nga pak, biseda u shndërrua në një lloj tryeze letrare të rumbullakët, ku merrnin pjesë presidenti dhe tre shkrimtarët. Tema e parë që u hap ishte Samiti i ardhshëm i Amerikave. Clinton kishte dashur që ai të mbahej në Miami, dhe aty edhe u zhvillua. Carlos Fuentes mendonte se New Orleans ose Los Angeles kishin pretendime historike më të forta, dhe ai dhe unë argumentuam me këmbëngulje në favor të tyre, derisa u bë e qartë se presidenti nuk kishte ndërmend t'i ndryshonte planet, sepse po llogariste mbështetjen për rizgjedhje nga Miami.

“Harroni votat, zoti President,” i tha Carlos. “Humbni Floridën dhe hyni në histori.”

Kjo frazë vendosi tonin. Kur folëm për problemet e narkotrafikut, presidenti më dëgjoi me bujari. “Tridhjetë milionë të varur nga droga në SHBA tregojnë se mafia e Amerikës së Veriut është më e fuqishme se ajo e Kolumbisë, dhe se autoritetet janë shumë më të korruptuara.” Kur i folam për marrëdhëniet me Kubën, ai u duk edhe më i hapur. “Sikur Fidel Castro dhe ju të uleshit e të flisnit ballë për ballë, të gjitha problemet do të zhdukeshin plotësisht.”

Kur folëm për Amerikën Latine në përgjithësi, kuptuam se ai ishte shumë

MISTERET E BILL CLINTON-IT

Nga Gabriel García Márquez

BOTUAR MË 1 SHKURT 1999

më i interesuar sesa kishim menduar, megjithëse i mungonin disa njohuri thelbësore. Kur biseda dukej se po ngurtësohej disi, e pyetëm se cili ishte filmi i tij i preferuar dhe ai u përgjigj “High Noon”, i Fred Zinnemannit, të cilin e kishte nderuar së fundmi në Londër. Kur e pyetëm se çfarë po lexonte, ai psherëtiu dhe përmendi një libër mbi luftërat ekonomike të së ardhmes, autor dhe titull që për mua mbetën të panjohur.

“Më mirë të lexoni Don Kishotin,” i thashë. “Gjithçka është aty.” Tani, Don Kishoti është një libër që nuk lexohet aspak aq sa pretendohet, megjithëse shumë pak njerëz do ta pranojnë se nuk e kanë lexuar. Me dy ose tre citate, Clinton tregoi se e njihte vërtet shumë mirë. Duke u përgjigjur, ai na pyeti se cilët ishin librat tanë të preferuar. Styron tha se i tij ishte Huckleberry Finn.

Unë do të kisha thënë Edipi Mbret, i cili ka qenë libri im i tryezës së natës për 20 vitet e fundit, por përmenda Konti i Monte Kristos, kryesisht për arsye teknike, të cilat pata disi vështirësi t'i shpjegoja.

Clinton tha se i preferuari i tij ishte Meditimet e Mark Aurelit, ndërsa Carlos Fuentes qëndroi besnik ndaj Absalom,

Absalom, romani yjor i Faulknerit, pa asnjë dyshim, megjithëse të tjerë do të zgjidhnin Light in August për arsye thjesht personale. Clinton, në nderim të Faulknerit, u ngrit në këmbë dhe, duke ecur rreth tryezës, recitoi përmendësh monologun e Benjit, pjesën më tronditëse dhe ndoshta më hermetike, nga The Sound and the Fury.

Faulkneri na çoi drejt një bisede mbi afinitetet midis shkrimtarëve të Karaibeve dhe grupit të romancierëve të mëdhenj të Jugut të Shteteve të Bashkuara. Na dukej shumë më kuptimplotë ta mendonim Karaiben jo si një rajon gjeografik të rrethuar nga deti i tij, por si një brez historik dhe kulturor shumë më të gjerë, që shtrihet nga veriu i Brazilit deri në Pellgun e Misisipit.

Mark Twain, William Faulkner, John Steinbeck dhe kaq shumë të tjerë do të ishin atëherë po aq “karaibianë” sa Jorge Amado dhe Derek Walcott. Clinton, i lindur dhe i rritur në Arkansas, një shtet jugor, e duartrokiti këtë ide dhe u shpreh i lumtur të ishte një karaibian.

Ishte afër mesnatës dhe ai u detyrua ta ndërpriste bisedën për të marrë një telefonatë urgjente nga Gerry Adams, të cilit, në atë çast, i dha autorizimin të bënte

fushatë dhe të mbledhte fonde në Shtetet e Bashkuara për paqen në Irlandën e Veriut. Kjo do të duhej të ishte përfundimi i një mbrëmjeje të paharrueshme, por Carlos Fuentes e çoi më tej, duke e pyetur presidentin se kë i konsideronte si armiq të tij.

Përgjigja e tij ishte e menjëhershme dhe e prerë: “Armiku im i vetëm është fundamentalizmi fetar i djathtë.” Kjo deklaratë i dha fund mbrëmjes. Herët e tjera që e pashë, qoftë në publik apo në privat, pata të njëjtin përshtypje si herën e parë. Bill Clinton ishte krejt e kundërta e idesë që latino-amerikanët kanë për presidentët e Shteteve të Bashkuara.

Duke marrë parasysh të gjitha këto, a duket e drejtë që këtij njeriu të jashtëzakonshëm t'i pengohet përmbushja e fatit të tij historik thjesht sepse nuk ishte në gjendje të gjente një vend privat për të bërë dashuri? Pikërisht kjo ndodhi. Njeriu më i fuqishëm në botë u pengua të konsumonte pasionet e tij të fshehta nga prania e padukshme e Shërbimit Sekret, i cili shërbente po aq për ta kufizuar sa edhe për ta mbrojtur.

Nuk ka perde në dritaret e Zyrës Ovale, nuk ka shul në derën e banjës private të presidentit. Vazoja me lule që shfaqet pas presidentit në fotografitë e tij në tavolinë është pretenduar nga shtypi se shërbente si vendstrehim për mikrofonë, për të shenjtëruar misteret e audiencave presidenciale.


Edhe më trishtuese, megjithatë, është fakti se presidenti donte vetëm të bënte atë që burrat e zakonshëm kanë bërë privatisht me gratë e tyre që nga fillimi i botës, dhe një ngurtësi puritane jo vetëm që e pengoi, por madje ia mohoi edhe të drejtën për ta mohuar.

Jonai shpiku letërsinë e trillimit kur e bindi gruan e tij se kthimi i tij në shtëpi ishte vonuar tri ditë sepse një balenë e kishte gëlltitur. Duke u mbështetur në atë argument të lashtë, Clinton mohoi se kishte pasur marrëdhënie seksuale me Monica Lewinsky dhe e mohoi këtë me kokën lart, si çdo bashkëshort i pabesë që respekton veten. Në fund, drama e tij personale është një çështje thjesht familjare, mes tij dhe Hillary-t, dhe ajo i qëndroi pranë në sytë e botës me një dinjitet homerik.

Një gjë është të gënjesh për të mashtruar; por krejt tjetër është të fshehësh të vërtetën për të mbrojtur atë dimension mitik të ekzistencës njerëzore që është jeta private. Me të drejtë, askush nuk është i detyruar të dëshmojë kundër vetvetes. Për faktin se këmbënguli në mohimet e tij fillestare, Clinton do të ishte ndjekur penalisht gjithsesi — kjo ishte thelbi i çështjes — por është shumë më dinjitoze të kryesh dëshmi të rreme duke mbrojtur privatësinë e zemrës sesa të shpallesh i pafajshëm në kurriz të dashurisë.

Në mënyrë katastrofike, me të njëjtën këmbëngulje me të cilën kishte mohuar fajin, ai më pas e pranoi dhe vazhdoi ta pranonte në të gjitha mediat — të shkruara, pamore dhe gojore — deri në pikën e poshtërimit; një gabim fatal për një dashnor të pasigurt, jeta e fshehtë e të cilit do të hyjë në librat e historisë jo pse bëri dashuri keq, por sepse e bëri atë shumë më pak madhështore sesa duhej.

Në mënyrë qesharake, ai iu nënshtrua seksit oral ndërkohë që fliste në telefon me një senator. Zëvendësoi veten me një



puro të ftohtë. Natyrisht përdori të gjitha llojet e dredhive shmangëse, por sa më shumë përpiqej, aq më shumë hetuesit e tij nxirrnin prova kundër tij, sepse puritanizmi është i pangopur dhe ushqehet me jashtëqitjen e vet.

Ka qenë një komplot i gjerë dhe i errët fanatikësh, i drejtuar ndaj shkatërrimit personal të një kundërshtari politik, madhështinë e të cilit ata nuk mund ta duronin. Metoda ishte përdorimi kriminal i drejtësisë nga një prokuror fundamentalist i quajtur Kenneth Starr, pyetjet e egra dhe të pangopura të të cilit dukeshin se i ngacmonin këta fanatikë deri në ekstazë.

Bill Clinton që takuam rreth katër muaj më parë, në një darkë gala në Shtëpinë e Bardhë për Andrés Pastrana-n, presidentin e Kolumbisë, dukej krejt ndryshe — jo më akademiku mendjehapur i Martha's Vineyard-it, por një njeri nën dënim, më i dobët dhe i pasigurt, që nuk arrinte ta fshihte, pas një buzëqeshjeje profesionale, një lodhje organike, si ajo lodhje e metalit që shkatërron avionët.

Disa ditë më parë, në një darkë për shtyp me Katharine Graham-in, gruan e artë të Washington Post-it, dikush kishte vënë re se, duke gjykuar nga gjyqet e Clinton-it, Shtetet e Bashkuara ende dukeshin të ishin vendi i Nathaniel Hawthorne-it. Atë natë në Shtëpinë e Bardhë, kuptova saktësisht se çfarë nënkuptohej.

Referenca ishte për romancierin e madh amerikan të shekullit të kaluar, i cili në veprën e tij denoncoi tmerret e fundamentalizmit të Anglisë së Re, ku shtrigat e Salemit digjeshin të gjalla. Romani i tij kryesor, Shkronja e kuqe, është drama e Hester Prynne-it, një gruaje të re të martuar që solli në jetë një fëmijë fshehurazi me një burrë tjetër. Një Kenneth Starr i asaj kohe e dënoi atë të mbante një këmishë pendese me shkronjën “A” të kodit puritan, me ngjyrën dhe erën e gjakut.

Një agjent i rendit e ndiqte kudo duke rrahur një daulle, që kalimtarët të shmangeshin prej saj. Fundi me siguri duhet ta mbajë zgjuar prokurorin Starr, sepse babai i fshehtë i fëmijës së Hester-it doli të ishte një ministër i kultit që e shndërroi atë në martire.

Metoda dhe morali i procedurave ishin në thelb të njëjta. Kur armiq të Clinton-it dështuan të gjenin atë që u duhej për ta rrëzuar, e ndoqën me pyetje të minuara derisa e zunë herë pas here në mospërputhje të vogla. Pastaj e detyruan të akuzonte veten publikisht dhe të kërkonte falje për gjëra që as nuk i kishte bërë, drejtpërdrejt, duke përdorur teknologjinë e informacionit universal, e cila nuk është gjë tjetër veçse një version trimijëvjeçar i daulleve që përndiqnin Hester Prynne-in.

Nga pyetjet e prokurorit, dinake dhe epshore, edhe fëmijë të vegjël u bënë të vetëdijshëm për gënjeshttrat që prindërit e tyre u kishin thënë për t’ua fshehur se si kishin ardhur në jetë. I goditur nga lodhja e metalit, Clinton kreu marrëzinë e pafalshme të ndëshkimit të dhunshëm të një armiku të sajuar 5.397 milje detare larg Shtëpisë së Bardhë, për të larguar vëmendjen nga gjendja e tij personale.

Toni Morrison, fituese e Çmimit Nobel për Letërsi dhe një shkrimtare e madhe e këtij shekulli të dhembshëm, e përmbloodhi gjithçka në një fjali të frymëzuar: “E trajtuan sikur të ishte një president me ngjyrë.”

Karikaturë nga Arben Meksi



MARTIN CAMAJ



VEPRA E PLOTË
NË NJË VËLLIM

Onufri